

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E martë, 13 shtator 2022

2 [Deklaratat përmbyllëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 9.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjes.

8 Asistente e Gjykatës, ju lutem të lajmëroni lëndën e
9 çështjes.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo
11 është çështja KSC-BC-2020-05, Prokuroria i Specializuar kundër
12 Salih Mustafës.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit.

15 Së pari, të kërkojmë që të paraqiten të gjitha palët. Të
16 shohim se kush është i pranishëm nga Zyra e Prokurorit të
17 Specializuar?

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjes, e nderuara
19 Gjykatëse dhe të gjithë që jeni këtu në sallë të Gjykatës dhe
20 jashtë.

21 ZPS-ja përfaqësohet nga Jack Smith, Prokuror i
22 Specializuar; Prokurorja Silvia D'Ascoli, Filippo De Minicis,
23 Julie Mann, që është Përgjegjëse e Çështjes. Kemi bashkë me
24 veten tonë edhe dy stazhier sot, Ebba Nermark dhe Benjamin
25 Dearden. Dhe unë jam Cezary Michalczuk, Prokuror.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala
2 Mbrojtësja e Viktimave.

3 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
4 Viktimat e përfaqësuara në këtë gjyq janë të përfaqësuar sot
5 nga Jack Provan, që është i ri, znj. Brechtje Vossenberq, që
6 është Bashkëmbrojtëse dhe unë, Anni Pues, që jam Mbrojtësja.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala
8 Mbrojtëse, ju e keni fjalën.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjesi, i nderuar Gjykatës.
10 Jam Julius Von Bone, mbrojtësi. Bashkë me mua është
11 bashkëmbrojtësi, Betim Shala; dhe hetues dhe përkthyes, Fatmir
12 Pelaj. Dhe z. Salih Mustafa na bashkohet me videolidhje.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
14 për procesverbalin, jemi tani përpara Trupit Gjykes numër I.

15 Sot do të fillojmë me deklaratat mbyllëse të kësaj
16 çështje. Do të ndjekim rendin e ditës siç e kemi paraqitur në
17 vendimin që ka të bëjë me deklaratën mbyllëse dhe çështjet e
18 ndërlihdura, që është tek dosja 468.

19 Ju përkujtoj që kjo seancë do të mbahet në seancë të
20 hapur, në qoftë se me përjashtim të rasteve kur palët kërkojnë
21 që të jetë seancë e mbyllur dhe të vendoset kështu nga Trupi
22 Gjykes. Për shkak se gjatë deklaratave mbyllëse mund të
23 përmendet informacione konfidenciale apo informacione të cilat
24 kanë të bëjnë me masat mbrojtëse, ju kujtoj që të më jepni
25 lajmërim paraprak në rast se kërkonit që të kalojmë në seancë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 3

1 të mbyllur apo private me qëllim që gjatë, pra, parashtrimeve
2 tuaja.

3 Ju përkujtoj, po kështu, që duhet të ndjekim procedurën
4 me anë të së cilës kërkohen redaktime që bëhen për deklaratat
5 në sallën e gjyqit, siç kemi bërë gjatë gjithë gjyqit dhe siç
6 paraqitet, siç është pjesë e dosjes 170.

7 Tani do të fillojmë me deklaratën mbyllëse të ZPS-së, për
8 të cilën ju kemi dhënë pesë orë e gjysëm, siç keni kërkuar. Ju
9 lutem na informoni, nëse ka ndonjë ndryshim në këtë afat kohor
10 për arsye të planifikimit.

11 Ju e keni fjalën.

12 Z. SMITH: [Përkthim] Si Prokuror i Specializuar, jam i
13 lumtur që kam privilegjin që të flas sot këtu në përfundim të
14 gjyqit të dytë të kësaj Gjykate.

15 Në qoftë se ajo do të ketë ndonjë kuptimësi, puna e kësaj
16 Gjykate duhet të bazohet në viktimat. Viktimat duhet ta dinë
17 që ky është vendi ku mund të rrëfejnë historitë e tyre pa
18 frikë, që përgjegjësia nuk ka një datë skadimi dhe se shteti i
19 së drejtës është ai që mbizotëron. Dhe tani, ndërsa filloj
20 komentet e mia, do t'u kërkoj që të mendoni për një çast për
21 një nga viktimat e kësaj çështje. Viktima, i cili nuk i
22 mbijetoi torturës që ndodhi në kompleksin e parandalimit të
23 Zllashit. Viktima për të cilin keni dëgjuar nga familja gjatë
24 këtij gjyqi. Viktima, vrasja e të cilit është pjesë e kësaj
25 çështjeje.

1 Sa vjeç do të ishte ai tani? Çfarë do të kishte bërë me
2 jetën e tij në qoftë se kjo jetë nuk do të ishte marrë? Do të
3 ishte pak mbi 50, këtë e di, po çfarë do të kishte bërë me
4 jetën e tij? Këtë s'kemi për ta ditur asnjëherë. Ai, mund të
5 themi, që do të kishte jetuar. Ndoshta do të kishte pasur një
6 jetë të mirë. Ndoshta një jetë të vështirë. Ndoshta do të
7 kishte pasur një jetë mjaft të suksesshme apo jo. Ndoshta do
8 të kishte kontribuar në mënyrë të konsiderueshme për
9 komunitetin e tij. Ndoshta do të kishte pasur familjen e tij,
10 fëmijët e tij që të rriteshin derisa të bëheshin të mëdhenj.
11 Ndoshta. Ndoshta.

12 Mund thjesht të spekulojmë këtu se çfarë do të kishte
13 bërë me kohën që ka mbetur në planetin tokë deri më tani e më
14 tutje. Por e vërteta është që këtë ne nuk kemi për ta ditur
15 asnjëherë, as familja e tij nuk ka për ta ditur asnjëherë, për
16 shkak të Salih Mustafës dhe njerëzimit që ai komandonte, ata të
17 cilët i kanë torturuar dhe vrarë. Prandaj nuk do ta dimë këtë
18 gjë asnjëherë.

19 Të nderuar Gjykatës, viktimat dhe tragjeditë e tyre janë
20 në thelb të kësaj çështjeje. Për herë të parë, pas më shumë se
21 23 viteve është kjo çështje që u ka dhënë atyre mundësinë për
22 t'u shprehur, i ka dhënë mundësinë për të folur për dhimbjen
23 dhe vuajtjet që kanë duruar në prill të vitin 1999 dhe sesi
24 hija e gjatë e atyre ngjarjeve traumatike vazhdon që t'i
25 ndjekë edhe sot e kësaj dite.

1 Në fjalët e 01679, viktimat e ndaluar është torturuar për
2 18 ditë nga z. Mustafa dhe njerëzit e tij:

3 "Më duket sikur po shoh një film. Kur shkoj në krevat
4 ngrihem duke piskatur, them gjëra në gjumë ... familja më
5 thotë që këtë kam bërë. Dhe ngrihem dhe çirrem dhe jam i
6 mbuluar me djersë. Më kujtohen emrat e këtyre njerëzve. Dhe
7 kam pikërisht këto kujtime.

8 "Janë emrat e viktimave dhe emrat e njerëzve të cilët na
9 kanë torturuar".

10 Kjo çështje ka të bëjë edhe me stigmatizimin social që
11 viktimat, të gjithë shqiptarët e Kosovës kanë duruar për vite,
12 vite të tëra pas këtyre ngjarjeve traumatike. Sipas një
13 viktime tjetër:

14 "...Shpresoj që një ditë do të jemi të gjithë të lirë për
15 të treguar se çfarë kemi përjetuar. Shpresoj që të kemi një të
16 ardhme ku të mos ketë krime, frikë dhe vrasje. Nuk kërkoj gjë
17 tjetër përveç lirisë. Ne e duam vendim tonë, Kosovën dhe nuk
18 kemi synuar asnjëherë që të themi ndonjë gjë të keqe për të. E
19 vetmja gjë që kërkoj është që të them haptazi atë që na ka
20 ndodhur pa pasur frikë. Dhe shpresoj që një ditë ne do të mund
21 ta bëjmë një gjë të tillë."

22 Të nderuar Gjykatës, përpara se të ekzistonte kjo
23 Gjykatë, Dhomat e Specializuara të Kosovës, kjo liri për të
24 thënë, për të folur haptazi nga ana e viktimave nuk ka
25 ekzistuar. Edhe sot kërkohet një guxim i jashtëzakonshëm.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 6

1 Kur dy viktimat e kësaj çështjeje e kanë takuar njëri-
2 tjetrin edhe disa vite pas ngjarjeve të Zllashit dhe njëri e
3 pyeti tjetrin nëse do të mund të tregonte se çfarë u kishte
4 ndodhur atyre në Zllash, atij ju tha nuk është kjo koha e
5 duhur apo vendi i duhur për shkak se dhe citoj, "Po të
6 raportoni se çfarë ka ndodhur, në fakt, është para
7 institucioneve të cilët i kontrollojnë pikërisht këta njerëz."

8 Të nderuar Gjykatës, stigma e përhershme që është
9 shkaktuar nga veprimet e të akuzuarit dhe atyre që kanë
10 vepruar në bazë të urdhrave të tij, nën udhëheqjen e tij, nën
11 kontrollin e tij, ata të cilët i kanë etiketuar viktimat si
12 spiunë dhe bashkëpunëtorë të armikut, një etiketë e bërë në
13 mënyrë të rreme për ta për shkak se janë perceptuar se nuk
14 kanë mbështetur sa duhet UÇK-në dhe kauzën e saj po që kanë
15 pasur një përkatësi politike të ndryshme. Ndoshta kanë
16 favorizuar LDK-në dhe jo UÇK-në që të drejtonte vendin.
17 Ndoshta kanë menduar se Ibrahim Rugova dhe jo Hashim Thaçi
18 është personi më i mirë për ta dërguar Kosovën drejt
19 pavarësisë, pas arritjes së pavarësisë.

20 Dhe për këtë ata janë burgosur në një rrethim të izoluar,
21 janë rrahur gjatë gjithë kohës, janë torturuar, në një rast
22 janë edhe vrarë.

23 Këta njerëz nuk ishin spiunë. Këta nuk kanë punuar me
24 armikun. Ata nuk ishin armiq të Kosovës. Është e rëndësishme
25 që ta dimë që ky gjyq ka filluar para një viti dhe gjatë

1 gjithë atij viti nuk kemi dëgjuar asnjë gramë dëshmi të
2 besueshme nga askush që të mbështeste pikërisht këto
3 pretendime pa bazë.

4 Kush ishin këto viktima? Ata ishin kosovarë, anëtarë të
5 komunitetit, bashkëqytetarë, disa prej të cilëve kishin dalë
6 vullnetarë për të shërbyer me UÇK-në për shkak se kanë besuar
7 fuqimisht në luftën e Kosovës për pavarësi. Fakti që secila
8 prej viktimave të kësaj çështje ishte kosovar, shqiptar i
9 Kosovës, nuk përshtatet me përshkrimin e tyre si armiq të
10 kësaj Gjykate.

11 Për ata të cilët e kanë kundërshtuar këtë Gjykatë, që
12 kanë kërkuar që ta pengojnë këtë Gjykatë dhe punën e zyrës
13 sime gjatë gjithë kohës, ky është një fakt i pakëndshëm por në
14 fakt i papushtueshëm. Është fakt që nuk do të dëgjohet
15 asnjëherë nga ata që duan të shkatërrojnë institucionet e
16 drejtësisë. Ata nuk merren me këtë çështje, me ekzistencën e
17 këtyre viktimave sepse nuk e bëjnë dot. Sepse për ta bërë një
18 gjë të tillë do të duhej të hidhnin poshtë pikërisht
19 pikëpamjen e tyre apo atë që mendojnë ata se çfarë përfaqëson
20 kjo Gjykatë dhe e kujt është.

21 Kjo është një gjykatë e Kosovës e krijuar nga vullneti i
22 popullit të Kosovës dhe u shërben të tërë viktimave dhe
23 krimeve që mbulon mandati i saj. Dhe këtu përfshihen shumë,
24 shumë qytetarë të Kosovës.

25 E vërteta është që disa udhëheqës të UÇK-së, si z.

1 Mustafaj, e kanë shfrytëzuar fuqinë e tyre për të viktimizuar,
2 brutalizuar kosovarët, përfshirë individët gabimi i vetëm i të
3 cilit është se janë perceptuar që nuk kanë besnikëri të
4 mjaftueshëm për UÇK-në dhe udhëheqësit e tij apo që kanë
5 pikëpamje politike që janë të ndryshme nga ato të UÇK-së dhe
6 udhëheqësve të tij.

7 Siç keni parë gjatë paraqitjes së dëshmimeve vitit të
8 shkuar nuk ka pasur objektiv të ligjshëm ushtarak për ndalimin
9 e tyre, nuk ka pasur asnjë justifikim për kushtet e mjerueshme
10 në të cilat janë mbajtur apo në mënyrën sesi janë torturuar
11 gjatë paraburgimit të tyre.

12 Diskutimet në këtë çështje duhet të fillojnë duke mbajtur
13 parasysh sesa të rënda janë krimet për të cilat flasim dhe
14 nivelin shumë të lartë të dhunës ndaj së cilës i janë ushtruar
15 viktimat. Kur të shqyrtoni këto dëshmi, të nderuar Gjykatës,
16 është e rëndësishme që të mos harroni asgjë që kanë vuajtur
17 viktimat dhe me të cilën akuzohet i akuzuari për shkak se jo
18 vetëm që ai e ka lejuar atë, e ka mbështetur dhe ka ndihmuar,
19 por e ka modeluar këtë dhunë për vartësit e tij.

20 Në kompleksin e paraburgimit të Zllashit, të burgosurit
21 janë rrahur çdo ditë. Ata janë mbajtur të paraburgosur në këtë
22 stallë dhe kanë dëgjuar çirrat jonjerëzore të atyre që
23 rriheshin lart. 1679 e ka shpjeguar:

24 "Kam dëgjuar gjitha ato lloj zërash dhe aty kam mësuar që
25 zëri i njeriu mund të ndryshojë për shkak të asaj që

1 përjeton”.

2 [Dëshmitari] 679 dëgjoi sesi kishte dëgjuar çirrje, të
3 lehura qensh, zhurma apo tinguj si të maceve që çirren për
4 shkak të torturës dhe të dhimbjes. Në të njëjtën mënyrë, 3593
5 ka thënë që zërat e njerëzve që rriheshin dhe piskamat e tyre
6 “Bënin që të mos flinin dot për shkak se kishim frikë se e
7 njëjta gjë mund të na ndodhte edhe neve po të na çonin në
8 katin lart”.

9 593 ka thënë më tej, se kur kam dëgjuar këtë “Kam menduar
10 që ndjeheshim shumë keq për shkak se mendonim për veten tonë.
11 Dhe mendonim se do të kishim të njëjtin fat si ato të tjerët”.

12 Dëshmitari [1]679 e ka bërë këtë tejet të qartë kur na
13 tha:

14 “Prisnim, thjesht prisnim vdekjen, kur do të vinte ajo.
15 Sot, nesër. Prisnim që të na vrisnin”.

16 Kompleksi i paraburgimit të Zllashit nuk ishte gjë tjetër
17 veçse një dhomë torture për këto njerëz. Dhe gjatë dëshmive
18 keni dëgjuar raste të përsëritura të kësaj torture.

19 Dëshmitarët e kësaj çështjeje e kanë parë veten të mbuluar me
20 gjak dhe me lëndime që janë rrahur derisa kanë humbur
21 ndjenjat. Janë rrahur me sakica, me shkop hekuri të policisë.
22 Trupi i tyre është djegur me qiri dhe me hekur të nxehtë. Janë
23 therur me thika. Dhe ndaj tyre është përdorur rryma elektrike.

24 [Dëshmitari] [1]679 ka shpjeguar sesi torturuesit e tij e
25 kanë ulur në një karrige, kanë ndezur një qiri dhe e kanë

1 vendosur afër tij me qëllim që të digjej ndërkohë që binte
2 qiriu aty. Kanë përdorur po kështu një kuti elektrike për ta
3 torturuar. I kanë ngritur pantallonat, i kanë lidhur telat në
4 këmbët e tij dhe më pas e kanë ndezur. Dhe shokimi elektrik e
5 ka dridhur gjithë trupin.

6 Siç kanë treguar raportet mjekoligjore nga Mbrojtësit e
7 Viktimave e kanë bërë të qartë, që kjo torturë ka lënë njolla
8 të pashmangshme në trupin dhe kokën dhe në trurin e tyre. Dhe
9 natyra e dhunës tregon jo vetëm që ajo është e vërtetë për sa
10 i përket dënimit në këtë çështje por edhe kredibilitetin e
11 viktimave.

12 Siç do të dëgjoni gjatë gjithë prezantimit të sotëm, këto
13 viktima dhe rrëfimet e tyre që të gjitha janë provuar nga të
14 gjithë të tjerët, duke pasur parasysh vuajtjet e mëdha gjatë
15 viteve, ata kanë pritur për t'u dëgjuar. E vetmja arsye e tyre
16 ka qenë që të shpresojnë që abuzimi të marrë fund dhe
17 drejtësia në fund të dalë në dritë.

18 Nga abuzimi i viktimave, askush nuk ka vuajtur më shumë
19 sesa i riu, vrasja e të cilit është në thelb të kësaj
20 çështjeje. Kur ka përshkruar gjendjen e tij 679 tha:

21 "Ishte katastrofë. Trupi i tij kishte gjithë këto njolla.
22 Ishte e tmerrshme. Që të gjithë na kanë rrahur, por atë e kanë
23 rrahur më shumë se të tjerët".

24 Pra, çfarë dimë për ngjarjet që i kanë paraprirë vrasjes
25 së këtij personi? Çfarë ajo që dimë tregon katërçipërisht se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 11

1 z. Mustafaj a ka patur përgjegjësi, pra, për këtë vrasje?

2 Të fillojmë me bazën. E dimë që viktimë është dërguar në
3 kompleksin e paraburgimit të Zllashit më 1 prill 1999. E dimë
4 që ky kompleks është kontrolluar në atë kohë nga njësitë BIA i
5 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne dimë po kështu që BIA dhe
6 ky kompleks ishin nën komandën e të akuzuarit të kësaj
7 çështjeje z. Salih Mustafaj.

8 Ne dimë po ashtu se më 1 prill i akuzuari ishte i
9 pranishëm atje në këtë kohë, në këtë kompleks, ku ka qenë
10 dëshmitar kur viktimë e vrasjes i është dorëzuar rojës Muhamet
11 Ajeti, tek porta. E dimë po kështu që Ajeti ishte ushtar i
12 BIA-s i komanduar nga i akuzuari.

13 Ne dimë që kjo viktimë është torturuar në kompleksin e
14 paraburgimit të Zllashit për më shumë se dy javë, duke filluar
15 nga ajo ditë, pra, 1 prilli. Dimë po kështu dhe kjo është e
16 rëndësishme, që kompleksi i paraburgimit në Zllash ishte një
17 vend i vogël, i izoluar. Dhe e dimë që në të njëjtën kohë ky
18 kompleks i vogël i izoluar, i akuzuari, e ka aprovuar vetë dhe
19 e kemi dëgjuar dhe nga dëshmitë e tjera, që ai ka qenë i
20 pranishëm në atë kompleks në të njëjtën kohë.

21 Ne dimë po kështu, që nga dita e parë, kjo viktimë,
22 viktimë e vrasjes është veçuar që të trajtohej në mënyrë
23 abuzive. Që në fillim është marrë një vendim për ta rrahur atë
24 më shumë dhe për ta trajtuar atë më keq se të tjerët.

25 Dëshmitari 4669 ka parë pesë apo gjashtë njerëz të cilët e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 12

1 kanë rrahur atë me çdo gjë që kishin në dorë. Dëshmitari
2 [1]679 na tha sesi ai ka parë që ai ishte djegur me një hekur
3 dhe e kishin therur me thikë.

4 Viktima e vrasjes ishte i vetmi i burgosur i cili i
5 kishte duart e lidhura gjatë gjithë kohës.

6 Dhe dukshëm, Dëshmitari 1679 na ka thënë që kjo viktimë i
7 njihte shumë prej atyre që e kishin burgosur, përfshirë
8 Salinë, të akuzuarin, Tabutin, Ilmi Velën dhe Fatmirin dhe si
9 të tillë dhe citoj, "ato kishin frikë që t'ia hiqnin prangat".

10 Kur e kanë sjellë në ahur pasi e kishin nxjerrin për ta
11 torturuar, ai dukej tërësisht i mbaruar. Kishte njolla dhe
12 shenja në fytyrë dhe në trup dhe nuk rrinte dot në këmbë për
13 shkak të lëndimeve të tij. Sipas Dëshmitarit 4669, "Ai ishte i
14 nxirë nga të rrahurat. Çdo gjë në fytyrën e tij, sytë, hunda,
15 çdo gjë ishte e nxirë". "Ai ishte i mavijosur, i nxirë në të
16 gjitha pjesët e dukshme të trupit". Nuk ishte në gjendje që
17 t'i hapte sytë.

18 Ata që e kanë mbajtur të burgosur e kanë përdorur
19 viktimën për të terrorizuar të burgosurit e tjerë, duke e
20 paraqitur trupin e tij si shembull, si paralajmërim.

21 [Dëshmitari] 4669 tha që viktima ishte sjellë këtu në ahur i
22 keqtrajtuar dhe të gjithë të paraburgosur kishin frikë dhe e
23 kishin kuptuar që situata ishte kritike dhe njëjta gjë mund të
24 ndodhte për to.

25 Çdo herë që është sjellë në ahur [Dëshmitari] 4669 dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 13

1 bashkë të paraburgosurit e tjerë ishin detyruar që të thoshin,
2 "Vdekje tradhtarëve, vdekje hajnave, vdekje halabakëve dhe
3 lavdi UÇK-së".

4 Çfarë dimë tjetër? E dimë se si rezultat i këtyre
5 rrahjeve të tmerrshme, viktimat e vrasjes ishte duke vdekur kur
6 e kanë parë për herë të fundit të burgosurit e tjerë. Kur
7 Dëshmitari 4669 e ka parë për herë të fundit viktimën "Ai
8 ishte", citoj, "pothuajse i vdekur" dhe ishte i shtrirë, i
9 ënjtur. I dilte gjak nga hunda. Nuk fliste dot dhe thjesht
10 lëngonte, bërtiste nga vrasjet. Pra, ishte kaq afër vdekjes sa
11 dëshmitarët u desh që ta mbanin atë duke e ngritur të gjithë
12 peshë për shkak se nuk rrinte dot në këmbët e tij.

13 Në fjalët e Dëshmitarit 1679:

14 "As nuk mund të përshkruhet gjendja e tij me fjalë. Trupi
15 i tij, lëndimet e tij, era që vinte, era e mishit që ndjenim.
16 Ishte e tmerrshme. Sipas mendimit tim, ishte masakër".

17 Pavarësisht se viktimat e vrasjes mund të ketë marrë frymë
18 në kohën kur e kanë parë për herë të fundit të burgosurit e
19 tjerë, jeta e tij kishte marrë fund. Të gjitha pjesët e
20 dukshme të trupit ishin të mbuluara me lëndime, ishte
21 mavijosur, nuk fliste dhe nuk i hapte dot sytë. Nuk ecte dot
22 me këmbët e tij. Ishte pothuajse i vdekur. Prandaj, të nderuar
23 Gjykatës, kur ata vendosën që të mos e lironin e kishin në
24 këtë mënyrë dënuar me vdekje. Ne dimë që ushtarët të cilët e
25 kanë torturuar dhe brutalizuar këtë viktimë ishin ushtarë të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 14

1 BIA-s nën komandën e të akuzuarit dhe nuk ka pasur asnjë
2 komandant tjetër i cili të ketë pasur aftësinë që të
3 kontrollonte këta ushtarë. Ai ishte i akuzuari që kishte
4 pushtetin për t'iu dhënë atyre urdhër dhe për t'i disiplinuar.

5 Çfarë tjetër dimë? Ne dimë që kur të burgosurit e tjerë
6 janë liruar, viktimat e vrasjes, bashkë me një të burgosur
7 tjetër, nuk janë lejuar të dalin. Edhe këtë herë, viktimat e
8 mbrojtjes është veçuar. Nuk i kanë lejuar të burgosurit e
9 tjerë për ta marrë me vete këtë viktimë. Nuk i kanë lejuar të
10 burgosurit e tjerë që ta marrin atë me vete dhe të shpëtonte
11 pavarësisht gjendjes së rëndë në të cilën ndodhej.

12 Dhe konkluzioni i vetëm i arsyeshëm që mund të nxirret
13 ishte që ata kishin vendosur që ai të mos mbijetonte, të mos
14 jetonte. Shansi i fundit i tij për të mbijetuar ishte momenti
15 kur të burgosurit e tjerë janë liruar. Kur ata që e kanë
16 mbajtur të paraburgosur nuk e kanë lejuar të dalë, ata me këtë
17 mënyrë e kanë vulosur fatin e tij duke bërë të mundur që ai të
18 mos e shihte më familjen e tij.

19 Po dimë edhe gjëra të tjera. E dimë kur të burgosurit e
20 tjerë janë liruar, kjo ka ndodhur në kohën kur po afrohej
21 ofensiva serbe në zonën e Zllashit. Ne dimë po më tej që i
22 akuzuari vetë ka qenë i pranishëm në kompleksin e paraburgimit
23 të Zllashit në të njëjtën kohë. Një dëshmitar i Mbrojtjes,
24 Teuta Hadri, kujtonte në mënyrë të veçantë sesi e ka parë të
25 akuzuarin në kompleksin e paraburgimit të Zllashit në këtë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 15

1 moment kohor. Dhe si rezultat, pra, ne e dimë që i akuzuari ka
2 qenë i pranishëm në kompleksin e paraburgimit të Zllashit në
3 dy momente kyçe që kanë të bëjmë me këtë krim: Më datën 1
4 prill, kur viktima është dërguar në këtë kompleks dhe kur po
5 afrohej ofensiva serbe dhe është marrë vendimi për të mos e
6 liruar këtë viktimë së bashku me të burgosurit e tjerë.

7 Ne dimë po kështu që në UÇK dihej disa ditë përpara
8 lirimit të burgosurve të tjerë që viktima kishte vdekur. Siç e
9 tha Dëshmitari 4600, ai ka mësuar menjëherë nga një komandant
10 i UÇK-së që viktima e vrasjes kishte vdekur disa ditë pas
11 fillimit të ofensivës që kishte bërë të detyrueshme tërheqjen
12 e UÇK-së nga Zllashi dhe lirimin e të burgosurve të tjerë.

13 Ne dimë po kështu, si përfundim, që trupi i viktimës
14 është gjetur në fillim të korrikut në një varr të cekët shumë
15 afër kompleksit të paraburgimit të Zllashit. Ai ishte me këmbë
16 të zbathura dhe këmbët i kishte të thyera që përputhet me
17 dëshminë që ka dhënë Dëshmitar 1679 kur tha që kur e kam parë
18 për herë të fundit nuk ecte dot.

19 Ndërkohë që sot i akuzuari dëshiron të fajësojë forcat
20 serbe për vdekjen e tij, dëshmi që kemi dëgjuar në këtë
21 çështje, nuk e mbështesin këtë argument. Fillimisht, ndërkohë
22 që forcat serbe mund të kenë hyrë në atë zonë në mënyrë të
23 përgjithshme, nuk kemi dëgjuar në këtë çështje dëshmi të
24 mjaftueshme që këto forca të kenë hyrë në kompleksin e
25 paraburgimit të Zllashit kur viktima, i cili nuk ecte dot me

1 këmbët e tij është parë për herë të fundit.

2 Dimë, po kështu, që i akuzuari dhe vartësit e tij kanë
3 pasur zgjedhjen, zgjedhjen nëse ta lirojnë viktimën apo jo siç
4 liruan të burgosurit e tjerë. Duke pasur parasysh gjendjen e
5 tij, duke e ditur që po afroheshin forcat serbe ato vendosën
6 që të mos e bënë një gjë të tillë. Ata i liruan të burgosurit
7 e tjerë por bënë zgjedhjen e synimshme për të mos e lejuar atë
8 personin të cilin e kishin rrahur më mirë dhe i cili i njihte
9 ato persekutorët e tij me emër që përpara kohës së
10 paraburgimit.

11 Duke pasur parasysh afrimin e forcave serbe dhe gjendjen
12 e tij të rënduar shëndetësore ku nuk lëvizte dot, ne e dimë që
13 e vetmja arsye që nuk e kanë, nuk dëshironin -- ne dimë arsyen
14 sepse nuk e kanë lejuar që të lirohej. Ndryshe nga të
15 burgosurit e tjerë të cilët kanë mësuar për të akuzuarin dhe
16 vartësit e tij gjatë kohës së paraburgimit, viktimja e
17 mbrojtjes [siç], e ka njohur të akuzuarin, e ka njohur me
18 emrin Salih dhe i ka njohur edhe vartësin e tij.

19 Çdo gjë që dimë ka një konkluzion që: Kjo viktimë është
20 veçuar që në fillim për një trajtim më të rëndë se të tjerët.
21 Është torturuar nga dita e mbërritjes në mënyra të
22 paimagjinueshme derisa të mos ecte, të rrinte në këmbë apo të
23 ecte derisa trupi i tij dhe gjithë fytyra të ishte e mbuluar
24 dhe ti vinte era kalbje dhe vdekje.

25 Dhe më pas trupi i tij është gjetur në afërsi të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 17

1 kompleksit të izoluar të paraburgimit të Zllashit, pra, vendi
2 ku ishte torturuar.

3 Pavarësisht se ZPS-ja nuk ka kërkuar një dëshmitar që të
4 jetë i pranishëm kur viktima e vrasjes ka ndërruar jetë, kjo
5 nuk është parakusht për konstatimin fajtor. I akuzuari dhe ata
6 që ka komanduar e kanë bërë këtë krim me qëllim që të kishte
7 sa më pak dëshmitarë sesa të mundej, i ka torturuar viktimat
8 në këtë vend të largët dhe pastaj i ka liruar viktimat e tjera
9 të cilat do të ishin dëshmitarë të momenteve të tij të fundit.

10 Salih Mustafa, si komandant i BIA-s, ishte në kompleksin
11 e paraburgimit në Zllash ditën kur viktima është dërguar në
12 paraburgim, është dërguar në një vend ku nuk do të lejohej të
13 largohej asnjëherë. Salih Mustafa, si komandant i BIA-s, ishte
14 atje në kompleksin e paraburgimit të Zllashit në momentin kur
15 është marrë vendimi për të mos e lejuar këtë viktimë së bashku
16 me të burgosur e tjerë, pavarësisht afrimit të forcave serbe.

17 I akuzuari mban përgjegjësi penale për vrasjen e tij dhe
18 faktet nuk lënë asnjë pikë dyshimi se ai është fajtor sipas
19 krimeve me të cilat është ngarkuar.

20 Ka edhe viktima të tjera të kësaj çështjeje të cilët kanë
21 mbijetuar gjatë paraburgimit në Zllash, por vetëm si njerëz të
22 thyer. Disa janë ulur në një karrige përpara këtij Trupi
23 Gjykues, ju kanë treguar se çfarë kanë vuajtur, për ëndrrat e
24 tyre të tmerrshme, për dhimbjet që kanë. Kolegët e mi do të
25 flasin më në hollësi për këtë çështje, për atë që është

1 provuar, për përgjegjësinë e të akuzuarit. Por për një moment
2 dua që të flas për guximin e jashtëzakonshëm që kanë treguar
3 këto viktimat për të ardhur për të dhënë dëshmi këtu.

4 E kanë bërë këtë në një klimë të frikës dhe të frikësimit
5 që vazhdon në Kosovë edhe sot. Dhe kjo është arsyeja se përse
6 është krijuar kjo Gjykatë dhe sigurisht është kjo arsyeja se
7 përse është sjellë këtu në Hagë.

8 Kur të shikojmë dëshminë e këtyre viktimave, kur të
9 peshojmë dëshminë dhe besueshmërinë e tyre, mbani parasysh
10 këto rrethana. Mbani parasysh sesa e vështirë ka qenë që këto
11 viktimat të vijnë këtu për t'u treguar se çfarë u ka ndodhur. E
12 kemi parë në këtë vend frikësimin që ndodh në Kosovë. [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 Juve ju kujtohet dhe do të thosha se nuk është
22 koincidencë, se pikërisht pasi i akuzuari u thirr për t'u
23 intervistuar nga ZPS-ja, ai mori informacion nga një
24 bashkëpunëtor pikërisht për këtë të njëjtin dëshmitar,
25 Dëshmitarin 3593. Përse? Deduksioni i vetëm i arsyeshëm është

1 se i akuzuari e njihte këtë dëshmitar, 3593, ishte i ndaluar
2 në Zllash dhe mund të jepte prova dëmtuese kundër tij.

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 Të nderuar Gjykatës, e kuptoni vetë sesi të gjitha këto
6 pjesë bashkohen me njëra-tjetrën. Është e habitshme se kur
7 Dëshmitari 3593 erdhi në Gjykatë, vazhdimisht refuzoi të
8 përmendte me zë të lartë emrin e të akuzuarit.

9 Pastaj ishte Dëshmitari 3594. Jeni ju ata që do të
10 vlerësoni dhe t'i jepni peshë dëshmisë dhe sjelljes së tij,
11 por ne parashtrojmë se ky dëshmitar kishte frikë, shumë frikë
12 në fakt për të qenë dëshmitar kundër të akuzuarit. Ai u përpoq
13 të tërhiqte deklaratat e mëparshme, të minimizonte lëndimet që
14 kishte pësuar apo që kishte parë tek të tjerët. Madje ai u
15 tërhoq dhe nga procesi si një viktimë pjesëmarrës.

16 Gjithashtu, 3594, në një intervistë të mëparshme pranoi
17 se kishte, po e citoj, "i ishte dërguar fjalë të kishte
18 kujdes, të mos përmendte ndonjë emër". Dhe këtu në gjyq ai
19 bëri pikërisht kështu.

20 I them të gjitha këto sepse dëshmitarët që kanë ardhur
21 para kësaj Gjykate për të dëshmuar dhe për të treguar
22 historitë e tyre jetojnë në një klimë frikësimi dhe hakmarrje
23 çdo ditë. Ata i nënshtrohen kësaj klime bashkë me familjet e
24 tyre.

25 Unë shpresoj shumë se puna e këtij Tribunali dhe të

1 vërtetat që ai nxjerr në pah përmes fakteve dhe ligjit me kohë
2 do të ndihmojnë për të zhdukur këtë klimë që ka qenë një
3 njollë në përpjekjet për sundimin e ligjit në Kosovë për dy
4 dekada.

5 Ndërkohë, në diskutimet tuaja për këtë çështje, të
6 nderuar Gjykatës kërkoheni që të merrni parasysh sesa kjo
7 klimë ka ndikuar në dëshmitarë të ndryshëm.

8 Gjatë gjithë çështjes së Mbrojtjes, pamë poste të
9 ndryshme në Facebook nga mbështetësit e të akuzuarit, të cilët
10 përshkruanin sesa kanë krenarë ishin për të, aq sa vishnin
11 edhe bluza për të treguar mbështetjen e tij për të. Për fat të
12 keq, do të gjeni se nuk ka deklarata publike për të mbështetur
13 viktimat e krimeve të tij. Ata nuk fitojnë asgjë duke e thënë
14 atë me emër si torturuesin e tyre. Vetëm sepse ndryshe do të
15 quhen tradhtarë nga ata që vazhdojnë t'i përmbahen konceptit
16 të rremë të një lufte të pastër.

17 Gjykata duhet ta marri parasysh këtë realitet në
18 vlerësimin e kredibilitetit të dëshmitarëve të ZPS-së në këtë
19 rast, veçanërisht ata që i përmendëm.

20 Duke pasur parasysh klimën e hakmarrjes ku ata jetojnë
21 bashkë me familjet e tyre, ata kanë pasur çdo arsye për të mos
22 e thënë emrin e tij, duke e ditur se duke përmendur emrin e
23 tij, kjo do t'i dëmtonte familjet e tyre. Nuk kishin
24 absolutisht asnjë arsye ta identifikonin, të tregonin se çfarë
25 bënë, në qoftë se ai nuk ishte aty, në qoftë se ai nuk ishte

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 21

1 përgjegjës, në qoftë se ai nuk merrte pjesë dhe mbikëqyrte
2 torturat e tyre.

3 Kuraja e këtyre dëshmitarëve për të ardhur dhe për të
4 dëshmuar dhe të gjithë, gjithçka që ata rrezikonin të humbnin
5 duke ardhur këtu shkon shumë në favor të kredibilitetit të
6 tyre.

7 Ju do të dëgjoni këtu sesi dëshmitë e tyre janë provuar
8 vazhdimisht e vazhdimisht gjatë gjithë këtij viti të gjyqit.
9 Nga pranimi nga të akuzuarit lidhur me pranimin e tij në
10 Zllash, deri tek pranimi lidhur me rolin e tij si udhëheqësi i
11 padiskutuar i BIA-s, historitë e viktimave janë vërtetuar nga
12 vetë i akuzuari në mënyra që ai nuk do t'i kishte imagjinuar
13 kurrë kur fillimisht dhanë deklaratat e tyre.

14 Po ashtu, aftësia e viktimave për të dhënë emrin e
15 ushtarëve të BIA-s të përfshirë në torturat e tyre, prania e
16 tyre në Zllash konfirmohet nga dëshmitarë krejtësisht të
17 palidhur dhe nga prova, duke pasur të gjitha këto, vërtetojnë,
18 pra, ato që ata thanë, sikurse dhe lista e të burgosurve.

19 Kjo çështje është dhe duhet të lidhet me viktimat, por
20 kryesisht edhe me të akuzuarin dhe viktimat e tij. Provat që
21 provojnë përgjegjësinë e tij për krimet e akuzuara janë
22 bindëse dhe të shtresëzuara dhe ato do të paraqiten në hollësi
23 nga ekipi im.

24 Ajo që është për t'u vënë në dukje është roli komandues i
25 të akuzuarit në BIA dhe në kompleksin e ndalimit në Zllash. Ai

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 22

1 nuk ka qenë i munguar apo i palidhur me këtë qendër, si ka
2 shpjeguar vetë kur është pyetur, ai ka thënë në mënyrë të
3 padiskutueshme dhe po citoj, "Unë jam shtabi", duke
4 nënvijëzuar autoritetin e tij të plotë dhe përfundimtar ndaj
5 vartësve të tij në BIA. Ai ishte një figurë komanduese në BIA
6 në të gjitha drejtimet: Ai jepte urdhra dhe këto urdhra
7 ndiqeshin.

8 Hera e parë që Dëshmitari 1679 u rrah, pikërisht herën e
9 parë fare kjo ndodhi në praninë e të akuzuarit, i cili e
10 filloi sulmin ndaj kësaj viktime. Dhe pastaj në të morën pjesë
11 dhe vartësit e të akuzuarit të cilët ai i drejtoi që të jepnin
12 fund atij, "ta mbaronin". Ushtarët ju bindën dhe vazhduan ta
13 qëllonin me grushte, me shqelma dhe ta rrihnin derisa
14 Dëshmitari 1679 humbi ndjenjat.

15 Në rolin e tij komandues, ai modeloi egërsinë kriminale
16 ndaj vartësve të tij, duke marrë pjesë drejtpërdrejtë në
17 rrahjet barbare të të burgosurit duke ju dhënë atyre leje dhe
18 drejtim të bënin të njëjtën gjë. Duke kryer akte të rënda
19 dhune kundër të burgosurve përpara vartësve të tij, ai
20 komunikojë në një mënyrë që fjalët nuk mundet ta miratojnë dhe
21 ta pranojnë dhe priste që ata të silleshin në të njëjtën
22 mënyrë.

23 Dhe kjo më sjell para çështjes së dënimit. Zyra ime ka
24 kërkuar që ju të jepni një dënim të gjatë me burg të
25 akuzuarit. Ju e dini që ne nuk e bëjmë këtë me lehtësi por

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 23

1 vetëm mbas një shqyrtimi të thellë të të gjithë faktorëve të
2 cilët do të merren në shqyrtim në mënyrë të ligjshme në
3 përcaktimin e një dënimi të drejtë në një rast të tillë të
4 rëndë.

5 Graviteti i akuzave, i krimeve të akuzuara, duke
6 përfshirë efektin shumë të madh që ato kanë pasur në jetën e
7 viktimave dhe të familjeve të tyre është një aspekt i
8 rëndësishëm për t'u marrë parasysh.

9 Në këtë rast, roli i dyfishtë i të akuzuarit si komandant
10 dhe pjesëmarrës përbën një faktor të madh rëndues për dënimin
11 e tij. Si një autor i drejtpërdrejtë Salih Mustafa siguroi që
12 ato që ato që ai kishte në komandë t'i trajtonin viktimat me
13 brutalitet dhe ashpërsi të veçantë.

14 Gjithashtu mungesa e faktorëve zbutës apo lehtësues bie
15 në sy në këtë rast. Pavarësisht nga fakti që ka mbrojtur veten
16 kundër akuzave me të cilat ai përballet, i akuzuari nuk ka
17 bërë kurrë ndonjë përpjekje të shprehë keqardhje apo simpati
18 për viktimat e krimeve të tij që ju i keni dëgjuar këtu të
19 deponojnë gjatë vitit të kaluar. Megjithëse ka dëgjuar sesi
20 viktima e vrasjes ishte rrahur derisa lëkura ju mbush me
21 shenja të zeza, sesi viktima 1617 [sipas përkthimit] ju
22 nënshtrua goditjeve me korrent, sesi viktimat janë
23 stigmatizuar nga komunitetet e tyre, sesi kanë vuajtur
24 fizikisht dhe psikologjikisht dhe vazhdojnë të vuajnë deri në
25 këtë ditë. Asnjëherë nuk e ka bërë atë të ofrojë keqardhjen

1 apo të pranojë dëmin që i ka shkaktuar.

2 Bashkë me faktorët rëndues, mungesë e plotë e faktorëve
3 zbutës janë në favor të dënimit të rekomanduar nga zyra jonë.

4 Kjo çështje ka të bëjë me viktimat dhe familjet e tyre,
5 persona të pafajshëm që kanë vuajtur gjatë gjithë jetës
6 dhimbjet për shkak të akuzuarit. Kjo çështje ka të bëjë
7 gjithashtu me llogaridhënien duke e konfirmuar sundimin e
8 ligjit për të ardhmen. Një e ardhme e mbështetur në drejtësinë
9 që viktimat dhe familjet e tyre kanë kërkuar për kaq shumë
10 kohë dhe për lirinë e tyre për të jetuar jetën si anëtarë të
11 barabartë të komunitetit të Kosovës.

12 Për këtë arsye dhe bazuar vetëm në provat dhe ligjet, ju
13 kërkojmë që ta shpallni të akuzuarin fajtor për krimet e
14 akuzuara dhe të jepnit dënimin e rekomanduar sepse kjo është
15 rruga e drejtë dhe e përshtatshme për krimet kaq të rënda që
16 ai ka kryer.

17 Faleminderit për kohën që më keni dhënë. Tani ua jap
18 fjalën kolegëve të cilët do të vazhdojnë të japin prova të
19 tjera shtesë dhe argumente të tjera shtesë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
21 i jepet fjala një nga kolegëve tuaj.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
23 Gjykatës. Mirëmëngjes, të gjithë në sallën e gjyqit dhe jashtë
24 saj.

25 Si vuri në dukje Prokurori i Specializuar, keni pasur

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 25

1 rastin të dëgjoni gjatë gjithë gjykimit zërat e viktimave
2 dëshmitarëve të cilët me kurajë dolën, erdhën këtu për të
3 dëshmuar në këtë çështje lidhur me atë që ata kanë përjetuar
4 në Zllash në prill të vitit 1999.

5 Pas më shumë se 23 vitesh, ky gjykim ju ka dhënë
6 mundësinë të flasin për t'u dëgjuar zëri i tyre. Dhe ç'na kanë
7 ndihmuar ata për të vërtetuar? Ç'na kanë thënë?

8 Një mesazh duhet të jetë i qartë që nga fillimi. Provat e
9 paraqitura në gjykim provojnë se i akuzuari, z. Salih Mustafa,
10 është përgjegjës përtej dyshimit të arsyeshëm për të gjitha
11 krimet e akuzuara në katër pikat e Aktakuzës. Krimet e
12 ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes.

13 Në pjesën e parë të deklaratave përmyllëse të ZPS-së,
14 Zyra e Prokurorit të Specializuar, ZPS shkurt, do të vërë në
15 dukje se përse bëhet fjalë në këtë çështje dhe si provat,
16 dëshmitë e viktimave, dëshmitarëve janë provuar. Pas pushimit,
17 do të vazhdojmë të diskutojmë elemente të tjerë të
18 kredibilitetit dhe të provimit apo të vërtetimit të provave,
19 përfshirë dhe përgjegjësinë e të akuzuarit. Pastaj do të
20 vazhdojmë të vlerësojmë çështjen e paraqitur nga Mbrojtja dhe
21 pjesën përfundimtare të deklaratave të ZPS-së do të
22 përqendrohen tek dënimi.

23 Të nderuar Gjykatës, më lejoni të kthehem në shtatorin e
24 vitit 2021 kur ZPS-ja e hapi çështjen pikërisht në këtë sallë
25 gjyqi. Në fjalën hapëse, ZPS-ja theksoi thjeshtësinë relative

1 dhe drejtësinë e fakteve të çështjes që do të paraqiteshin.
2 Gjatë gjithë gjykimit, ju dëgjuat viktimat dëshmitarë, të
3 cilët me fjalë të thjeshta por bindëse, ju treguan sesi gjatë
4 luftës në Kosovë, nga afërsisht 1 prill 1999 deri në 19 prill,
5 u çuan në fshatin e Zllashit dhe u mbajtën në mënyrë të
6 paligjshme në një kompleks në Zllash në kushte të tmerrshme,
7 të papërshtatshme për njerëzit. Ju dëgjuat ata të përshkruanin
8 sesi abuzoheshin vazhdimisht, kërcënoheshin, rriheshin
9 egërsisht dhe torturoheshin nga kapësit e tyre. Historitë e
10 tyre ishin të drejtpërdrejta. Historitë e tyre ishin të forta,
11 ishin të ngjashme me njëra-tjetrën dhe provonin, vërtetonin
12 njëra-tjetrën. Historitë e tyre, të nderuar Gjykatës, provonin
13 të gjitha elementët e krimeve të akuzuara në Aktakuzë dhe
14 përgjegjësinë e të akuzuarit, z. Salih Mustafa për ato krime.

15 Përpara se vazhdojmë me historitë e tyre, me dëshmitë e
16 tyre, më lejoni të përshkruaj shkurtimisht vendndodhjen ku
17 krimet e akuzuara janë kryer. Vendndodhja ka shumë rëndësi në
18 këtë çështje.

19 ZPS-ja ka përmendur vendin e ndalimit ku mbaheshin
20 viktimat si kompleksi i ndalimit në Zllash. Të gjithë e njohim
21 në këtë sallë gjyqi këtë vend, strukturën, sepse i kemi
22 diskutuar gjerësisht gjatë gjyqit, për publikun dua të tregoj
23 disa diapozitiva, disa pamje, për të parë se ku krimet e
24 akuzuar në Aktakuzë kanë ndodhur në prill të vitit 1999.

25 Krimet kanë ndodhur në Zllash, siç e dimë, një fshat i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 27

1 vogël i thellë që ndodhet në rajonin malor të Gollakut, në
2 lindje të Prishtinës, kryeqytet i Kosovës. Harta që shihni
3 tani në ekran përshkruan pikërisht Zllashin në lidhje me
4 Prishtinën. Pra, aty shikoni Zllashin në krahun e djathtë të
5 rrethit me blu. Është rreth 20 kilometra me rrugë nga
6 Prishtina.

7 Në prill 1999, fshati i Zllashit përbëhej nga disa grupe
8 shtëpish të shpërndara në një zonë më të gjerë malore të
9 lidhura me rrugën kryesore vetëm përmes një rruge të vogël me
10 kthesa. Kjo tregohet, pasqyrohet në fotografinë ajrore të
11 paraqitur në ekran. Këtu shikoni grupet e shtëpisë në mes të
12 fotografisë. Janë të rrethuara me blu. Ato përfaqësojnë
13 kompleksin e ndalimit të Zllashit. Shikoni gjithashtu, shikoni
14 vetë sesa i izoluar ishte. Sa i vogël ishte. I rrethuar vetëm
15 nga pemë shumë larg nga zona të banuara.

16 Kush e drejtonte këtë kompleks në prill të 1999? Ai
17 përdorej nga anëtarë të UÇK-së, në veçanti, nga një grup i
18 UÇK-së i quajtur BIA, B-I-A, që komandohej nga i akuzuari, z.
19 Salih Mustafa. Ai njihej gjithashtu dhe si komandant Cali apo
20 thjesht si Cali.

21 Siç dëgjuam gjatë gjykimit, ky kompleks, që ZPS-ja e ka
22 quajtur kompleksi i ndalimit të Zllashit, njihej në këtë zonë
23 si baza e Skifterajve apo kompleksi i Skifterajve. Njësia BIA
24 e komanduar nga i akuzuari, në fakt, njihej edhe si Skifterët.
25 BIA e përdorte këtë vend si një nga bazat e veta. Salih

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 28

1 Mustafa, si komandant i BIA-s, përgjigjej dhe kontrollonte
2 kompleksin dhe ushtarët e BIA-s që vepronin aty.

3 Disa ndërtesa të këtij kompleksi kanë rëndësi të veçantë
4 për këtë çështje sepse janë përdorur nga Salih Mustafa dhe
5 anëtarë të tjerë të BIA-s për të ndaluar, marrë në pyetje,
6 keqtrajtuar, të paktën shtatë civilë të Kosovës gjatë kohës që
7 mbulon Aktakuza.

8 Ndërtesat përkatëse paraqiten tani në ekran. Do t'u
9 kthehem këtyre ndërtesave pas një çasti.

10 Tani më lejoni të diskutoj edhe pse shkurtimisht se çfarë
11 provojnë provat që janë paraqitur këtu lidhur me katër pikat e
12 Aktakuzës. Hollësitë e dëshmimeve të dëshmitarëve, atyre ata që
13 i kanë mbijetuar keqtrajtimit dhe torturave të cilat paraqiten
14 në dosjen tonë, kështu që do të japim vetëm një përshkrim të
15 fakteve të vërtetuara.

16 Së pari, cilat ishin viktimat e krimeve në këtë çështje?

17 Siç tha Prokurori i Specializuar ndërkohë, viktimat ishin
18 të gjithë kosovarë shqiptarë të Kosovës, të vendit aty,
19 civilë. Asnjëri prej tyre nuk mernte pjesë aktive në luftime
20 në kohën e arrestimit, keqtrajtimit apo në rastin e njërit
21 prej tyre vrarë. Askush prej tyre nuk përbënte ndonjë kërcënim
22 ushtarak për UÇK-në. Askush prej tyre nuk i ndihmoi forcat
23 serbe në ndonjë mënyrë.

24 Çfarë ndodhi me këto viktimat? Çfarë u ndodhi këtyre
25 viktimave?

1 U arrestuan, u rrëmbyen, u dërguan, u çuan në fshatin
2 Zllash dhe u mbajtur të ndaluar. Asnjë dokument arrestimi nuk
3 u është dhënë. Viktimave nuk u thanë arsyen pse ishin
4 arrestuar dhe pastaj mbajtur të ndaluar, përveç disa akuzave
5 të pabaza, pa themel, të bëra gjatë marrjes në pyetje se ishin
6 hajdutë, spiunë, bashkëpunëtorë të serbëve. Asnjë provë nuk u
7 paraqitë në gjyq se ishin spiunë, bashkëpunëtorë. Asnjë.

8 Ku konkretisht janë çuar viktimat në Zllash?

9 Të gjithë u çuan në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe
10 konkretisht, brenda saj, brenda këtij kompleksi në disa
11 ndërtesa, të cilat të gjithë dëshmitarët pavarësisht nga
12 njëri-tjetri në mënyrë të pavarur e njohën në fotot e
13 paraqitura atyre gjatë dëshmive këtu në gjyq.

14 Viktimat përshkruan se i mbanin në një stallë, në një
15 vend që përdorej për të mbajtur bagëtitë, si edhe në dhomën
16 sipër ku merreshin për pyetje dhe rriheshin.

17 Do t'jua tregoj tani fotografinë në ekran.

18 Shumica e viktimave, përfshirë viktimën e vrasjes, janë
19 mbajtur të ndaluar këtu ku e shohim në ekran në këtë ndërtesën
20 që ka numrin 4A. E keni tani në qendër të pamjes. Si edhe në
21 podrumin e ndërtesës ku në fotografi shënohet me një rreth të
22 kuq. Edhe kjo ndërtesë tani paraqitet, siç e shihni, në ekran.
23 Ata keqtrajtoheshin vazhdimisht në të dy këto vende në 4A dhe
24 podrumin e ndërtesës. Në katin e sipërm të ndërtesës që
25 vazhdon të jetë e paraqitur në ekran, hyrja e të cilës shihet

1 si shënohet me një vijë vertikale të kuqe, të ndaluarit
2 merreshin në pyetje dhe torturoheshin.

3 Dëshmitari 4669 është ndaluar në një ndërtesë tjetër që
4 shënohet me numrin 5. Mund ta shihni një pjesë të kësaj
5 ndërtese në ekran.

6 Disa fjalë lidhur me foton që keni përpara. Të nderuar
7 Gjykatës, do të kujtoni se kjo është një foto që është shënuar
8 në Gjykatë nga dëshmitari i Mbrojtjes, Selatin Krasniqi, që
9 vetë ka qenë një anëtar i BIA-s. Ai ishte nipi i Adem
10 Krasniqit, pronari i kompleksit të ndalimit i cili ia kishte
11 dhënë këtë UÇK-së, një kontribut të tij në përpjekjet e
12 luftës.

13 Selatini e njihte mirë dhe ia përshkroi këtë ndërtesë
14 Gjykatës; por nuk tha, pra, atë që ndodhte realisht në atë
15 ndërtesë.

16 Provat që paraqiti ZPS-ja provojnë përtej dyshimit të
17 arsyeshëm se viktimat janë mbajtur në atë ndërtesë të ndaluar.
18 Disa për disa ditë apo për një javë apo disa të tjerë për
19 rreth dy javë. Disa të tjerë akoma përreth 19 ditë.

20 Gjatë ndalimit të tyre viktimat rriheshin,
21 keqtrajtoheshin, torturoheshin pothuajse çdo ditë, si në
22 stallë që është 4A dhe në dhomën e marrjes në pyetje në pjesën
23 e sipërme, që sapo e pamë. Në stallë keqtrajtimi i tyre bëhej
24 përpara të ndaluarve të tjerë dhe kjo shkaktonte, ngjallte
25 frikë dhe te të tjerët.

1 Të ndaluarit shpiheshin, siç thashë, edhe në ndërtesën
2 lart ku merreshin në pyetje, rriheshin, torturoheshin. Kjo
3 pjesa lart dhe e kemi përpara në ekran tani, tek kjo ndërtesë
4 mund të futeshe nga dera që është e shënuar me vizën e kuqe.
5 Kur çoheshin lart të ndaluarit përmes asaj dera, i merrnin një
6 nga një. I merrnin në pyetje dhe pastaj i rrihnin brutalisht,
7 i keqtrajtonin, i torturonin, siç kemi dëgjuar gjatë gjyqit.

8 Në kompleksin e ndalimit në Zllash të ndaluarit
9 keqtrajtoheshin dhe psikologjikisht. Kjo përfshinte, për
10 shembull, ushtarët hynin aty dhe ju tregonin të ndaluarve të
11 tjerë trupin e lënduar shumë të një viktime, i cili më vonë
12 pastaj u vra.

13 Në këtë kompleks kushtet e ndalimit ishin shumë të
14 këqija, çnjerëzore. Viktimat detyroheshin të flinin në shesh
15 në këtë stallë kafshësh, nuk i jepnin ushqim të mjaftueshëm
16 dhe ujë, mbaheshin në kushte jashtëzakonisht jo sanitare. Nuk
17 ju ofrohej asnjë kujdes shëndetësor për të mjekuar plagët e
18 shkaktuara nga i akuzuari dhe vartësit e tij gjatë seancave të
19 shpeshta të marrjes në pyetje dhe të torturave. Nuk lejoheshin
20 vizita të familjarëve.

21 Dhe çfarë roli luajti Salih Mustafa në të gjithë këtë?
22 Provat vërtetojnë se ai vetë mori pjesë në keqtrajtim dhe
23 mbikëqyri atë në këtë kompleks. Dy dëshmitarë në veçanti, 1679
24 dhe 3593, e përmendën me emër të akuzuarin si person që merrte
25 pjesë drejtpërdrejt në pyetjet dhe rrahjet e tyre.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 32

1 Të kujtojmë së pari provat, dëshminë e Dëshmitarit
2 W01679. Ky dëshmitar, pasi u çua në këtë kompleks nga ushtarët
3 e BIA-s, u mor në pyetje nga komandant Cali. Pra, i akuzuari
4 Salih Mustafa. Komandant Cali e akuzoi se ishte gënjeshtar, i
5 bërtiti, e mallkoi dhe e qëllloi dhe e rrahu përpara sesa ta
6 linte në duart e ushtarëve që e rrahën derisa ai humbi
7 vetëdijen.

8 I akuzuari mori pjesë gjithashtu në rrahjet, keqtrajtimin
9 e Dëshmitarit 3593. Kjo ndodhi pas pak mbasi dëshmitari u çua
10 në këtë kompleks dhe u çua në stallë. Pak kohë pas kësaj, e
11 tërhoqën tre-katër veta e nxorën nga stalla e çuan në një
12 ndërtesë dhe aty e rrahën egërsisht. Me grushte, me shkelma, e
13 kanë dëmtuar në kokë dhe në dhëmbë disa herë, humbi vetëdijen
14 gjatë këtyre rrahjeve.

15 Këta njerëz e shanin, e akuzonin se ishte bashkëpunëtor i
16 serbëve. Rrahjet, të cilat vazhduan për një kohë të gjatë,
17 përfunduan kur një burrë me një kapele të kuqe, i cili ishte i
18 pranishëm gjatë këtyre rrahjeve dhe të cilin dëshmitari e
19 identifikoi si i akuzuari, nxori një revolver dhe ia vuri në
20 kokë dëshmitarit dhe e shkrepiti. Arma bëri zhurmë por nuk shtiu
21 dhe pastaj i akuzuari tha: "Lëreni. Qenka me fat".

22 I akuzuari pastaj e mori në pyetje Dëshmitarin 3593 një
23 javë më pas. Kësaj here i akuzuari përsëri njihej nga bereta e
24 kuqe, e pyeti, i bëri pyetje 3593 për hajdutë dhe e rrahu
25 pastaj me shkop bejzbolli.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 33

1 Më tej, dëshmitë provojnë se i akuzuari ka qenë në
2 kompleksin e Zllashit kur viktima, më pas i vrarë, u çua aty.
3 Dëshmitarët e mbijetuar 1679, 3593, 4669 dhanë dëshmi provuese
4 që provojnë që ato që ndodhën aty çuan në vrasjen e këtij
5 dëshmitari. Dëshmuan për torturat e bëra aty dhe për faktin që
6 ai dëshmitar u mbajt aty kur të tjerët u liruan në kohën që do
7 të ndodhte ofensiva serbe në 18 prill apo në atë kohë.

8 Këta dëshmitarë gjithashtu dëshmuan se herën e fundit që
9 e panë viktimën e vrasjes ishte në një gjendje të tmerrshme,
10 pothuaj i vdekur për sa i takon gjendjes fizike. Trupi i këtij
11 viktime u gjet më vonë në një varr të cekët shumë afër
12 kompleksit të ndalimit në Zllash.

13 Kolegu im, z. De Minicis do të trajtojë pikën katër të
14 Aktakuzës, vrasje, në prezantimin që do të bëjë më vonë gjatë
15 ditës së sotme.

16 Në vetvete, të nderuar Gjykatës, provat e dhëna nga
17 dëshmitarët vërtetojnë të gjitha elementët që kanë të bëjnë me
18 akuzat që janë ngritur në Aktakuzë përtej dyshimit të
19 arsyeshëm. Dëshiroj sot që të flas për provimin që vjen nga i
20 akuzuari vetë edhe nga viktimat deri në faktin që ato kanë
21 qenë plotësuese të njeri-tjetrit. Do flasim gjithashtu edhe
22 për dëshmitë e personave të tjerë në këtë çështje dhe
23 gjithashtu, do të cekim edhe dokumente të tjera shkresore të
24 cilat nuk janë trajtuar shprehimisht në këtë çështje.

25 Do të filloj fillimisht me deklaratën e të akuzuarit. Dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 34

1 në këtë kuadër do të cek së pari disa prej pranimeve që ai ka
2 bërë personalisht.

3 Siç e dimë, z. Mustafa është intervistuar nga Zyra e
4 Prokurorit të Specializuar si i dyshuar. Ai ka pasur një
5 avokat të pranishëm gjatë intervistimit dhe është këshilluar
6 lidhur me të drejtat e tij, përfshirë këtu edhe të drejtën për
7 të mos folur, pra, për të qëndruar i heshtur. Le të
8 transmetojmë një sekuençë të shkurtër të intervistës ku i
9 akuzuari thotë që e ka dhënë këtë dëshmi me vullnetin e vet.

10 [Luhet videoincizimi]

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Siç mund ta shihni dhe ta
12 dëgjoni, z. Mustafa konfirmoi që ai nuk kishte kundërshtime
13 lidhur me mënyrën sesi ishte kryer intervista dhe mënyrën sesi
14 ishte marrë dëshmia e tij.

15 Përpara se të kalojmë në aspekte të rëndësishme të
16 pranimeve të tij, mendoj se ne duhet t'i japim përgjigje një
17 pyetjeje: Si duhet ta vlerësojmë ne deklaratën e z. Mustafa?

18 Kur vlerësohet intervista e tij me ZPS-në dhe kur
19 krahasohet përmbajtja e kësaj dëshmie me provat në çështje, të
20 nderuar Gjykatës, ne do shohim që ai u mundua që të ecte në
21 një shteg shumë të kujdesshëm. Nuk duhet të harrojmë që ai u
22 intervistua në cilësinë e tij si i dyshuar. Si i tillë, ai
23 ndoqi një linjë të kujdesshme ndërmjet të të dukurit kredibël,
24 i besueshëm dhe ndërmjet mospranimit të përgjegjësisë penale.
25 Ai pranoi atë çfarë duhet të pranonte. Ndërkohë që mohoi çdo

1 gjë që duhet të mohonte për mospranim përgjegjësie.

2 Ai i pranoi këto fakte se do ishte, për shembull, pranoi
3 faktin që ka qenë në kompleksin e Zllashit gjatë kohës kur
4 janë kryer krimet. Ai pranoi se ishte përgjegjës për BIA-n.
5 Konfirmoi gjithashtu edhe identitetin e anëtarëve konkret të
6 BIA-s. Dhe, të nderuar Gjykatës, në mënyrë domethënëse janë
7 përmendur gjithashtu edhe ushtarët të cilët janë përmendur nga
8 viktimat të cilët kanë marrë pjesë në rrahjet dhe në
9 keqtrajtimin e tyre.

10 Madje z. Mustafa edhe pranoi se ka dëgjuar thashetheme
11 për civilë të cilët janë ndaluar në kompleksin e ndalimit në
12 Zllash, por përfundoi këtu sa i takon këtyre thashethemeve. Ai
13 e dinte këtë gjë dhe tha gjithashtu që, për shembull, njerëzit
14 ishin ndaluar dhe abuzuar në kompleks, por nga ana tjetër kjo
15 ishte një përgjegjësi dhe që nuk mund të anashkalonte z.
16 Mustafa sepse ishte personi që ishte përgjegjës aty.

17 Pranimet që janë bërë prej tij janë domethënëse, por nuk
18 ka dyshim se ato janë më domethënëse sesa seç e ka menduar z.
19 Mustafa në atë kohë dhe jo vetëm kaq por e mbështesin viktimat
20 apo janë provuese për atë çfarë thuhet në lidhje me viktimat
21 dhe janë aspekte shumë të rëndësishme.

22 Le të diskutojmë për këto pranime të tij në më hollësi.

23 Së pari, i akuzuari ka bërë pranime të rëndësishme të
24 cilat kanë të bëjnë me kohën dhe vendin që lidhet me akuzat në
25 Aktakuzë. Ai pranoi se ka qenë në Zllash gjatë periudhës së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 36

1 Aktakuzës. Ai filloi duke shpjeguar se në periudhën nga data
2 25 mars deri më 22 prill 1999, ai ka qëndruar në Zllash. Ai,
3 dhe këtu citoj, "ka fjetur aty gjatë natës dy ose tri herë për
4 disa net" dhe këtu është fundi i citimit. Ai thotë konkretisht
5 që është larguar nga Zllashi në një pikë të caktuar kohe në
6 periudhën nga 12 deri në 14 prill 1999 dhe e konfirmon që ka
7 qenë i pranishëm në Zllash përpara kësaj date.

8 Më konkretisht, ajo çfarë thotë i akuzuari është që ai ka
9 qenë atje, citoj, "ndoshta 15 ose 20 ditë përpara ofensivës"
10 dhe e mbyll citimin këtu, gjë e cila, sipas tij, ka filluar
11 ose më datë 16 prill 1999 ose rreth asaj date.

12 Së dyti, i akuzuari pranon praninë e tij jo vetëm në
13 Zllash, por, konkretisht, në kompleksin e ndalimit në Zllash
14 duke konfirmuar se kur ka qenë në Zllash ai ka qëndruar në një
15 prej ndërtesave të kompleksit të ndalimit në Zllash. Ai
16 konfirmoi se disa ushtarë të BIA-s qëndronin në Zllash dhe se
17 ata përdornin një shtëpi të sigurtë në kompleksin që ne pamë
18 në ekran dhe kompleksin të cilit i referohet ZPS-ja si vendi i
19 ndalimit në Zllash.

20 Pse janë të rëndësishme këto pranime të të akuzuarit
21 lidhur me kohën dhe vendin? Këto janë të rëndësishme, të
22 nderuar Gjykatës, sepse ato përkojnë me njëri-tjetrin dhe për
23 pasojë bazojnë dhe provojnë provat dhe të dhënat e dhëna nga
24 Dëshmitari 1679 dhe 3593 lidhur me fillimin e prillit të vitit
25 1999, kur ata e kanë parë të akuzuarin në Zllash dhe faktin që

1 ai është identifikuar, pra, atje në Zllash nga viktimat. Dhe
2 flitet për të njëjtin vend për ekzaktësisht të njëjtin vend ku
3 të akuzuarit thonë që janë marrë në pyetje dhe janë
4 keqtrajtuar nga i akuzuari.

5 Pra, e dimë nga dëshmia e të akuzuarit që ai ka qenë i
6 pranishëm atje.

7 Pranimet e z. Mustafa lidhur me vendin dhe kohën përkojnë
8 me njëra-tjetrën dhe mbështesin apo provojnë provat lidhur me
9 faktin se kur dhe ku viktima i vrarë është dërguar në
10 kompleksin e ndalimit në praninë e të akuzuarit.

11 Për ta përmbledhur, të nderuar Gjykatës, i akuzuari
12 pranon se ai ka qenë i pranishëm në kompleksin e ndalimit në
13 Zllash në fillim të prillit, në të njëjtën kohë kur
14 dëshmitarët 1679, 3593 dhe 4600 thonë që e kanë parë atë po
15 aty.

16 Tani, pyetja që ngrihet është kjo: Në qoftë se këta
17 dëshmitarë do i kishin sajuar këtë historitë e tyre, tregimet
18 e tyre, si është e mundur që ato do të kishin zgjedhur si kohë
19 kur e kanë parë të akuzuarin në kompleksin e ndalimit në
20 Zllash datën ose kohën ekzakte që i akuzuari vetë ka pranuar
21 se ka qenë atje? Në qoftë se ata do ta sajnin të gjithë këtë,
22 si do të ishte e mundur që ata ta dinin që z. Mustafa do të
23 kishte qenë atje gjatë asaj kohe? Dhe përgjigja për këtë
24 pyetje është që nuk është e mundur që ta dinin një gjë të
25 tillë. Probabiliteti i një ko incidence të tillë është zero dhe

1 është diçka që nuk ndodh objektivisht në realitet.

2 Fakti që i akuzuari pranon që ka qenë i pranishëm në KNZ
3 në kohën që ai thotë është një bazë mbështetëse e fuqishme për
4 sa i takon vërtetësisë së dëshmisë së viktimave dhe
5 dëshmitarëve.

6 Do të kaloj në një tjetër pikë të rëndësishme që ka vlerë
7 për çështjen. I ndaluari thotë, që ka qenë përgjegjës për BIA-
8 n. Pra, dhe i akuzuari ka qenë i vetëm komandant i BIA-s gjatë
9 gjithë ekzistencës së këtij njësie. Ai ka qenë autoriteti më i
10 lartë i njësisë, siç e ka shprehur edhe vetë dhe këtë, në
11 fakt, mund ta shikojmë edhe në diapozitivin e dhënë. Ai është
12 shprehur: "... shtabi isha unë".

13 I akuzuari kishte fuqinë që të caktonte vartësit e tij
14 në detyra të ndryshme përfshirë këtu zëvendësin e tij, shefat
15 e sektorëve dhe të merrte masa disiplinore kundër tyre.
16 Kompetencat e tij komanduese transmetoheshin përmes urdhrave
17 dhe që ekzekutoheshin. Kemi disa shembuj të këtyre urdhrave,
18 përfshirë edhe një sulm mbi serbët në vitin 1999, që të
19 akuzuarit e diskutojnë në intervistën e tyre.

20 Përsëri, pse janë të rëndësishme këto pranime? Janë të
21 rëndësishme sepse pranimet e z. Mustafa sa i takon rolit të
22 tij dhe sa i takon komandës që kishte mbi ushtarët e BIA-s
23 përkojnë me dëshmitë e dhëna nga shumë dëshmitarë, në veçanti,
24 dy dëshmitarë specifik. I akuzuari thotë që të tjerët i
25 drejtoheshin atij si "komandant". Dhe ai ka ushtruar

1 autoritet, siç e thonë dhe të tjerët, mbi ushtarët e pranishëm
2 në Zllash, mbi ata ushtarë të cilët kanë qenë të përfshirë në
3 abuzimin dhe torturën e të ndaluarve.

4 Përsëri, kjo është një provë mbështetëse e fortë e të
5 dhënave të cilat janë ndarë me ne nga dëshmitarët. Dhe nga ana
6 tjetër rast kjo nuk mund të ishte koincidencë sepse ata nuk e
7 dinin, të ndaluarit nuk e dinin komandant Calin kur ishin të
8 ndaluar në Zllash. Dhe nuk mund të dinin se çfarë kompetence
9 kishte ai gjatë asaj kohe.

10 Një tjetër pohim ose pranim i rëndësishëm i të akuzuarit
11 është që në të vërtetë kishte njerëz që ishin të ndaluar në
12 kompleksin e ndalimit në Zllash. Kur u pyet lidhur me këtë në
13 intervistën me ZPS-në, z. Mustafa tha së pari që e dinte që
14 kishte persona të ndaluar aty dhe mbante mend dy episode:
15 Njëri në fund të marsit në 1999 dhe njërin episod në prill të
16 vitit 1999.

17 Kur u pyet më tej z. Mustafa pohoi gjithashtu që kishte
18 dëgjuar thashetheme që civilë, disa prej tyre pretendoheshin
19 që të ishin hajdutë, mbaheshin të ndaluar në atë çfarë ZPS-ja
20 e quan kompleksi i ndalimit në Zllash dhe ky është vendi ku i
21 akuzuari e tha që kishte qëndruar njëherë në Zllash. Z.
22 Mustafa thotë që ky fakt, domethënë, ndalimi i civilëve nuk
23 ishte sekret. Ai tha që kishte dëgjuar se disa prej këtyre
24 civilëve ishin liruar në prag të ofensivës serbe, por tha që
25 nuk i kishte parë këtë gjë të ndodhte vetë, me sytë e vetë.

1 Shikoni me kujdes sesi i akuzuari tregon shumë kujdes
2 gjatë deklaratës që jep. Ai mundohet që të pohojë aq sa i
3 duhet të pohojë sepse ai e di se qendra e ndalimit nuk ishte
4 sekret, pra, ishte e njohur, ndërkohë që në të njëjtën kohë
5 thekson se nuk është se kishte të bënte fare me ndalimin e
6 civilëve.

7 Pra, çfarë dinte ai faktikisht për viktimat e ndaluara?
8 Çfarë akti ose çfarë roli luante ai për marrjen në pyetje apo
9 keqtrajtimet? Të gjitha këto ai në intervistën e tij i cilëson
10 apo i përshkruan si thashetheme, pra, kemi të bëjmë me një
11 vend dhe vendi ku ai qëndronte ishte dhe vendi ku ishin të
12 ndaluar viktimat dhe dëshmitari.

13 Dhe përsëri edhe kjo mënyrë e të shprehurit të tij është
14 mbështetëse e deklaratave të dhëna nga dëshmitari. Pra, ajo
15 çfarë vërtetohet është që disa prej këtyre civilëve, përfshirë
16 gjithashtu edhe viktimën e mbetur, akuzoheshin se ishin
17 hajdutë dhe pjesa më e madhe e tyre janë liruar më datën 18
18 prill ndërkohë që afrohej ofensiva serbe.

19 Një tjetër pranim a pohim i rëndësishëm i të akuzuarit që
20 mbështet apo provon deklaratat e Dëshmitarit 1679 dhe 3593
21 është që ai ka identifikuar dhe ka thënë me emër tre anëtarë
22 të BIA-s që janë përmendur konkretisht nga këto viktima. Në
23 veçanti, i akuzuari ka pranuar që një person me nofkën Tabuti,
24 kuptimin e të cilit e dëgjuam edhe gjatë procesit gjyqësor, me
25 emrin real Musliu, ishte, në fakt, anëtar i BIA-s. Të nderuar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 41

1 Gjykatës ju e mbani mend që nofka Tabuti është përmendur nga
2 viktimat, nga 01679 dhe nga një tjetër dëshmitar si një prej
3 ushtarëve që ishte në Zllash.

4 Kemi dy ushtarë të tjerë të cilët janë konfirmuar nga i
5 akuzuari si anëtarë të BIA-s ish-in Brahim Mehmetaj, që quhej
6 ndryshe Bimi dhe Ilmi Vela apo Vdekja. Përsëri emrat e tyre
7 janë përmendur nga një prej viktimave W01679 ndërmjet
8 ushtarëve që ishin në Zllash.

9 Të nderuar Gjykatës ju e mbani mend që Dëshmitari 01679
10 madje edhe e njohu Bimin.

11 Identifikimi i këtyre tre individëve në mënyrë të pavarur
12 nga viktimat nga njëra anë dhe i akuzuari në anën tjetër
13 përsëri është një provë e fuqishme e vërtetësisë së dëshmisë
14 së dhënë nga viktimat. Në qoftë se ata do ta sajnin historinë
15 e tyre, siç do të pretendohet nga Mbrojtja, a do të ishte e
16 mundur që ata konkretisht të jepnin emrin e personave që
17 kishin marrë pjesë në abuzimin e tyre apo personat të cilët
18 ishin të pranishëm në intervistimin e tyre apo të pohonin që
19 ata të ishin anëtarë të BIA-s? Çfarë mundësie do të kishte që
20 të ndodhte një gjë e tillë? Mundësia ishte zero.

21 Dhe viktimat, në fakt, i kanë dhënë këto emra sepse këto
22 janë persona të cilët kanë qenë konkretisht në qendrën e
23 ndalimit në Zllash. Janë persona, emrat e të cilëve viktimat i
24 kanë mbajtur mend dhe për të cilët kanë dhënë dëshmi në mënyrë
25 shumë kurajoze. Dhe, siç e thashë, Dëshmitari 0179 e ka njohur

1 edhe fizikisht Bimin.

2 Një tjetër gjë që doja të sillja në vëmendje, këtë pikë
3 që ja vlen që të theksohet, është që ndërkohë që i akuzuari
4 pohon që Bimi ka qenë anëtar i BIA-s, ai ka bërë çdo gjë të
5 mundur gjatë intervistimit për të zbehur rolet e tij duke i
6 mbrojtur si atë edhe veten. Nuk ka dyshim që ai e dinte sesi
7 bashkëpunëtori i ngushtë i tij, çdo përgjegjësi për krimet mbi
8 të, mund të binte edhe mbi të, duke qenë në pozicionin e
9 komandantit të BIA-s.

10 Kjo strategji e të akuzuarit ishte veçanërisht e dukshme
11 sa i takon zëvendësit të tij, z. Mehmetaj, që njihet ndryshe
12 me emrin Bimi, që z. Mustafa mundohej që ta hiqte nga skena
13 dhe duke pretenduar që Bimi nuk ishte asnjëherë ose ka qenë
14 shumë rrallë në Zllash. Pra, kjo ishte një strategji për
15 shpëtimin e vetes. Citoj këtu atë çfarë ka thënë z. Mustafaj:

16 "Bimi nuk ishte. Nuk qëndronte asnjëherë në Zllash.
17 Ndoshta qëndronte një orë ose dy orë, por nuk ka qëndruar
18 asnjëherë gjatë natës në Zllash".

19 Kjo është pjesë e intervistës së bërë nga z. Mustafa.

20 Të nderuar Gjykatës, ju mund ta mbani mend sesa pranë
21 këtij versionit të fakteve të dëshmisë së z. Mehmetaj është
22 dëshmia e bërë prej tij me atë çfarë u tha nga z. Mustafaj.
23 Dhe ai, në fakt, është intervistuar nga ZPS-ja si i akuzuar
24 apo si i dyshuar disa muaj pas dëshmisë së dhënë nga z.
25 Mustafaj.

1 Ai ka thënë që nuk ka qenë asnjëherë, nuk ka qëndruar
2 asnjëherë gjatë në Zllash.

3 Të nderuar Gjykatës, besoj e mbani mend këtë listën e
4 telefonatave që ka paraqitur ZPS-ja nga telefonatat e bëra nga
5 z. Mustafaj. Pra, mund të shikojmë, pra, informacionin që
6 është theksuar në ekran, që tregon që z. Mustafaj edhe Bimi
7 kanë folur një ditë përpara intervistës së z. Mehmetaj me ZPS-
8 në. Më pas kanë komunikuar përsëri vetëm pesë minuta pas
9 përfundimit të intervistës së ZPS-së.

10 Tani do të shikojmë fragmentin përkatës të
11 korrespondencës, thirrjeve të bëra ndërmjet dy personave.

12 Të nderuar Gjykatës, ju e mbani mend që dëshmia e z.
13 Mehmetaj sa i takon kohës kur ai ka qenë, ka ndryshuar në
14 mënyrë thelbësore gjatë marrjes së tij në pyetje dhe dëshmisë
15 së tij në gjykatë. ZPS-ja tregoi në kundërpyetjen e vet sepse
16 ai e ndryshoi atë çfarë kishte thënë në dëshminë fillestare
17 për ZPS-në.

18 Dhe i akuzuari, në fakt, përdori të njëjtën strategji
19 shpëtimi lidhur me Ilmi Velën, i njohur ndryshe si Vdekja, të
20 cilin i akuzuari pretendoi se e ka demobilizuar në mars të
21 vitit 1999, menjëherë pas ngjarjeve të cilat akuzohen në këtë
22 çështje. Pra, në këtë mënyrë, ai i dha z. Vela një alibi që i
23 shkonte për shtat lidhur me atë çfarë kishte ndodhur në Zllash
24 në vitin 1999, në prill të 1999 dhe më tej u distanca nga
25 krimet në të cilat kishte marrë pjesë z. Vela.

1 Përtej këtyre tre individëve të cilët i akuzuari i
2 konfirmon si anëtarë të BIA-s dhe që ishin identifikuar nga
3 viktimat si të pranishëm në Zllash ka dhe dy anëtarë të tjerë
4 të BIA-s emrat e të cilëve lidhen me ngjarjet në Zllash. Këta
5 dy persona janë Dardani dhe Shyti.

6 Dardani u identifikua në gjykim si Kujtim Qerimi.
7 Fotografitë e kohës së luftës të cilat janë sekuestruar në
8 USB-në e z. Mustafa në kohën që u arrestua e tregojnë z.
9 Mustafa së bashku me Dardanin.

10 Më lejoni t'ju jap dy shembuj të këtyre dy fotografive.
11 Le të shohim fotografinë e parë në ekran. Mund ta shikoni z.
12 Mustafa me kapelën e kuqe në mes edhe Dardani është personi në
13 të djathtë të fotografisë. Fytyrat e dy personave që janë në
14 fotografi janë të zbehura por ndërkohë Dardani është personi
15 që është me rrethin blu.

16 Le të kalojmë tek fotografia tjetër. Sërish shikojmë z.
17 Mustafa që është ulur në gjunjë, ndërkohë që Dardani është
18 sërish personi që është me këtë rrethin blu. Sërish, këto
19 fytyrat janë fshirë për të mos identifikuar për publikun.

20 Pra, Dardani identifikohet si një prej autorëve të
21 abuzimeve të ndodhura në Zllash.

22 Le të kalojmë tek Shyti. Muhamet Ajeti, gjatë dëshmisë së
23 tij në Gjykatë dëshmitar i mbrojtjes identifikoi Shytin dhe
24 tha që Shyti ishte anëtar i BIA-s dhe ishte në Zllash në prill
25 të vitit 1999. Të nderuar Gjykatës, besoj e mbani mend që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 45

1 Shyti u përmend gjithashtu nga dëshmitari si një prej rojeve
2 në kompleksin e Zllashit. Dhe e mbani mend besoj, të nderuar
3 Gjykatës, që z. Mustafa e kishte numrin e Shytit në listën e
4 personave të kontaktit të tij në telefonin e tij.

5 Këto identifikime të z. Mustafa me burim në BIA tregojnë
6 për një provim të fortë të vërtetësisë së dëshmitarëve të
7 cilët, në veçanti, dëshmitarët 1679, 3593 dhe 4600. Këta
8 dëshmitarë nuk do të kishin mundësi që të thoshin emrat
9 Tabuti, Ilmi Vela, Dardan, Bimi ose Shyti në qoftë se nuk do i
10 kishin takuar ata në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill
11 të vitit 1999.

12 Tani do të trajtoj një tjetër element që ka të bëjë me
13 pranimet ose pohimet e të akuzuarit.

14 Pohimi i pestë i rëndësishëm i të akuzuarit, i bërë në
15 intervistën përpara ZPS-së, është [se] gjatë luftës në Kosovë
16 ai mbante një kapelë të kuqe. Një kapele e kuqe e cila nuk
17 ishte pjesë e uniformës standarde të BIA-s. Dhe tha gjithashtu
18 se në Zllash nuk kishte asnjë person tjetër, të paktën me sa
19 dinte ai, që njihej me emrin komandant Cali dhe mbante
20 gjithmonë të vënë një kapele të kuqe.

21 Edhe ky pohim, të nderuar Gjykatës, mendojmë se është i
22 rëndësishëm, është domethënës.

23 E mbani mend që Dëshmitari 3593 identifikoi personin që e
24 mori në pyetje dhe e keqtrajtojë atë në Zllash si një person
25 që mbante të vënë në kokë një kapele të kuqe.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 46

1 Kur u arrestua i akuzuari, e vetmja fotografi që mbante
2 në portofolin e tij është fotografia që do të shikojmë tani në
3 ekran. Dhe çfarë mbante në këtë fotografi i akuzuari? Mbante
4 kapelën e kuqe në kokë.

5 Kapela e kuqe ishte një tipar dallues i të akuzuarit, ku
6 ai dukej, dallohej nga pjesa tjetër e anëtarëve të UÇK-së. Për
7 shembull, kjo duket edhe në foton që e kemi tani të paraqitur
8 në ekran që sërish është marrë nga i akuzuari, pra, i është
9 marrë të akuzuarit.

10 Bereta ose kapela e kuqe është një tipar dallues për të
11 dhe kjo është identifikuar gjithashtu edhe nga Dëshmitari
12 03594. Sipas tij kjo e bënte komandant Calin që të dallohej
13 nga pjesa tjetër e ushtarëve. Gjatë dëshmisë së tij në Gjykatë
14 kjo kapele e kuqe u identifikua nga 03594 dhe citoj këtu:

15 "Kjo kapelë ishte si gjithë kapelat e tjera po ishte me
16 ngjyrë të kuqe. Mendoj që ai e mbante kapelën për t'u bërë i
17 dallueshëm nga të tjerët. Ai ishte personi i vetëm që mbante
18 një kapele të kuqe. Askush tjetër nuk mbante kapelë të kuqe"
19 fundi i citimit.

20 Të nderuar Gjykatës, tani do të kaloj tek provimi i
21 elementëve të dëshmive të viktimave dhe dëshmitarëve, mendoj
22 që është momenti i përshtatshëm tani që të bëjmë pushimin.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
24 do bëjmë një pushim. Do mblidhemi sërish për 30 minuta.

25 --- Pauza fillon në orën 10.58

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 47

1 --- Seanca rifillon në orën 11.27

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
3 vazhdojmë me deklaratën mbyllëse të ZPS-së.

4 Përpara se ta bëjmë këtë po shoh që jemi të njëjtët
5 persona këtu.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
8 njëjta gjë edhe për Mbrojtësen e Viktimave. Po.

9 Dhe e njëjta edhe për palën e Mbrojtjes. Dakord.

10 Zyra e Prokurorit të Specializuar, ju e keni fjalën.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
12 Gjykatëse.

13 Do të vazhdoj tani me dëshmitë të cilat mbështesin njëra-
14 tjetrën siç janë paraqitur gjatë çështjes sonë.

15 Tani do të kaloj tek mënyra se si dëshmitarët kanë
16 dëshmuar dhe dëshmitë e tyre kanë provuar njëra-tjetrën. Së
17 pari, viktimat kanë konfirmuar që e kanë parë njëri-tjetrin në
18 kompleksin e ndalimit në Zllash në prill të vitit 1999 në
19 dëshmitë e tyre dhe kanë shpjeguar se çfarë kanë ditur për
20 njëri-tjetrin. Për shembull, W01679 ka parë gjashtë të ndaluar
21 të tjerë, përfshirë viktimën e vrasjes, W03594, W03593, W04669
22 dhe një të ri i cili e kishte emrin Burmak.

23 E dyta, viktimat kanë dhënë rrëfime të ngjashme për sa i
24 përket mënyrës se si janë arrestuar dhe dërguar në kompleksin
25 e ndalimit në Zllash, ata vetë dhe të ndaluarit e tjerë që

1 kanë takuar atje. Për shembull, 1679 dhe 3593 në mënyrë të
2 pavarur kanë dhënë të njëjtin informacion lidhur me W03594 dhe
3 arsyet e arrestimit të tij. I njëjti informacion është dhënë
4 nga W035974 vetë, kur ka dhënë dëshmi.

5 E treta. Të gjitha viktimat të ndaluar në Zllash kanë
6 përshkruar në mënyrë të ngjashme vendin e ndalimit të tyre, e
7 kanë njohur atë në fotografitë të cilat i kanë parë gjatë
8 dëshmisë përpara Trupit Gjykues. Përshkrimet e tyre përkatëse
9 janë në përputhje me atë që është dhënë, për shembull, nga
10 Dëshmitari i Mbrojtjes, Selatin Krasniqi, siç e thamë, anëtar
11 i BIA-s dhe një i afërm i pronarëve të kompleksit të Zllashit.

12 Për shembull, pjesa e brendshme e ndërtesës ku janë marrë
13 në pyetje dëshmitarët është përshkruar nga 01679 që përputhet
14 me përshkrimin që ka bërë Selatin Krasniqi kur ka përshkruar
15 të njëjtën ndërtesë, në veçanti katin e sipërm, atë që ne e
16 pamë me vija vertikale në derë. Ato kanë thënë se si pjesa e
17 sipërme përbehej nga dy dhoma, një në secilën anë të
18 korridorit.

19 E katërta. Viktimat kanë mbështetur njëri-tjetrin edhe
20 për sa i përket gjendjes fizike të tyre dhe kanë përshkruar në
21 mënyrë të ngjashme edhe llojin, edhe tipin e keqtrajtimit dhe
22 torturës që ka marrë viktima i cili më vonë është vrarë, si
23 dhe gjendjen e tmerrshme në të cilën është mbajtur dhe në të
24 cilën e kanë parë.

25 E pesta. Dëshmitarët kanë dhënë dëshmi për përdorimin e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 49

1 të njëjtave mjete abuzimi. Për shembull, edhe W03593 edhe 1679
2 thanë që janë rrahur me një shkop bejsbolli. W01679 është
3 djegur me një hekur të nxehtë dhe 03593 ka vërejtur shenja të
4 djegies në trupin e viktimës që është vrarë më vonë.

5 [Dëshmitari] 1679 vetë i është nënshtruar sulmit me rryme
6 elektrike. Dhe 3593 ka thënë që ka dëgjuar nga të tjerët se si
7 keqbërësit kanë përdorur rrymën elektrike si mjet torture.

8 E gjashta. W03593 dhe W01679 kanë identifikuar një numër
9 të anëtarëve të BIA-s që të kenë qenë të pranishëm në
10 kompleksin e ndalimit të Zllashit dhe kanë marrë pjesë në
11 rrahjen e tyre. Siç e kam thënë edhe më parë, të gjitha
12 viktimat, 3593 dhe 1679, kanë identifikuar një njeri me nofkën
13 Tabuti. [Dëshmitari] 1679 ka përmendur po kështu edhe Ilmi
14 Velajn, i njohur ndryshe edhe si Vdekja, si dhe Afrimin,
15 Dardanin, Bimin dhe Fatmirin. Këta të gjithë ishin anëtarë të
16 BIA-s, siç ka konfirmuar i akuzuari, si dhe siç kemi dëgjuar
17 edhe nga dëshmitë e tjera, përfshirë W04600, Ahmet Ademin dhe
18 Brahim Mehmetaj i njohur si Bimi. Hollësitë e të gjitha këtyre
19 gjenden në dosjen përfundimtare të ZPS-së.

20 Më tej, Dëshmitarët W01679, 3593 dhe 3594 kanë bërë
21 përshkrime pothuajse identike të momentit të lirimit të tyre
22 nga kompleksi i ndalimit të Zllashit, rreth datës 18 apo 19
23 prill 1999. Për shembull, ato kanë konfirmuar rendin në të
24 cilin janë liruar si dhe faktin që një i ri me emrin Burmak
25 dhe viktimat e vrasjes ishin ata të cilët nuk janë liruar. Ata

1 kanë dhënë po kështu dëshmi të përputhshme lidhur me një
2 vizitë që ata kanë bërë menjëherë mbas lirit të tyre.

3 Si përfundim, të nderuar Gjykatës, në shumë pika viktimat
4 mbështesin njëri-tjetrin. Duhet të kujtojmë që të gjitha
5 viktimat i kanë dhënë dëshminë e tyre në mënyrë të pavarur nga
6 njëri-tjetri, në kohë të ndryshme dhe duke mos e njohur
7 domosdoshmërisht njëri-tjetrin, apo duke pasur dijeni që
8 tjetri të ketë qenë dëshmitar në këtë çështje.

9 Të besosh që janë të fabrikuara rrëfimet e tyre kërkon që
10 jo vetëm që të gjithë ata e kanë shpikur këtë ngjarje dhe kanë
11 dhënë dëshmi nën betim, por edhe që ata të kenë bashkëpunuar
12 për të gjitha hollësitë përpara se të merreshin në pyetje
13 lidhur me këtë çështje. Dhe kjo është një teori krejtësisht e
14 pabesueshme. Është një lloj komplotesh të cilat në fakt nuk
15 ndodhin në realitetin objektiv.

16 Dhe në fakt nuk përfundon këtu. Jo vetëm rrëfimet e
17 viktimave e kanë mbështetur njëri-tjetrin, por dëshmitë e tyre
18 janë mbështetur edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të
19 kësaj çështje, si edhe nga dëshmitë dokumentare. Për shembull,
20 një numër dëshmitarësh e kanë thënë që i akuzuari ishte në
21 kompleksin e ndalimit të Zllashit gjatë periudhës së
22 aktakuzës. Për shembull, dëshmitari 0466 [sipas përkthimit]
23 dha dëshmi sesi e kishte parë të akuzuarin në kompleks në
24 fillim të prillit 1999, duke mbështetur dëshminë e 1679 dhe të
25 3593.

1 Prania e të akuzuarit edhe në Zllash, edhe në kompleksin
2 e ndalimit në Zllash në prill të 1999, është konfirmuar dhe
3 nga një numër dëshmitarësh të tjerë si Sejdi Veseli, Fatmir
4 Sopi dhe Teuta Hadri dhe Selatin Krasniqi.

5 Për shembull, po marrim vetëm njërin prej tyre. Teuta
6 Hadri dëshmoi sesi e ka parë të akuzuarin një natë përpara
7 ofensivës serbe si dhe në ditën e ofensivës, në kompleksin e
8 ndalimit në Zllash. Kjo është një dëshmi e fuqishme që dëshmon
9 që i akuzuari ishte në kompleksin e ndalimit në Zllash,
10 pikërisht në ditën e lirit të të paraburgosurve.

11 Prania e të akuzuarit, komandanti i BIA-s, tregon që
12 ishte ai që ka vendosur se cilët të burgosur do të duhej të
13 liroheshin dhe cilët nuk do të lejoheshin të largoheshin. Po
14 kështu edhe një numër dëshmitarësh të tjerë kanë konfirmuar
15 identitetin e anëtarëve të BIA-s të përmendur nga 1679 dhe
16 3593 si dhe i akuzuari vetë, siç e kemi diskutuar edhe më
17 parë. Këta dëshmitarë përfshijnë, për shembull, Fatmir Sopin,
18 Sejdi Veselin, 4600, si dhe Dëshmitarin e Mbrojtjes Muhamet
19 Ajeti, i njohur përndryshe edhe si Shyti.

20 Për më tepër, një numër dëshmitarësh, në mënyrë të
21 pavarur, kanë dëshmuar që Salih Mustafa ka pasur komandë e
22 autoritet mbi kompleksin e ndalimit në Zllash. Ato përfshijnë
23 kryesisht Fatmir Sopin, Sejdi Veselin dhe 04600. Këto
24 dëshmitarë kanë konfirmuar që BIA dhe Brigada 153 ishin
25 njësite të veçanta dhe se në kompleksin e ndalimit në Zllash

1 nuk ka pasur ushtarë të brigadës.

2 Lidhur me rolin e BIA-s dëshmi të tjera provuese vijnë
3 nga anëtarë të familjes të cilët kanë mësuar menjëherë pas
4 lirimit të të paraburgosurve, kur dëgjuan që janë mbajtur dhe
5 parandaluar nga Skifterët, që Skifterët ishin ata që kanë
6 drejtuar burgun ku janë mbajtur dhe se të parandaluarit që të
7 gjithë ishin keqtrajtuar atje, përfshirë edhe viktimën i cili
8 më pas është vrarë dhe është trajtuar më keq se të tjerët.

9 Ne e dimë që Skifterët ishte një emër tjetër për njësitin
10 e BIA-s. Vetëm disa orë pas lirimit, viktimat thanë se kush
11 mbante përgjegjësi për ndalimin dhe abuzimin e tyre. Edhe kjo
12 është një provë e fuqishme e dëshmive të viktimave dhe e
13 përgjegjësisë së të akuzuarit për atë që u kishte ndodhur
14 atyre.

15 Dëshmitë që vijnë nga dëshmitarët e Mbrojtjes po kështu
16 mbështesin dëshminë e viktimave lidhur me mundësinë e goditjes
17 me rrymë elektrike në kompleksin e ndalimit në Zllash, që
18 është thënë që është përdorur si mjet torture. Për shembull,
19 dëshmitarja e Mbrojtjes, Ibadete Canolli foli për përdorimin e
20 baterive të makinave në prill të 1999, për të siguruar dritë
21 brenda ndërtesës. Me këtë provohet rrëfimi i dhënë nga 1679
22 për përdorimin e asaj që ai e ka quajtur "kuti të
23 elektricitetit" në kompleksin e ndalimit në Zllash.

24 Më tej kemi dëgjuar të konfirmohet që ka pasur në fakt
25 elektricitet në kompleksin e ndalimit në Zllash në atë kohë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 53

1 Do t'ju kujtohet, të nderuar Gjykatës, se si Dëshmitarja e
2 Mbrojtjes Teuta Hadri ka dhënë dëshmi sesi në atë kohë në
3 kompleksin e Zllashit ka pasur një televizor i cili
4 funksiononte, në prill të 1999.

5 Përveç dëshmive të dëshmitarëve, të nderuar Gjykatës,
6 dëshmia e dëshmitarëve provohet edhe nga provat dokumentare që
7 janë pranuar këtu. Dhe këtu do të diskutojmë një dokument që
8 ne e kemi quajtur lista e të burgosurve.

9 Të nderuar Gjykatës, do të kërkoja që diapozitivat në
10 vazhdim të mos i transmetohen publikut, që t'i shohim këto
11 vetëm brenda sallës së gjyqit.

12 A mund ta konfirmojmë?

13 Dokumenti që shohim në ekran këtu në sallën e gjyqit,
14 është një dokument që është në shqip dhe ka listën e një numri
15 të personave të ndaluar në Zllash në prill të vitit 1999. Këtu
16 mund të shohim në faqen e parë emrat e të burgosurve të cilët
17 janë rrethuar me të kuqe.

18 Po të fillojmë nga koka, emrat përfshijnë viktimën e
19 vrasjes, 3593, 3594, 1679. Ky dokument tregon datën e
20 arrestimit që është në përputhje me atë që kanë deklaruar
21 viktimat, si dhe të dhëna të tjera personale përfshirë emrat e
22 baballarëve, datat e vendet e lindjes, si dhe rezidencën
23 vendin e vendbanimit.

24 Përveç emrit të viktimave, lista provon po kështu dhe
25 aspekte të tjera të dëshmive që kemi dëgjuar nga dëshmitarët e

1 kësaj çështjeje. Për shembull, aty përfshihen emrat e rreth 19
2 të paraburgosurve, të parandaluarve, që përputhet me atë që ka
3 thënë W03593 në dëshminë e tij kur tha që UÇK-ja "Sillnin
4 njerëz çdo natë në atë dhome. Ka pasur deri në 17 persona".

5 E dyta, dokumenti provon dëshminë e W03594.

6 A mund të konfirmoj që edhe diapozitivi tjetër do të
7 shihet brenda sallës së gjyqit? Faleminderit.

8 Të nderuar Gjykatës, do të shihni një faqe tjetër tani të
9 këtij dokumenti në ekran. Dokumenti përfshin atë që duket që
10 janë shënime të marra gjatë marrjes në pyetje të W03594. Një
11 nga përgjigjet e dëshmitarit, siç është mbajtur shënim në krye
12 të shënimit që shihni në ekran, provon faktin që dëshmitari
13 siç ka dhënë dëshmi dhe gjendet në faqen 1034, 1035, që ka
14 takuar një numër personash dhe ka diskutuar me to një numër
15 çështjesh të cilat shfaqen në ekran. Nuk do t'i specifikoj më
16 tutje për shkak të statusit të mbrojtur të informacionit dhe
17 të dëshmitarit. Të nderuar Gjykatës, ju mund ta shihni
18 sidoqoftë këtë edhe në anglisht dhe në shqip, në ekran.

19 Dhe në fund, do të kaloj tani në faqen tjetër dhe të
20 konfirmoj që do ta shohim vetëm në sallën e gjyqit. Është një
21 faqe shënimesh në të njëjtin dokument ku ka një shënim anash
22 që thuhet "Për Calin". Të nderuar Gjykatës, ju mund t'i shihni
23 variantet edhe në anglisht edhe në shqip, në ekranet tuaja.

24 Dokumenti që përfshin listën e dëshmitarëve, tregon një
25 nivel të lartë provues të dëshmisë që kanë dhënë dëshmitarët e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 55

1 kësaj çështjeje. Vërtetësia provohet nga hollësitë e
2 përmbajtjes së këtyre dokumenteve. Këto hollësi mund të ishin
3 përpiluar vetëm nga ata të cilët i kanë burgosur viktimat.

4 Në fakt, viktimat janë mbajtur së bashku si grup vetëm
5 njëherë në jetën e tyre dhe kjo ka ndodhur vetëm kur ishin në
6 Zllash, pra të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash. Kjo
7 listë me informacionin që kemi parë, mund të ishte krijuar
8 vetëm në atë kohë.

9 Dhe në fund, dëshmitë e tjera dokumentare për të
10 mbështetur dëshmitë e dëshmitarëve, janë të dhënat
11 shëndetësore të paraqitura gjatë seancave gjyqësore të cilat
12 provojnë gjendjen shëndetësore të tyre dhe çfarë u kishte
13 ndodhur.

14 Po ju referoj, të nderuar Gjykatës, në paragrafët 186-
15 191.

16 Një tjetër ka të bëjë me dëshmitë shëndetësore të
17 viktimës së Mbrojtjes [sipas përkthimit], e cila është gjetur
18 menjëherë mbas luftës në një nga ndërtesat e kompleksit të
19 ndalimit në Zllash.

20 Ky, në bashkëpunim me dëshminë që kemi dëgjuar për këtë
21 dokument, konfirmon që viktima që është vrarë më vonë, është i
22 mbajtur i ndaluar në këtë kompleks siç kanë dëshmuar 1679,
23 4669, 3593 dhe 3594.

24 Të nderuar Gjykatës, tani do t'ia lë fjalën kolegut tim
25 z. Michalczuk, i cili do të vazhdojë me deklaratën myllëse të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 56

1 ZPS-së, duke diskutuar çështjet e besueshmërisë së dëshmive të
2 paraqitura nga dëshmitarët e Zyrës së Prokurorit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit znj. Prokurore.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem na lejoni 2 sekonda sa
6 të ndryshojmë vendet tona.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit. Z. Prokuror, ju e keni fjalën kurdo që të jeni i
9 gatshëm për të filluar.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ndoshta mund të them në këtë

11 pikë që diapozitivat të cilët duhet të shiheshin brenda Trupit
12 Gjykes ishin të vetmet që donim të ishin të atilla. Të tjerat
13 mund të transmetohen publikisht, lirisht.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më lejoni
15 të kaloj tani tek diskutimi lidhur me përgjegjësinë e të
16 akuzuarit.

17 Përgjegjësia e të akuzuarit për krimet e ngarkuara në
18 këtë aktakuzë, provohet nga dëshmitë e viktimave siç e kemi
19 diskutuar, dëshmi të cilat provohen nga disa grupe të tjera të
20 dëshmive.

21 Së pari, konfirmohen nga vetë ajo që ka pranuar i
22 akuzuari. E dyta, nga dëshmia e secilit prej viktimave që ka
23 provuar dëshmitë e viktimave të tjera. E treta, nga dëshmitë e
24 dëshmitarëve të tjerë, përfshirë Dëshmitarët e palës
25 Mbrojtëse. E katërta, janë konfirmuar nga dëshmitë

1 dokumentare. Dhe së fundmi, janë konfirmuar nga sjellja e të
2 akuzuarit gjatë hetimeve.

3 Më lejoni tani, të nderuar Gjykatës, që t'i kthehem
4 çështjes së viktimave dhe dëshmisë së tyre dhe ta shohim këtë
5 edhe njëherë për të parë çështjen e besueshmërisë së tyre. Të
6 diskutojmë në mënyrë të veçantë dëshminë e dy viktimave, të
7 cilët e kanë identifikuar të akuzuarin dhe kanë thënë që ka
8 qenë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje dhe rrahjeve. Dhe
9 janë dëshmitarët 1679 dhe Viktima 3593.

10 Po filloj me 1679, të nderuar Gjykatës. Ky dëshmitar
11 ishte një viktimë e drejtpërdrejtë e sjelljes penale e të
12 akuzuarit. Ai ka përmendur në vazhdimësi të akuzuarin si Cali
13 apo Komandanti Cali gjatë gjithë deklaratave të tij, duke
14 filluar nga deklarata e tij e parë, ku nofka Cali shfaqet për
15 herë të parë. Ky dëshmitar ka treguar të njëjtën histori që
16 nga fillimi. Edhe në një ambient të frikësimit të
17 dëshmitarëve, ai ka përmendur të akuzuarin që në fillim.

18 Më tej, ky dëshmitar nuk e ka zbukuruar dëshminë që ka
19 dhënë dhe nuk e ka pasuruar me kalimin e kohës, ajo që do të
20 pritej në rast se dikush e fajëson në mënyrë të rreme të
21 akuzuarin. Në fakt, ka dhënë dëshmi që Komandanti Cali
22 personalisht ka marrë pjesë në rrahjen e tij vetëm një herë.
23 Dhe kjo ishte koha kur dëshmitari është dërguar në kompleksin
24 e ndalimit në Zllash, kohë gjatë së cilës ai u ka dhënë urdhra
25 edhe të tjerëve.

1 Dëshmitari 1679 ka dëshmuar se Komandant Cali nuk ishte i
2 pranishëm gjatë gjithë seancave të rrahjeve dhe se në raste të
3 tjera kur ka qenë i pranishëm ai nuk e ka rrahur dëshmitarin,
4 por e ka vëzhguar dhe është tallur me të ndërkohë që shokët e
5 tij po rrihnin 1679.

6 Ky dëshmitar në mënyrë të besueshme dëshmoi se e dinte se
7 kush ishte Komandant Cali për shkak se ushtarët e tjerë i
8 kishin thënë që po e dërgonin atë që të fliste me komandantin.
9 Ky dëshmitar e dinte pasi komandanti është vetë paraqitur me
10 emrin Komandant Cali.

11 Ai e ka kuptuar menjëherë sepse në dhomën ku e ka rrahur
12 ky komandanti, ai i ka dëgjuar të tjerët që e kishin thirrur
13 atë me emrin Cali. 1679 ka shpjeguar po ashtu që të tjerët i
14 drejtoheshin komandantit, "Çfarë të bëjmë, Cali. Çfarë duhet
15 të bëjmë". Ky dëshmitar konfirmoi gjithashtu që viktimat e
16 vrasjes e ka njohur se kush ishte Cali.

17 Dhe përfundimisht, 1679 e ka njohur Calin nga dy
18 fotografitë të cilat ia ka treguar Trupi Gjykues brenda kësaj
19 salle gjyqi.

20 Dëshmia e Dëshmitarit 1679 është po kështu fuqimisht
21 fajësuese, por është po kështu edhe e kufizuar. Ai nuk e ka
22 zbukuruar. Nuk ka pretenduar që i akuzuari ka marrë pjesë në
23 të tëra rrahjet. Mund ta kishte bërë një gjë të tillë po të
24 ishte duke e sajuar atë, siç pretendon tani pala Mbrojtëse.

25 Për me tepër, dëshmia e këtij dëshmitari, 1679, nuk ka

1 ndryshuar gjatë gjithë kohës që ka dhënë dëshmi para sallës së
2 gjyqit dhe ishte në përputhje edhe më deklaratat e tij të
3 mëparshme. Ka pasur disa detaje të cilat nuk i kujtoheshin apo
4 disa mospërputhje të vogla në dëshminë e tij. Kjo është e
5 vërtetë. Me gjithë këtë, është saktësisht kjo që pritet nga
6 një dëshmitar të cilit i kërkohet që të kujtojë çdo hollësi që
7 ka ndodhur më shumë se 20 vite më parë.

8 Për sa i përket gabimeve në deklaratat e mëparshme të
9 dëshmitarit, 1679 ka ngulur këmbë që t'i sqarojë dhe të
10 shpjegojë se çfarë i kujtohej. Për shembull, kur është
11 konfrontuar me disa rrëfime që ishin të ndryshme lidhur me
12 njerëzit të cilët e kanë marrë nga shkolla e Zllashit dhe e
13 kanë dërguar në kompleksin e ndalimit, ky dëshmitar ka
14 shpjeguar që i është kujtuar që nuk [sipas përkthimit] e ka
15 përmendur Bimin edhe në deklaratat e tij të mëparshme. Dhe
16 nguli këmbë dhe tha që deklarata që ishte marrë në atë kohë
17 nuk kishte shënuar pikërisht atë që donte të komunikonte,
18 përfshirë rrethanat e vështira në të cilat kishte dhënë dëshmi
19 dhe si ndjehej në momentin e dëshmisë.

20 Një konfirmim i spikatur dhe i paplanifikuar i aftësisë
21 së dëshmitarit për të identifikuar keqbërësit ka ndodhur në
22 rastin kur Brahim Mehmetaj, Bimi, dha dëshmi këtu në sallë.
23 1679 e ka njohur atë menjëherë si Bimi. I njëjti Bimi i cili
24 kishte marrë pjesë në keqtrajtimin e tij në kompleksin e
25 ndalimit në Zllash, përpara se z. Mehmetaj të pranonte që

1 nofka e tij ishte Bimi.

2 Dëshmitari 1679 atë ditë po i shihte procedurat në
3 televizion dhe e ka njohur menjëherë Bimin sapo u shfaq në
4 ekran. Të nderuar Gjykatës, ju e dini që kjo konfirmohet nga
5 një mesazh me tekst që dëshmitari ka dërguar dhe që është
6 pranuar si dëshmi. Në këtë mesazh, 1679 ka shkruar që e ka
7 njohur Bimin si personi i cili e kishte keqtrajtuar atë në
8 Zllash. Edhe njëherë, ky mesazh është dërguar përpara se z.
9 Brahim Mehmetaj të thoshte në deklaratën e tij që nofka e tij
10 ishte Bimi.

11 Identifikimi i Bimit nga ky dëshmitar 23 vite pas
12 ngjarjeve dhe pa ja kërkuar njeri, mbështet identifikimin e
13 tij se Bimi ishte një nga personat që e ka torturuar. Por, në
14 të njëjtën kohë demonstroi edhe aftësinë e tij për të
15 identifikuar personat të cilët kanë marrë pjesë në abuzimin
16 dhe torturimin e tij, përfshirë të akuzuarin. Ishte ky një
17 test objektiv i aftësisë së dëshmitarit për të kujtuar atë që
18 ka parë dhe që i kujtohej, një test të cilin dëshmitari e ka
19 kaluar me sukses dhe Trupi Gjykses do ta mbajë parasysh kur
20 vlerëson identifikimin që ai i ka bërë të akuzuarit.

21 Të nderuar Gjykatës, tani do të flas lidhur me
22 dëshmitarin e dytë të kësaj çështje, 3593.

23 Ky dëshmitar ka treguar arsyet se përse ishte i sigurt që
24 torturuesi i tij në Zllash ishte vërtetë i akuzuari, që ishte
25 vërtetë ai që quhet Cali dhe si e ka identifikuar.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 61

1 Dëshmitari e ka parë për herë të parë të akuzuarin në
2 Zllash tre herë. Gjatë rrahjes së parë që ka ndodhur në të
3 njëjtën ditë kur është arrestuar dhe dërguar në kompleksin e
4 ndalimit. Më pas gjatë rrahjes së dytë që ka ndodhur disa ditë
5 më pas. Dhe më pas kur i akuzuari, në një pikë të caktuar, ka
6 ardhur në ahur së bashku me disa ushtarë.

7 Gjatë rrahjes së parë, 3593 i ka ngritur sytë lart një
8 herë dhe ka parë të akuzuarin i cili kishte kapelën e kuqe,
9 siç e tha dëshmitari. Edhe po të ishte errësirë, dëshmitari do
10 të kishte qenë në gjendje ta shihte të akuzuarin nga drita e
11 elektrikut, siç e tha edhe vete. Dhe e ka parë që i akuzuari
12 kishte në kokë atë beretën e kuqe të dallueshme, që e kemi
13 diskutuar përpara marrjes së pushimit. Në atë rast i akuzuari
14 nuk ka pasur maskë.

15 Ajo që e ka bërë që 3593 ta kujtonte mirë të akuzuarin
16 ishte përvoja traumatizuese dhe e paharrueshme që ka ndodhur
17 kur i akuzuari i ka vendosur pistoletën në kokë 3593 dhe ka
18 tërhequr këmbëzën. Dëshmitari e ka karakterizuar atë moment si
19 tmerrues dhe e ka përshkruar në të njëjtën mënyrë në të gjitha
20 deklaratat e tij.

21 Të kalojmë tani në rrahjen e dytë të kësaj viktime. Gjatë
22 rrahjes së dytë dëshmitarit i është hequr thesi nga koka dhe e
23 ka parë qartë të akuzuarin. I akuzuari kishte veshur uniformë,
24 edhe këtë herë kishte kapelën e kuqe dhe ishte i vetmi person
25 që e ka rrahur dëshmitarin me një shkop bejsbolli.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 62

1 Dëshmitari po kështu ka dëgjuar nofkën e të akuzuarit,
2 Cali, kur ai ishte në Zllash. Siç e ka shpjeguar, ai e ka
3 dëgjuar një herë kur e kanë dërguar para të akuzuarit. Në atë
4 pikë dikush tha, "Hajde. Hajde, hajde Cali". Dhe po kështu,
5 "Komandant Cali, ç'të bëjmë?". Dëshmitari më pas ka dëgjuar
6 qartë që i akuzuari quhej "komandant". Ai e ka konfirmuar
7 gjithashtu që i akuzuari ishte vërtetë komandant në Zllash një
8 muaj pas lirimit të tij gjatë bisedave me ushtarët e UÇK-së në
9 këtë zonë.

10 Të nderuar Gjykatës, 3593 nuk ka arsye të gënjejë, nuk ka
11 arsye për ta implikuar në mënyrë të rreme të akuzuarin. Nuk e
12 njeh përndryshe të akuzuarin, nuk ka ndonjë paragjykim ndaj
13 tij dhe në fakt ka pasur një stimul të fuqishëm për të mos i
14 treguar emrin komandantit të UÇK-së duke pasur parasysh klimën
15 e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë. Si edhe me dëshmitarin
16 1679, dëshmia e 3593 ishte modeste. Ai nuk ka zbukuruar. Po të
17 donte të gënjente që ta implikonte në mënyrë të rreme të
18 akuzuarin, do ta kishte përmendur të akuzuarin në çdo rrahje,
19 si pjesëmarrës apo mbikëqyrës i torturës së tij apo të tjerëve
20 sa herë që kishte ndodhur. Por dëshmitari nuk e ka bërë këtë.

21 Nuk është përpjekur që të shtojë apo ta përmirësojë
22 historinë e tij për ta bërë atë më fajësuese.

23 Megjithatë, nëse Gjykata do të shqetësohej për faktin që
24 dëshmitari 3593 nuk e ka përmendur të akuzuarin në deklaratën
25 e parë dhënë UNMIK-ut, por e bëri këtë vetëm më pas kur dha

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 63

1 intervistë për ZPS-në në këtë Gjykatë, mund t'ju them se për
2 mendimin tonë, të nderuar Gjykatës, ka disa arsye konkrete dhe
3 bindëse se përse dëshmitari u soll në këtë mënyrë. Këto arsye
4 përfshijnë kryesisht frikën. Frikë që buronte nga klima e
5 përhapur e frikësimit e dëshmitarëve dhe pa ndëshkueshmëria e
6 ish anëtarëve të UÇK-së në Kosovë.

7 Që nga fundi i luftës në Kosovë deri sot, ata që ishin të
8 gatshëm të vinin dhe të dëshmonin në lidhje me krimet e
9 pretenduara të kryera nga ish anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare
10 të Kosovës, të gjithë janë përballur me dilema ekzistence: të
11 mos flisnin dhe të vazhdonin të jetonin në botën e
12 gënjeshtreve dhe të frikës me një ndjejë faji që nuk po bënë
13 asgjë apo të kërkonin drejtësi dhe të vërtetën duke u
14 përballur me përbuzjen sociale dhe duke i vendosur veten dhe
15 familjet e tyre në rrezik hakmarrjeje.

16 Zgjedhja e parë, në vështrim të parë, duket më e lehtë.
17 Dhe në fakt ka qenë zgjedhje e shumë prej tyre. Mundësia e
18 dytë, e zgjedhur nga shumë pak, kërkon shumë kurajë,
19 vendosmëri dhe mbështetjen e njerëzve të dashur të tyre. Ata
20 të paktë që guxuan të flisnin, të tregonin të vërtetën, janë
21 përballur me shumë probleme duke qenë se kushtet në Kosovë nuk
22 kanë qenë të tilla për t'i ndihmuar ata të dalin si
23 dëshmitarë.

24 Përpara krijimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës,
25 shumë persona në Kosovë konsideronin se ekzistonte një klimë e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 64

1 përhapur pandëshkueshmërie për krimet e kryera nga UÇK-ja
2 gjatë 1998-1999, ishte një perceptim i përligjur. Dhe është
3 provuar nga një numër i pakët procedimesh të suksesshme. Shumë
4 në Kosovë besonin se ata që kanë marrë pjesë në UÇK ishin ende
5 të fuqishëm në institucionet e Kosovës. Dhe në fakt i
6 kontrollonin ato. Kjo është vënë në dukje nga një nga
7 dëshmitarët, Dëshmitari 4669.

8 Ai dëshmoi se, kur disa vite më parë dikush, një tjetër i
9 ndaluar, iu afrua duke i sugjeruar që të raportojnë atë që
10 kish ndodhur në Zllash, ai e ndjeu se nuk ishte koha e duhur
11 sepse, "Të gjithë institucionet mbaheshin pikërisht nga këta
12 njerëz". Ai shtoi se ai nuk ju besonte institucioneve në atë
13 kohë.

14 Kjo Gjykatë, në këtë rast, ka provuar se është një forum
15 ku dëshmitarë të tillë si 4669 dhe viktimat të tjera, më në
16 fund mund të rrëfenin historitë e tyre. Në këtë drejtim,
17 krijimi i Dhomave të Specializuara ishte një moment i
18 suksesshëm për këta dëshmitarë dhe në një plan më të gjerë për
19 drejtësinë në Kosovë.

20 Mungesa e një forumi nuk ishte në fakt i vetmi faktor
21 ngurues i dëshmitarëve. Një tjetër faktor ishte klima sociale
22 dhe kulturore që vazhdon edhe sot.

23 Në një shoqëri të lidhur ngushtë ku identifikimi dhe
24 besnikëria etnike e tejkalon besnikërinë ndaj shtetit dhe
25 autoriteteve zyrtare, bashkëpunimi me institucionet hetimore

1 kundër ish-udhëheqësve të UÇK-së, sikundër i akuzuari, mund të
2 jetë një anatëmë që bie ndesh fort me normat lokale. Në një
3 klimë të tillë, dëshmitarët që japin dëshmi kundër anëtarëve
4 të UÇK-së, minimumi janë përballur me largim social,
5 përjashtim social.

6 Një element tjetër që i ka dekurajuar shumë dëshmitarët
7 dhe viktimat të flisnin, ishte fakti se shumë prej tyre ishin
8 etiketuar, edhe pa prova, si bashkëpunëtorë dhe spiunë serb.
9 Në periudhën pas lufte ky klasifikim ishte jashtëzakonisht i
10 rrezikshëm për personat në fjalë. Edhe mbas 23 vitesh, kjo gjë
11 habitshëm është ende e fortë dhe e vlefshme, sikurse është
12 vënë në dukje shumë mirë nga dëshmitari 4676. Dhe ju e keni
13 pikërisht tani në ekran. Ky dëshmitar ka thënë:

14 "Frika ekziston gjatë gjithë kohës, po. Dhe është njëfarë
15 keqkuptimi. Është një frikë për t'u vënë në dukje, frikë për
16 t'u treguar me gisht, frikë për t'u etiketuar tradhtar,
17 bashkëpunëtor, një person që u do të keqen të tjerëve, dikush
18 që ka tradhtuar vlerat e lirisë dhe vlerat e luftës. Dhe kjo
19 del nga një perceptim që ekziston midis nesh".

20 Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, të nderuar
21 Gjykatës, fakti që Dëshmitari 3593 nuk e përmendi të akuzuarin
22 në deklaratën dhënë UNMIK-ut nuk duhet mbajtur kundër tij dhe
23 nuk duhet të këtë ndonjë ndikim të rëndësishëm në
24 besueshmërinë e përgjithshme të tij, përfshirë dhe
25 identifikimin e të akuzuarit. Sikundër ai vuri në dukje qartë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 66

1 në deklaratën dhënë UNMIK-ut dhe e keni citimin në ekran:

2 "Doja të jepja menjëherë një dëshmi - tha ai dëshmitar - kur u
3 lirova, por për sigurinë e fëmijëve të mi dhe të vetes sime,
4 nuk i dhashë dëshmi askujt."

5 Dëshmitari, atëherë, guxoi ta fajësonte të akuzuarin
6 vetëm kur u ndie më i sigurt. Më i sigurt, të nderuar
7 Gjykatës. Jo i sigurt. Më i sigurt. Sepse edhe sot, pas 23
8 vitesh, kur ai dëshmoi në këtë Gjykatë përpara Panelit të
9 Dhomave të Specializuara të Kosovës, frika e dëshmitarit ishte
10 ende e dukshme.

11 Juve iu kujtohet, të nderuar, refuzimi i tij i
12 vazhdueshëm të përmendte emrin mbiemrin apo dhe pseudonimin e
13 të akuzuarit. Edhe kur vizatimi i tij i dhënë ZPS-së iu tregua
14 në Gjykatë me emrin Cali të shkruar qartësisht në të, ai
15 vazhdoi të refuzonte të konfirmonte se fjala Cali ishte
16 shkruar aty. Përkundrazi ai tha: "Nuk e di. Nuk e mbaj mend".

17 Kur Prokurori që po i bënte pyetjet ia tregoi dy herë, ai
18 tha:

19 "Po, e kuptoj. Ky është emri i të akuzuarit. Pra, unë nuk
20 dua t'ia përmend emrin. E thashë edhe dje këtë dhe nuk dua që
21 ta përmend kurrë emrin e atij sa të jem gjallë".

22 Të nderuar, Dëshmitari 3593, a ju dukej se ishte një
23 dëshmitar që po e shtonte dëshminë e tij? A ishte ai që po e
24 implikonte në mënyrë të rreme të akuzuarin? Jo. Ai ishte një
25 dëshmitar që nguronte dhe që kishte frikë, i cili nuk donte të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 67

1 implikonte askënd në deklaratat e tij fillestare dhe vetëm
2 arriti të tregonte historinë e tij të vërtetë para kësaj
3 Gjykate.

4 Ju duhet të merrni parasysh, të nderuar Gjykatës, lidhur
5 me këtë dëshmitar, provat e rëndësishme që dilnin nga sjellja
6 e të akuzuarit gjatë hetimeve. Kjo sjellje tregon fuqimisht
7 përfshirjen e tij në krimet për të cilat akuzohet. Emri i
8 Dëshmitarit 3593 dilte edhe në një mesazh të dërguar nga një
9 bashkëpunëtor i të akuzuarit, të akuzuarit vetë. Ky mesazh u
10 dërgua pak kohë pasi Salih Mustafa u thirr për intervistë nga
11 ZPS-ja.

12 Përse ka rëndësi ky fakt? Ky komunikim? Ai është i
13 rëndësishëm sepse tregon se i akuzuari e dinte se 3593 ishte
14 një dëshmitar i mundshëm kundër tij në atë kohë. Është e
15 rëndësishme sepse tregon se i akuzuari e dinte se 3593 ishte
16 ndaluar dhe abuzuar në qendrën në Zllash.

17 T'jua shpjegoj më me hollësi këtë gjë. Në 16 tetor 2019,
18 i akuzuari mori një fletëthirrje për t'u paraqitur para Zyrës
19 së Prokurorisë për një intervistë në cilësinë e një të
20 dyshuari. Katër ditë më pas, më 20 tetor 2019, bashkëpunëtori
21 i të akuzuarit i dërgoi një komunikim me telefon celular ku
22 përmbahej emri dhe mbiemri i Dëshmitarit 3593. Ishte kjo vallë
23 një ko incidencë, të nderuar Gjykatës? Kjo ka shumë gjasa të
24 mos jetë e vërtetë. Në fakt, është e pamundur.

25 Ta them pak më thjeshtë. [Dëshmitari] 3593 dhe i akuzuari

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 68

1 nuk kishin pasur kontakt pas luftës dhe nuk kishte ndonjë
2 lidhje midis të dyve përveçse burgosjes dhe torturave që 3593
3 iu nënshtrua nga i akuzuari dhe ushtarët e BIA-s. Për më
4 tepër, ZPS-ja e kishte intervistuar fshehurazi 3593 disa javë
5 përpara këtij komunikimi me telefon dhe i akuzuari në këtë
6 moment nuk kishte si të dinte për këtë intervistë.

7 Kështu që shpjegimi i vetëm i arsyeshëm që emri i 3593
8 del në mesazhin me tekst që përmenda, është se i akuzuari dhe
9 bashkëpunëtorët e tij, nga njëri-tjetri e dinin se ky
10 dëshmitar ishte viktimë në Zllash dhe se ai mund të ishte një
11 dëshmitar i mundshëm kundër të akuzuarit.

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 Tani dua t'i kthehem dëshmitarit të tretë dhe të diskutoj
19 rëndësinë dhe besueshmërinë e dëshmisë së dhënë prej tij, dhe
20 e kam fjalën për Dëshmitarin 4600.

21 Në dosjen e saj përfundimtare, ZPS-ja përcakton disa
22 elementë të rëndësishëm në lidhje me dëshminë e këtij
23 dëshmitari. Këtu më lejoni të përqendrohem në disa prej tyre.

24 Dëshmitari 4600 dëshmoi se e kishte parë të akuzuarin në
25 Zllash në fillim të prillit 1999, që ishte në fakt, po t'i

1 bashkosh të gjitha të dhënat, i bie të ishte data 1 prill i
2 atij viti. Atë datë, sikurse e dini më së miri, kjo datë ka
3 shumë rëndësi.

4 Dëshmitari 4600 ishte konsistent në rrëfimin e historisë
5 së tij, si gjatë hetimit, ashtu edhe në gjykatë. Rrëfimi i tij
6 lidhur me ngjarjet që ndodhën më 1 prill 1999, ishte i qartë i
7 hollësishëm dhe i mbështetur edhe nga dëshmitarë të tjerë
8 përfshirë 4603, 4390, 4391, 4674 dhe 4648.

9 Dëshmitari 4600, duke e ditur se mund të fajësonte veten,
10 megjithatë e dha dëshminë e tij pa e zbukuruar atë apo pa u
11 orvatur për ta larguar veten nga kjo pikturë, pamje. Nuk ka
12 shpjegim të arsyeshëm se përse ai do të kishte gënjyer lidhur
13 me atë që bëri dhe me përfshirjen e tij në këtë çështje.

14 Dëshmia e këtij dëshmitari konfirmoi gjithashtu se
15 anëtarët e BIA-s përfshinin Dardanin dhe Nazif Musliun, i
16 njohur ndryshe si Tabuti. Përveç këtyre dy anëtarëve të BIA-s,
17 Dëshmitari 4600 identifikoi në veçanti një tjetër ushtar të
18 BIA-s me pseudonimin Shyti që në fakt ishte Muhamet Ajeti,
19 Dëshmitari i Mbrojtjes. Muhamet Ajeti erdhi pikërisht në këtë
20 sallë gjyqi dhe konfirmoi pseudonimin e tij Shyti dhe se ishte
21 anëtar i BIA-s në 1999, se ishte në Zllash në prill të 1999
22 dhe se njerëzit në fakt ashtu e quanin, Shyti.

23 Gjithashtu mund të kujtoni nga dëshmia që vetë dëshmitari
24 dha se ai e quajti z. Ajeti, Shyti dhe se ai e kishte të
25 ruajtur emrin e tij si Shyti AAK.

1 Shkurtimisht, të tre dëshmitarët 1679, 3593 dhe 4600
2 japin dëshmi, që mund të besohen nga kjo Gjykatë, e cila
3 konfirmon praninë e të akuzuarit në kompleksin e ndalimit në
4 Zllash në periudhën e konfirmuar apo pranuar nga vetë i
5 akuzuari.

6 Të nderuar Gjykatës, shumë shkurt dua që në kontekstin e
7 të gjitha dëshmive në këtë çështje, të diskutoj edhe sjelljen
8 e të akuzuarit në këtë hetim. Kam përmendur një episod të
9 kësaj sjelljeje që ka të bëjë me Dëshmitarin 3593, kur emri i
10 tij iu tregua të akuzuarit në mesazhin që iu dërgua atij. Por,
11 përveç këtij episodi, i akuzuari në mënyrë aktive ka ndjekur
12 hetimet lidhur me të dhe ka treguar synimin e tij për të
13 ndërhyrë në këto hetime.

14 Tre shembuj që tregojnë këtë.

15 Shembulli i parë. Pak kohë pas luftës kur u pyet për
16 vazhdimësinë e hetimeve për ngjarjet në Zllash, i akuzuari
17 tha, "Nuk do të ketë çështje. Nuk do të ketë gjyq". Ai shtoi,
18 "Për sa kohë që unë jam këtu, kjo çështje nuk do të eci
19 përpara". Dhe siç parashikoi me të drejtë i akuzuari, në fakt
20 nuk filloi ndonjë çështje. Salih Mustafa në atë kohë ishte
21 oficer i Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

22 Episodi i dytë. Dhe ky ka të bëjë me hetimet e ZPS-së në
23 veçanti. I akuzuari ishte në kontakt të vazhdueshëm me ish-
24 shokun e tij të BIA-s, z. Qerimi, ndryshe Dardani, e ka
25 informuar në kohë reale për zhvillimet në këtë çështje. Të dy

1 këta burra shkëmbejnë mesazhe me njëri tjetrin lidhur me
2 Brahim Mehmetaj, Bimin, i cili sapo ishte thirrur si i dyshuar
3 nga ZPS-ja. Ky shkëmbim tregon se i akuzuari dhe Kujtim Qerimi
4 donin të takoheshin me Mehmetaj përpara se ai të vinte në
5 Hagë. Dhe kështu bënë për të koordinuar dëshmitë e tij me atë
6 të akuzuarit dhe për të penguar hetimet e ZPS-së lidhur me
7 krimet e kryera në kompleksin e ndalimit në Zllash.

8 Episodi i tretë, të nderuar Gjykatës. Pas intervistës së
9 z. Agron Xhemajli, një i dyshuar tjetër në këtë çështje, i
10 akuzuari dhe Kujtim Qerimi folën përsëri. Kujtim Qerimi në
11 komunikimin e tij me të akuzuarin tha, "Ka mënyra për ta
12 trajtuar këtë punë, për ta zgjidhur këtë punë".

13 Të nderuar Gjykatës, sjellja e z. Mustafa gjatë hetimit
14 tregon se ai ishte i vetëdijshëm për fajësinë e tij dhe për
15 provat që e implikonin atë në krimet e kryera në kompleksin e
16 ndalimit në Zllash. Gjithashtu, tregon synimin e tij për të
17 penguar përpjekjet për të shkuar tek e vërteta.

18 Pasi diskutova këtë, tani do të diskutoj me lejen tuaj
19 çështjen e paraqitur nga Mbrojtja, e cila ka të bëjë kryesisht
20 me pretendimin se i akuzuari nuk kishte si t'i ketë kryer
21 krimet në Zllash sepse ka qenë gjetkë gjatë periudhës që
22 mbulon aktakuza.

23 Për të hedhur poshtë çështjen e Prokurorisë, Mbrojtja ka
24 paraqitur disa dëshmitarë të cilët u përpoqën që të akuzuarin
25 ta vendosnin në vende të ndryshme në Kosovë gjatë prillit të

1 '99. Disa prej tyre pretenduan se kishin pasur ndërveprime me
2 të akuzuarin në ditët e para të prillit 1999.

3 Dhe tani dua të jem i qartë që në fillim. Provat e
4 Mbrojtjes nuk provojnë se Salih Mustafa nuk ishte në Zllash
5 gjatë periudhës së mbuluar nga aktakuza. Edhe e marrë në
6 vetvete, veçantë nga provat e ofruara nga Prokuroria dhe nga i
7 akuzuari në pranimet e tij, ai [e pakuptueshme] që ka qenë në
8 Zllash, dëshmitarët e Mbrojtjes nuk bëjnë gjë tjetër veçse
9 tregojnë se Salih Mustafa ka lëvizur nga një vend në tjetër në
10 periudhën e Aktakuzës dhe ka qenë në atë kohë në vende të
11 tjera përveç Zllashit, si në Prishtinë, Butovc apo në
12 Barilevë.

13 Megjithatë, të gjitha këto vende janë të qasshme nga
14 Zllashi, aty mund të shkohet shumë shpejt nga Zllashi dhe nuk
15 ka prova se i akuzuari nuk ka qenë në Zllash në momente
16 kritike që mbulohen nga aktakuza, apo se nuk është penalisht
17 përgjegjës për krimet e akuzuara në aktakuzë nëpërmjet formave
18 të shumta të përgjegjësisë.

19 Është e vërtetë se duke lëvizur në këtë zonë gjatë
20 prillit, ishte një kohë e vështirë për shkak të pranisë së
21 herëpashershme të forcave serbe dhe të karakteristikave
22 topografike të terrenit. Megjithatë, provat tregojnë
23 gjithashtu se i akuzuari megjithatë ishte në gjendje të
24 lëvizte në këtë zonë gjatë asaj kohe.

25 Ne e dimë se i akuzuari kishte qasje në automjete që ai i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 73

1 ka përdorur për të kaluar nga një vend në tjetrin. Për
2 shembull, Dëshmitarët Bislam Nreci dhe Avni Gashi, konkretisht
3 vunë në dukje se në prill të 1999, i akuzuari lëvizte me një
4 Golf Wolkswagen 2. Gjithashtu Dëshmitari Nazmi Vrbovci dhe
5 Fatmir Humolli përmenden se i akuzuari përdorte një veturë.
6 Sikundër konfirmohet nga Teuta Hadri dhe nga vetë Salih
7 Mustafa, në prill të 1999 kishte automjete dhe mjete të tjera
8 transporti në Zllash, që si komandant i BIA-Serbisë, i
9 akuzuari sigurisht ka pasur qasje në to.

10 Salih Mustafa kishte mundësi gjithashtu të shkonte nëpër
11 zonë në këmbë. Ai e njihte zonën mjaft mirë sepse shpesh
12 dërgonte furnizime në vendndodhje të ndryshme të UÇK-së.
13 Gjithashtu është angazhuar me shoqërimin e zyrtarëve të UÇK-së
14 dhe të plagosurve brenda kësaj zone. Për të gjitha këto arsye,
15 mundësia e të akuzuarit për të lëvizur nga një vend në tjetrin
16 me makinë apo në këmbë, është e padiskutueshme.

17 Më lejoni, të nderuar Gjykatës, të kaloj tani tek një
18 vlerësim i shkurtër i rrëfimeve individuale të dëshmitarëve të
19 Mbrojtjes. Për të mos përsëritur dëshminë e tyre, do të
20 përqendrohem jo shumë në rrëfimet e tyre, se sa në
21 besueshmërinë e tyre.

22 Në disa raste, një besueshmëri e tillë ishte dukshëm e
23 ndikuar nga një anësim jo vetëm në favor të të akuzuarit, por
24 edhe kundër kësaj Gjykate. Përse paragjykimi ndaj kësaj
25 Gjykate është kaq i rëndësishëm? Është i rëndësishëm sepse ai

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 74

1 ndikon në besueshmërinë e dëshmitarëve të Mbrojtjes ku eksiton
2 në shkallë të tillë që minon çdo detyrim që këto dëshmitarë
3 mund të kenë ndjerë për të dhënë dëshmi të vërtetë përpara
4 kësaj Gjykate.

5 Dy dëshmitarë të Mbrojtjes, Fatmir Humolli dhe Ahmet
6 Ademi, u paraqiten për të demonstruar se janë takuar me Salih
7 Mustafën në Prishtinë më 1 prill 1999. Të nderuar, ju e keni
8 venë re sesi kjo datë u bë e rëndësishme gjatë gjykimit.
9 Posaqë Prokuroria provoi se ngjarje kritike të rëndësishme
10 ndodhën pikërisht atë ditë, ku përfshihej vetë i akuzuari,
11 provat e dëshmitarëve të Mbrojtjes filluan të evoluonin nga
12 deklaratat e mëparshme dhe befas në Gjykatë dëshmitarët
13 pretendonin të kujtonin gjëra shumë konkrete lidhur me atë
14 datë, gjë që s'kishte ndodhur më parë.

15 Me gjithë përpjekjet më të mira të këtyre dëshmitarëve,
16 provat e tyre, dëshmia e tyre nuk provon se i akuzuari nuk ka
17 qenë në Zllash në datën 1 prill 1999.

18 Dëshmitari i Mbrojtjes Fatmir Humolli pretendoi se ka
19 qenë me të akuzuarin në Prishtinë gjatë një dite, rreth 1
20 prillit 1999. Sipas këtij dëshmitari, të dy u larguan nga
21 Prishtina më 1 prill në mëngjes herët dhe pastaj arritën në
22 fshatin Barilevë ku u ndanë në një moment në pasdite. Por kjo
23 dëshmi e këtij dëshmitari nuk është e besueshme.

24 Fatmir Humolli ishte i pasigurt lidhur me datat e këtyre
25 ngjarjeve. Ai vuri në dukje data të ndryshme gjatë dëshmisë së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 75

1 tij në gjykatë dhe data të ndryshme në deklaratat që ai i dha
2 ZPS-së dhe Mbrojtjes gjithashtu. Siç e pranoi vetë, ky
3 dëshmitar nuk ishte në gjendje të kujtonte datat e sakta, siç
4 tha, për shkak të kalimit të kohës. Kur u pyet për takime të
5 tjera me Salih Mustafën në janar apo shkurt 1999, ky dëshmitar
6 nuk ishte në gjendje të jepte data konkrete lidhur me këto
7 takime.

8 Përpara Gjykatës, z. Humolli pretendoi se befas ishte i
9 sigurt lidhur me 1 prillin 1999, sepse në atë datë pati një
10 eksod të popullsisë drejt Maqedonisë duke kaluar nëpërmjet
11 Prishtinës. Megjithatë, sikurse provohet nga shumë dokumente
12 të paraqitura në gjyq, përfshirë raporte të organizatave
13 ndërkombëtare, si për shembull OSBE-ja apo disa organe të
14 medias, refugjatët në fakt filluan të largohen nga Prishtina
15 pak kohë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s në 24 mars
16 1999 dhe eksodi i tyre vazhdoi të paktën deri më 6 prill të
17 atij viti.

18 Nëse vërtetë kjo ngjarje e ndihmoi Fatmir Humollin të
19 kujtonte datën e takimit me z. Mustafa siç pretendonte, kjo
20 mund të kishte ndodhur në çdo ditë brenda kësaj periudhe kohe
21 dhe jo patjetër më 1 prill 1999, sikundër ai pretendon.

22 Më tej, Fatmir Humolli nuk ishte një dëshmitar objektiv
23 apo i besueshëm. Ai botonte poste në Facebook në mbështetje të
24 të akuzuarit dhe është një mik i të akuzuarit sepse kanë qenë
25 shokë për një kohë të gjatë në Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin

1 e Kosovës dhe luftëtarë të UÇK-së.

2 Për më tepër, z. Humolli tregonte një paragjykim, një
3 anësim negativ ndaj Gjykatës së Specializuar gjë që ngre
4 pikëpyetje lidhur me sinqeritetin e betimit të tij dhe
5 vërtetësinë e këtij betimi. Ai vuri në dukje se, "Gjykata
6 është ngritur në mënyrë të padrejtë". Dhe publikisht e
7 krahasoi atë me burgun e Guantanamos. Gjithashtu publikoi se
8 është një gjykatë e "padrejtë, kryesisht raciste dhe shkelëse
9 e të drejtave të njeriut" dhe "një institucion politik që nuk
10 mund të garantojë një gjykim të drejtë".

11 Ahmet Ademi ishte një tjetër Dëshmitar i Mbrojtjes i
12 thirrur për të dëshmuar lidhur me takimin me të akuzuarin në
13 Prishtinë në një ditë në fund të marsit, fillim i prillit
14 1999. Dëshmia e z. Ademi nuk ofron një alibi për të akuzuarin
15 për 1 prillin. Dëshmitari nuk ishte i sigurt lidhur me datat e
16 këtij takimi duke e pranuar se ai dinte vetëm se takimi me të
17 akuzuarin ndodhi në fund të marsit apo në fillimin e prillit.
18 Ai fajin për këtë ia vuri kalimit të kohës, për këtë pasiguri
19 të tij.

20 Pra shkurtimisht, rrëfimet e Fatmir Humollit dhe të Ahmet
21 Ademit nuk vërtetuan se Salih Mustafa nuk ka qenë në Zllash në
22 1 prill 1999. Gjithashtu, Prishtina është rreth 22 km larg
23 Zllashit, që i bie 40 minuta me makinë. Dhe, edhe nëse i
24 akuzuari vërtetë ka qenë në Prishtinë herët në mëngjes të 1
25 prillit të 1999, që nuk është provuar nga dëshmitë, ai

1 megjithatë kishte mundësi të mbërrinte në Zllash brenda të
2 njëjtës ditë, në kohë për të qenë i pranishëm kur kanë ndodhur
3 ngjarje të rëndësishme atë ditë në Zllash.

4 Nazmi Vrbovci dhe Bislim Nreci u thërritën për të dhënë
5 një alibi për Salih Mustafën, duke pretenduar se ata kanë ndër
6 vepruar me të në fshatin e Barilevës në ditët e para të
7 prillit të vitit 1999. Dëshmitë e të dy dëshmitarëve janë
8 shumë problematike. Por, edhe nëse do të ishin të vërteta, ato
9 ende nuk bien ndesh me provat siç janë paraqitur nga
10 Prokuroria.

11 Nazmi Vrbovci dëshmoi që e ka parë të akuzuarin në
12 Barilevë më 1 ose 2 prill 1999, ku kishte qëndruar për rreth 1
13 deri 3 orë. Duke marrë parasysh këtë periudhë të shkurtër kohe
14 kur Nazmi Vrbovci pretendon se e ka parë të akuzuarin, dëshmia
15 e tij nuk vërteton që Salih Mustafa nuk ishte në qendrën e
16 ndalimit në Zllash gjatë të njëjtës ditë. Barileva ndodhet 31
17 km larg nga Zllashi që është afërsisht 30 minuta me makinë dhe
18 i akuzuari mund të ishte lehtësisht në të dyja vendet
19 lehtësisht në të njëjtën ditë.

20 Më tej, dëshmia e Nazmi Vrbovcit është problematike për
21 dy arsye të veçanta. Së pari, ai dha data të ndryshme lidhur
22 me kohën kur e kishte takuar të akuzuarin në deklaratën për
23 Mbrojtjen dhe në dëshminë që dha përpara gjykatës dhe nuk
24 ishte në gjendje që të shpjegonte në mënyrë bindëse këtë
25 mospërputhje. Në gjykatë ai u përqendrua tek data 1 prill,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 78

1 edhe pse asnjëherë nuk e kishte përmendur këtë datë përpara.
2 Ai menjëherë insistoi për këtë datë edhe pse, siç dëshmoi, nuk
3 kishte ndonjë ngjarje konkrete të veçantë që do ta bënte atë
4 të mbante mend këtë datë të veçantë.

5 Së dyti, dhe ajo çfarë është e rëndësishme, të nderuar
6 Gjykatës, Nazmi Vrbovci nuk e dha dëshminë e tij në mënyrë të
7 pavarur, por ra dakord për sa i takon datave me persona të
8 tjerë përfshirë këtu edhe dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes
9 Bislim Nreci. Bislim Nreci diskutoi me Nazmi Vrbovcin jo vetëm
10 lidhur me datën kur pretendohet që të kenë takuar të
11 akuzuarin, por edhe për rrethanat e tjera që kanë ndodhur në
12 Barilevë në prill të vitit 1999.

13 Dëshmia e Bislim Nrecit po ashtu nuk është në kundërshtim
14 me çështjen e Prokurorisë. Ky dëshmitar ka thënë se është
15 takuar me Salih Mustafën në Barilevë në mars ose në shkurt të
16 vitit 1999 dhe pastaj në mes të prillit të po të njëjtit vit.
17 Ky dëshmitar po ashtu ishte i pasigurt lidhur me datat e
18 takimeve që kishte pasur me të akuzuarin.

19 Dëshmia e z. Nreci duhet të vlerësohet gjithashtu në
20 kuadrin e anësisë së tij, siç vërtetohet edhe nga postimet e
21 tij në Facebook edhe bashkëpunimin e tij me Nazmi Vrbovcin sa
22 i takon datave dhe ngjarjeve në Barilevë në prill të vitit
23 1999.

24 Në këtë kuadër vlen të theksohet se Nazmi Vrbovci dhe
25 Bislim Nreci janë njohur me njëri-tjetrin që prej fëmijërisë,

1 janë shokë, janë miq dhe takohen shpesh.

2 Të nderuar Gjykatës, të gjithë emrat që unë përmenda më
3 përpara, Gani Sopi, Hazir Borovci dhe Jakup Ismaili, janë
4 thirrur nga Mbrojtja për të konfirmuar alibinë e të akuzuarit
5 për disa ditë përpara fillimit të prillit 1999. Sipas këtyre
6 dëshmitarëve, Salih Mustafa pretendohet që ka kaluar disa ditë
7 në fshatin e Butovcit të poshtëm. Të tre këta dëshmitarë i
8 përkisnin të njëjtit njësit të UÇK-së në Butovc që, në një
9 pikë të caktuar kohe, ishte pjesë e njësitit BIA që komandohej
10 nga i akuzuari. Ata ishin gjithashtu miq gjatë luftës dhe janë
11 miq edhe sot e kësaj dite.

12 Gani Sopi. Gani Sopi ishte i paqartë lidhur me datat kur
13 i akuzuari kishte qëndruar në Butovc. Ai specifikisht tha se
14 vetëm mund t'i referohej datave të përafërta dhe se nuk
15 dëshironte që t'i referohej datave konkrete pasi mund t'i
16 kishte harruar me kalimin e kohës. Ai pretendonte se mund t'i
17 mbante mend datat për shkak të Bajramit të vogël që kishte
18 ndodhur në atë kohë. Megjithatë, ky dëshmitar nuk mund të
19 jepte asnjë datë specifike, një datë konkrete që kishte të
20 bënte me festimet e Bajramit të vogël.

21 Kur vlerësohet dëshmia e Gani Sopit, të nderuar Gjykatës,
22 duhet mbajtur parasysh fakti që ai ka lidhje të ngushta
23 familjare me të akuzuarin, pasi gruaja e të akuzuarit është
24 mbesa e Gani Sopit. Dëshmitari dhe Salih Mustafa janë po ashtu
25 miq, janë shokë lufte dhe e kanë njohur njëri-tjetrin që prej

1 vitit 1996-1997.

2 Për më tepër, Gani Sopi ka dëshmuar pas dëshmisë së miqve
3 të tij Hazir Borovci dhe Jakup Ismaili, që dhanë dëshmi
4 përpara tij, ku u vu në dukje rëndësia e datave të caktuara sa
5 i takon fajësisë penale të të akuzuarit.

6 Jakup Ismaili tha se ishte takuar me Salih Mustafën në
7 Butovc së pari në fund të marsit dhe më pas ishte takuar rreth
8 datës 7 apo 8 prill 1999 dhe më pas është takuar me të
9 afërsisht më datë 20 prill, po të njëjtit vit. Asnjë prej
10 këtyre dëshmime nuk është në papërputhshmëri me provën e
11 pjesëmarrjes së të akuzuarit dhe drejtimin e krimeve prej tij
12 në Zllash.

13 Më tej, në vlerësimin e dëshmisë së tij, Gjykata duhet të
14 vlerësojë problemet me kujtesën të z. Ismaili, një çështje që
15 ai e përmendi disa herë gjatë dëshmisë së tij përpara
16 gjykatës, si dhe duhet të mbajë parasysh edhe faktin që ai
17 është një shok i mirë i Salih Mustafës, me të cilin ai ka
18 mbajtur lidhje të vazhdueshme, si përpara arrestimit të tij
19 edhe pas arrestimit.

20 Dëshmitari i tretë që pretendon që e ka parë të akuzuarin
21 në Butovc në prill të vitit 1999 është Hazir Borovci. Si
22 shokët e tij, Gani Sopi dhe Jakup Ismaili, edhe ky dëshmitar
23 nuk ishte i sigurt për datat në prill duke thënë se, ai mund
24 ta ketë parë Salih Mustafën më datë 2 ose 3 prill edhe më vonë
25 duke thënë se mbase e ka parë 3, 4 ose 5 herë.

1 Ashtu si edhe Gani Sopi, Hazir Borovci dha data të
2 gabuara sa i takon festimeve të Bajramit të vogël, që ishte
3 pika e referencës kryesore e tij e ndërveprimeve me të
4 akuzuarin. Ai pranoi gjithashtu që nuk e kishte takuar të
5 akuzuarin përditë.

6 Në vlerësimin e dëshmisë së z. Borovci, ajo çfarë duhet
7 të merret parasysh është anësia e këtij dëshmitari pro të
8 akuzuarit, gjë e cila është dëshmuar përmes postimeve të tij
9 mbështetëse në Facebook.

10 Të nderuar Gjykatës, edhe në vlerësimin më të lartë,
11 dëshmitë e z. Sopi, z. Ismaili dhe Z. Borovci nuk janë në
12 kundërshtim me provat e paraqitura nga Prokuroria. Butovci
13 gjendet vetëm 32 km larg Zllashit, që është rreth 50 minuta me
14 automjet dhe i akuzuari mund të shkonte në Zllash dhe të
15 kthehej prej Zllashit përditë, nga ky vend.

16 Tre dëshmitarë shtesë janë thërritur për të dëshmuar
17 lidhur me takimet me të akuzuarin për një periudhë të shkurtër
18 kohe në mes të prillit të vitit 1999. Edhe dëshmitë e tyre nuk
19 janë në kundërshtim me provat e paraqitur nga Prokuroria.
20 Njëri prej tyre ishte Kapllan Parduzi, i plagosur në luftimin
21 e Surdullit më 10 prill 1999. Ky dëshmitar u mundua që të
22 ofronte një alibi për të akuzuarin për një datë që nuk u
23 specifikua, ndërmjet periudhës nga 10 deri në 13 prill të të
24 njëjtit vit dhe pretendoi se ky i fundit e shoqëroi atë dhe
25 Nuredin Ibishin në vendin e quajtur Rimanishtë ose Bellopojë,

1 rrugës për në spitalin e UÇK-së në Potok.

2 Dëshmia e z. Parduzi nuk ka lidhje me çështjen dhe nuk
3 cenon në asnjë mënyrë provat e ofruara nga Prokuroria.

4 Gjithashtu, dëshmia e z. Parduzi duhet të konsiderohet
5 dhe nuk duhet të merret parasysh duke marrë parasysh kushtet
6 në të cilën ai gjendej, gjithashtu edhe periudhën e shkurtër
7 dhe rrethanat në të cilën ai pretendoi që të jetë takuar me z.
8 Mustafa dhe dëshminë kontradiktore të Nuredin Ibishit dhe të
9 z. Parduzi, si dhe shprehjet e tyre kundër kësaj Gjykate dhe
10 mbështetjen e tyre për te akuzuarin.

11 Dëshmitari i fundit i alibisë për Mbrojtjen ishte Sheqir
12 Rrahimi, i cili ngiste makinën ku kishin udhëtuar Nuredin
13 Ibishi i plagosur dhe Kapllan Parduzi. Ai dha dëshmi përpara
14 kësaj Gjykate se në një pikë të caktuar gjatë udhëtimit, ishte
15 takuar me dy persona që po i jepnin traktorit dhe kishte
16 dëgjuar njërin prej tyre që ta thërriste tjetrin si "Cali".

17 Ky dëshmitar nuk e njihte Salih Mustafën në atë kohë dhe
18 pranoi se pas 23 vitesh ai nuk ishte në gjendje të thoshte në
19 qoftë se personi i quajtur Cali ishte në fakt i akuzuari apo
20 jo.

21 Në përmbledhje, të nderuar Gjykatës, alibia e pretenduar
22 nga i akuzuari nuk është provuar dhe kjo qëndron përtej
23 dyshimit të arsyeshëm. Nuk ka të dhëna dhe prova të besueshme
24 që tregojnë që z. Mustafa nuk ishte në kompleksin e ndalimit
25 në Zllash më datën 1 prill të vitit 1999 ose në ndonjë datë

1 ose kohë tjetër domethënëse për periudhën e aktakuzës.

2 Të nderuar Gjykatës, përveç alibisë, Mbrojtja u përpoq që
3 të provonte se nuk ka pasur të ndaluar që mbaheshin në Zllash
4 në prill të vitit 1999 dhe se i akuzuari nuk ishte përgjegjës
5 për kompleksin e ndalimit atje. Muhamet Ajeti, i njohur
6 ndryshe si Shyti, dhe Selatin Krasniqi janë ofruar nga
7 Mbrojtja në mënyrë të posaçme për tu përpjekur që të
8 demonstrojnë që gjatë periudhës së aktakuzës nuk kishte të
9 ndaluar që mbaheshin në kompleks.

10 Provat nuk duhet të merren fare parasysh, të nderuar
11 Gjykatës, sepse të dy personat janë ish-vartësit e të
12 akuzuarit në BIA, janë admirues të tij dhe e konsiderojnë atë
13 si mikun e tyre.

14 Selatin Krasniqi, anëtar i njësitit BIA, dhe djali i
15 pronarëve të kompleksit të Zllashit, pretendon se nuk ishte në
16 dijeni të asnjë të ndaluarit që mbahej në kompleks, pavarësisht
17 faktit që kishte qëndruar atje, megjithëse jo gjatë gjithë
18 kohës, që prej fillimit të prillit të vitit 1999. Besueshmëria
19 e këtij dëshmitari cenohet fort prej disa faktorësh, ashtu siç
20 është dëshmuar edhe gjatë dëshmisë së tij.

21 Unë do të jap vetëm pak shembuj të këtyre faktorëve të
22 cilët duhet të shqyrtohen si prova të peshuara kundrejt
23 provave të paraqitura nga Prokuroria.

24 Së pari, gjatë intervistës së parë të Mbrojtjes në shkurt
25 të vitit 2021, ndërkohë që po vizatonte skemën e kompleksit që

1 ai e njihte shumë mirë, ai qëllimisht harroi që të përcaktonte
2 ndërtesën ku ishin mbajtur të ndaluarit edhe pse bëhej fjalë
3 për një strukturë goxha të rëndësishme dhe të madhe në
4 kompleks.

5 Përpara Gjykatës ai pretendoi se nuk mbante mend se si
6 kishte harruar një gjë të tillë kaq të rëndësishme.

7 Së dyti, edhe nëse fillimisht dhe me vendosmëri ai
8 pretendoi se nuk kishte asnjë person të ndaluar në Zllash, më
9 vonë pranoi se njerëzit, përfshirë dhe veten e vet, ishin
10 pyetur nga UÇK-ja në kompleksin e ndalimit në Zllash në
11 periudhën përpara fillimit të bombardimeve të NATO-s.

12 Së treti, kur u pyet disa herë se kush ishte përgjegjës
13 për kompleksin e ndalimit në Zllash, Selatin Krasniqi përmendi
14 disa emra, por të bën përshtypje që ai asnjëherë nuk përmendi
15 emrin e Salih Mustafës si pjesë e komandës atje. Dhe kjo
16 pavarësisht faktit që ai e dinte që Z. Mustafa ishte
17 komandanti i tij në BIA dhe pohimeve të veta të z. Mustafa për
18 këtë pikë.

19 Së katërti, Selatin Krasniqi u përpoq që të hiqte nga
20 Zllashi të njohurin e tij dhe bashkëluftëtarin në BIA, Muhamet
21 Ajeti, i njohur ndryshe si Shyti, i cili vetëpranoi se kishte
22 qenë i pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash. Selatin
23 Krasniqi ka thënë si më poshtë para gjykatës sa i takon
24 pranisë së Ajetit në Zllash:

25 "Muhamet Ajeti erdhi në tetor. E përmenda edhe më herët.

1 Ai qëndroi për një natë ose dy dhe shkoi në drejtim të Majacit
2 ose në drejtim të një vendi tjetër. Nuk jam shumë i sigurt.
3 Dhe nuk e kam parë atë deri kur erdhi koha e ofensivës. Në
4 fakt e kam parë atë në Prishtinë ditën kur Prishtina u sulmua
5 nga forcat serbe dhe më pas nuk e kam parë më atë deri në
6 kohën e ofensivës”.

7 Kur u pyet nga Prokurori që i bëri kundërpjetje edhe u
8 konfrontua me dëshminë e Muhamet Ajetit, Selatin Krasniqi
9 pranoi pasi nuk kishte çfarë të bënte gjë tjetër:

10 “Nuk e mbaj mend. Nuk e mbaj mend. Ai mund të ketë qenë
11 atje, por unë nuk e mbaj mend. Nuk mund të them as po, as jo”.

12 Mendoni për këtë, të nderuar Gjykatës. Selatin Krasniqi e
13 dinte që z. Ajeti ishte atje, por u mundua që të bënte
14 gjithçka që mundej në mënyrë të tillë që ta largonte atë nga
15 kompleksi. Dhe këtë nuk e bëri thjeshtë për të mbrojtur z.
16 Ajeti, por gjithashtu edhe për të ndihmuar në këtë mënyrë
17 Mbrojtjen e të akuzuarit.

18 Gjatë vlerësimit të dëshmisë së z. Krasniqi, Gjykata
19 duhet të marrë parasysh lidhjen e fortë dhe emocionale të tij
20 me të akuzuarin, që dëshmohet edhe në deklaratën e tij:

21 “Ne jemi të gjithë shokë dhe do të mbetemi shokë deri sa
22 të vdesim. Edhe pas vdekjes madje”.

23 Duhet të kujtojmë gjithashtu që në të shkuarën z.
24 Krasniqi është dënuar për krimin e mashtrimit.

25 Muhamet Ajeti, i njohur ndryshe si Shyti, ishte një

1 tjetër dëshmitar i cili tha që as nuk kishte parë, as nuk
2 kishte dëgjuar që njerëzit ishin mbajtur në kompleksin e
3 ndalimit në Zllash në prill të vitit 1999. Ai mohoi gjithashtu
4 që kishte qenë i pranishëm kur viktimat e vrasjes ishin dërguar
5 në kompleks. Dëshmia e tij është e kufizuar dhe e
6 pambështetur, e pabesueshme.

7 Ai nuk e implikoi veten dhe pranoi që kishte qenë i
8 pranishëm kur viktimat e vrasjes ishin dërguar në kompleks ku i
9 akuzuari kishte qenë i pranishëm. Ai pranoi sa më pak fakte të
10 ishte e mundur dhe asgjë që mund të vishte me përgjegjësi
11 penale atë ose komandantin e vet, z. Salih Mustafa.

12 Lidhur me çështjen e të burgosurve të mbajtur në
13 kompleksin e ndalimit në Zllash, z. Ajeti nuk duket sikur as
14 të jetë futur në ndërtesat e kompleksit, të cilat kanë rëndësi
15 shumë të madhe në këtë çështje. Ai tha që nuk kishte qëndruar
16 në ndërtesat e kompleksit, që është përdorur si vend marrje në
17 pyetje dhe ndalimi, dhe pranoi se nuk e kishte vizituar
18 asnjëherë bodrumin e kësaj shtëpie ku të paktën disa prej të
19 ndaluarve janë mbajtur.

20 Ai thotë se ka qëndruar vetëm jashtë në oborr. Ai
21 gjithashtu nuk ishte i sigurt se cilat dhoma në atë shtëpi
22 përdoren nga civilët apo nga ushtarët. Kur u përball me
23 dëshmitë e të akuzuarit, që pranonte që kishte persona të
24 ndaluar në qendrën e Zllashit, Muhamet Ajeti pranon,
25 "Sigurisht, Salih Mustafa i di më mirë".

1 Sa i takon besueshmërisë, të nderuar Gjykatës, ju duhet
2 të merrni parasysh edhe dy çështje të tjera shtesë.

3 Së pari, pretendimet e Muhamet Ajetit që nuk është takuar
4 asnjëherë me të akuzuarin në Zllash në vitin 1999, janë të
5 pabesueshme. I akuzuari vetë e pranon se ka qenë në Zllash në
6 prill të vitit 1999 dhe është e paimagjinueshme që z. Ajeti të
7 mos ketë qenë në dijeni të pranisë së komandantit të vet të
8 BIA-s të cilin ai e admiron thellësisht.

9 Së dyti, Muhamet Ajeti ka lidhje të forta me të
10 akuzuarin, siç është dëshmuar dhe nga postimet e tij në
11 Facebook dhe të dhënat e komunikimit në telefon, të cilat janë
12 marrë nga telefoni i të akuzuarit. Ai ka gjithashtu edhe
13 lidhje të ngjashme të forta me anëtarin e BIA-s edhe ish-
14 shokun e vet në BIA Brahim Mehmetaj, siç tregohet nga postimet
15 e ndryshme në Facebook.

16 Në dëshminë e vet z. Ajeti ka pasur një motiv të fortë si
17 për të shfajësuar veten, por gjithashtu edhe për të mbrojtur
18 të akuzuarin dhe z. Mehmetaj.

19 Të nderuar Gjykatës, Mbrojtja ka pyetur disa dëshmitarë
20 të tjerë sa i takon njohurisë së tyre për sa i takon të
21 ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999. Të
22 gjithë ata mohuan se kishin një njohuri të tillë. Por, siç
23 është vërtetuar në gjykatë, ata nuk zotërojnë një bazë të
24 mjaftueshme për të dëshmuar lidhur me praninë ose mos praninë
25 e personave të ndaluar atje.

1 Fatmir Sopi. Fatmir Sopi dha dëshmi duke thënë që në
2 periudhën për të cilën flasim, ai kishte qenë gjatë gjithë
3 kohës në lëvizje, që ishte i përfshirë në luftime dhe se nuk
4 mendonte se kishte qenë atje në prill të vitit 1999.

5 Sejdi Veseli. Sejdi Veseli kurrë nuk e ka vizituar
6 kompleksin e ndalimit në Zllash dhe askush nuk i ka dhënë atij
7 asnjë lloj informacioni lidhur me atë vend.

8 Fatmir Humolli. Ky dëshmitar asnjëherë nuk ka vizituar
9 asnjë nga vendet në kompleksin e ndalimit në Zllash, përveç
10 vendit ku qëndronin personat e plagosur. Kur ka takuar
11 familjen e vet atje në prill të vitit 1999, familja qëndronte
12 jashtë në oborr dhe dëshmitari tha para Gjykatës që nuk ishte
13 futur në asnjë prej ndërtesave.

14 Teuta Hadri. Teuta Hadri, mjeke, mbërriti në Zllash drejt
15 fundit të periudhës së aktakuzës më 16 prill dhe qëndroi atje
16 për tre ditë. Ajo nuk e njihte zonën pasi nuk kishte qenë atje
17 asnjëherë më përpara. Ndërsa ishte në Zllash, ajo ishte shumë
18 e zënë me punën e saj si mjeke. Kishte qëndruar kryesisht në
19 dhomën që i ishte caktuar, rrallë kishte dalë në oborr dhe nuk
20 kishte vizituar asnjë prej ndërtesave në kompleksin e ndalimit
21 në Zllash. Ajo tha se mund të shikonte vetëm thjesht zonat e
22 afërta të kompleksit të Zllashit nga brenda dhomës ku
23 qëndronte.

24 Ibadete Canolli-Kaciu. Kjo dëshmitare, anëtare e BIA-s,
25 mbërriti në Zllash më 16 prill të vitit 1999, ku qëndroi deri

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 89

1 më 21 prill. Ajo nuk kishte qenë më përpara në atë vend. Për
2 shkak të kalimit të kohës, ajo nuk ishte në gjendje të jepte
3 përshkrim të vendit ku kishte qëndruar. Kur iu treguan
4 fotografi të ndërtesave brenda kompleksit të ndalimit në
5 Zllash, ajo tha se nuk i kujtohej nëse i kishte parë ato
6 ndërtesa apo jo.

7 Znj. Kaciu ka qëndruar kryesisht brenda dhe nuk ka
8 lëvizur shumë në oborr. Ajo doli nga dhoma a saj vetëm një
9 herë për të marrë ca ushqim nga një kuzhinë aty afër.
10 Dëshmitarja tha që nuk kishte vizituar asnjë prej ndërtesave
11 në kompleks. Ndërkohë që ishte në Zllash, ajo ishte shumë e
12 ngarkuar me punë mjekësore dhe vëmendjen e kishte kryesisht të
13 përqendruar tek të plagosurit.

14 Në përmbledhje, të nderuar Gjykatës, dëshmitarët e
15 thërritur nga Mbrojtja krijojnë asnjë pikë dyshimi lidhur me
16 atë çfarë ka ndodhur në Zllash në prill të vitit 1999. Ata nuk
17 cenojnë në asnjë mënyrë dëshmitë dhe provat e shumta që
18 vërtetojnë që viktimat u dërguan në Zllash, u ndaluan dhe me
19 ta u abuzua në Zllash dhe që një prej viktimave në fakt u vra.

20 Të nderuar Gjykatës, ju mund ta mendoni se pse Mbrojtja
21 ka marrë këtë pozitë ekstreme të pretendimit që nuk ka pasur
22 të ndaluar në Zllash dhe që të gjithë viktimat i kanë sajuar
23 dëshmitë e tyre. Pse duhet të vazhdonte të insistonte Mbrojtja
24 në këtë pistë? Përgjigja që kemi ne për këtë pyetje, të
25 nderuar Gjykatës, është shumë e thjeshtë.

1 Duke pasur parasysh rolin e Salih Mustafës në Zllash,
2 komandën e tij mbi BIA-n dhe kompleksin në Zllash, provon që
3 ka pasur të ndaluar dhe me këta të ndaluar është abuzuar
4 ndërkohë që përgjegjësia binte mbi të akuzuarin. I akuzuari
5 ishte aty. Ishte komandant i BIA-s. Ishte personi i vetëm që
6 jepte komandat. Dhe është personi përgjegjës për shëndetin e
7 të burgosurve dhe abuzimin me ta atje.

8 Të nderuar Gjykatës, me sa shoh po mbërrijmë afër orës
9 13.00 dhe nuk e di a është moment i përshtatshëm ky për të
10 bërë pushimin e drekës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I
12 nderuar Prokuror, jua lë juve në dorë. Nëse mendoni që ky
13 është një moment që lejon bërjen e pushimit, mund ta bëjmë
14 pushimin tani.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, mendoj që
16 është moment shumë i përshtatshëm për neve për të bërë
17 pushimin e drekës tani.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull. Do e ndërpresin seancën këtu dhe do të mblidhemi
20 sërish pas një ore e gjysmë. Drekë të mbarë dhe do të takohemi
21 sërish për një orë e gjysmë.

22 --- Pushimi i drekës fillon në orën 12.57

23 --- Seanca rifillon në orën 14.30

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
25 shikojmë përbërjen. Po e shkoj që ZPS-ja ka të njëjtën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 91

1 përbërje.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, të njëjtën përbërje, me
3 përjashtim të dy stazhierëve të cilët janë larguar.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Mbrojtësja e Viktimave, po.

6 E njëjta gjë edhe për palën Mbrojtëse. Z. Mustafa na
7 ndjek me videolidhje.

8 Dakord. Vazhdojmë tani dhe ja jap fjalën Zyrës së
9 Prokurorit të Specializuar.

10 Ju e keni fjalën.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
12 Përpara se të fillojmë do t'ju informoj se do ta përfundojmë
13 deklaratën tonë brenda këtij sesi. Jemi të bindur që do ta
14 përfundojmë përpara orës 16.00.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Dakord. Atëherë nuk do të vazhdojmë sot me deklaratën tuaj të
17 mbyllëse të Mbrojtjes, Mbrojtësja e Viktimave pasi kemi
18 vërejtur se dëshironi të keni të paktën një orë në dispozicion
19 për të bërë një krahasim me atë që ka thënë Zyra e Prokurorit
20 të Specializuar. Dhe ora 16.00 është një orar i përshtatshëm
21 me qëllim që të mund të fillojmë një ditë të re nesër.

22 z. Prokuror, ju e keni fjalën.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani do të
24 flas lidhur me pikën 4 dhe prova të cilat janë në thelb të
25 akuizës së vrasje.

1 Nuk ka dëshmitarë pamorë të cilët konfirmojnë rrethana e
2 vërteta të momenteve të fundit të viktimës së vrarë.
3 Megjithatë, provat tregojmë përtej asnjë dyshimi të arsyeshëm
4 që është i akuzuari -- që viktima është vrarë dhe akuzuari ka
5 përgjegjësi penale.

6 Të nderuar Gjykatës, rregullat e procedurës ju lejojnë që
7 të gjeni palën fajtor lidhur -- kur bëhet fjalë se ajo është e
8 vetmja arsyetim që mund të dalë. Dhe në këtë drejtim vetëm
9 koherenca e brendshme e këtyre provave është ajo që duhet
10 mbajtur parasysh.

11 Ju them që edhe pa nevojë për të patur dëshmi të
12 drejtpërdrejtë lidhur me moment e fundit të jetës, të gjitha
13 -- të jetës së viktimës të gjitha, të gjitha tregojmë, na
14 çojnë tek konkluzioni, në një konkluzion i vetëm që viktima
15 është vrarë dhe që z. Mustafa është ai përgjegjës për këtë.

16 Së pari, të nderuar Gjykatës keni parasysh sesa të ashpra
17 ka qenë keqtrajtimi i viktimës nga vartësit e të akuzuarit,
18 varet nga i akuzuari. Ky keqtrajtim kishte të bënte me rrahje
19 me shkopinj hekuri dhe përdorimin e thikave.

20 E dyta, fakti që viktima nuk është lejuar nga i akuzuari
21 dhe kur të tjetër janë lejuar në datën 18 prill 1999, ishte
22 ajo që, kur po largoheshin pra nga kompleksi i Zllashit siç e
23 kam shpjeguar, është një moment thelbësor ky.

24 E treta, duhet të mbahet parasysh kushtin e afër vdekjes
25 së viktimës dhe aftësinë e tij për të mos -- dhe paaftësinë e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 93

1 tij për të lëvizur, duhet të mbajmë parasysh atë që ka parë në
2 këtë kompleks dëshmitari 4669.

3 E katërta, po të kemi parasysh afërsinë me kompleksin e
4 ndalimit në Zllash, flitet për 100 deri 200 metra nga vendi ku
5 është gjetur trupi i viktimës në korrik 1999.

6 E pesta, të nderuar Gjykatës, shikoni pranoni praninë e
7 një trupi të dytë në atë varr. Rrethanat kanë rëndësi të
8 veçantë. Së pari, se ka patur një të ndaluar tjetër në
9 kompleksin e ndalimit. Një njeri që ka patur nofkën "Burmak".
10 Ai nuk është lejuar së bashku me të tjerët. I dyti, ky person,
11 Burmak, sipas dëshmitarëve të tjerë të kësaj çështje, për
12 shembull, 03593 është ai që është keqtrajtuar më keq së bashku
13 me viktimën e Mbrojtjes.

14 Pra kemi të dy këto të ndaluar që kanë marrë trajtimin më
15 të keq, të cilët nuk janë lejuar të largohen kur të tjerët
16 janë liruar.

17 Dhe së fundmi, të nderuar Gjykatës, shikoni se në
18 ç'gjendje është gjetur trupi i viktimës, i cili është, siç
19 është gjetur nga të afërmit e tij, që është në përputhje me të
20 gjitha dëshmitë që kemi parë mbi të rrahurat dhe përshkrimin që
21 kanë bërë dëshmitarët.

22 Këto dëshmi janë të gjitha konsistente dhe të
23 përputhshme. Dhe konkluzioni i vetëm që del është që viktima e
24 vrasje është vrarë menjëherë pasi janë liruar të ndaluarit e
25 tjerë. Ne mund të mos e dimë momentin e saktë se kur ka

1 ndodhur ky, por ka ndodhur kur të ndaluarit e tjerë nuk ishin
2 aty për të qenë dëshmitarë.

3 Këto rrethana nuk ju provojnë juve, të nderuar Gjykatës,
4 nga arritja e konkluzionit që kjo vrasje ka ndodhur si
5 rezultat i të akuzuarit dhe njerëzit e tij.

6 Ju kërkoj në mënyrë të posaçme t'i jepni shqyrtimin e
7 duhur vendimit për të mos e lejuar viktimën të lirohet, [e
8 pakuptueshme] të tjerë, pasi është një hollësi shumë e
9 rëndësishme dhe tregon lidhur me synimet e të akuzuarit dhe
10 anëtarëve të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët
11 lidhur me viktimën. Nuk ka arsye tjetër për Salih Mustafën që
12 të shtynte lirimin. Nuk ka pasur asgjë tjetër përveç vendimit
13 që ai të vritje.

14 Dhe në këtë drejtim duhet të marrë parasysh përse janë
15 liruar të ndaluarit në radhë të parë. Ishte një vendim i cili
16 ishte diktuar nga rrethanat. UÇK-ja në Zllash, përfshirë edhe
17 BIA në kompleksin e ndalimit në Zllash, është dashur që të
18 largoheshin për të evakuuar civilët e zonës për shkak të
19 ofensivës serbe që afrohej. Dhe në këto rrethana, përse është
20 mbajtur viktimja e vrasjes dhe ai tjetri, Burmaku, ndërkohë që
21 të tjerët janë lejuar dhe ekziston vetëm një përkrahim apo
22 konkluzion logjik që është vendosur, që ato duheshin vrarë. Që
23 është në përputhje me atë që ka ndodhur. Sidomos, po të mbahet
24 parasysh rrahjet e mëdha që kanë marrë dhe gjetjen e viktimës
25 100 apo 200 metra në afërsi të kompleksit së bashku me një

1 trup tjetër.

2 Pala Mbrojtëse është përpjekur që të shpikë disa dyshime
3 lidhur me përgjegjësinë e të akuzuarit lidhur me këtë. Përfshi
4 edhe faktin që janë vrarë nga forcat serbe. Në fakt nuk ka
5 asnjë provë që forcat serbe të kenë hyrë në kompleksin e
6 ndalimit të Zllashit dhe të kenë vrarë civilë atje. Në fakt, e
7 kundërta është e vërtetë, nuk ka dyshim që në kohën që janë
8 liruar të burgosurit nga ky kompleks, ata nuk kanë takuar apo
9 nuk kanë parë forca serbe. Në fakt, ato u larguan në mënyrë të
10 sigurt në drejtim të Prishtinës dhe në vendeve të tjera pas
11 lirimit të tyre.

12 Të nderuar Gjykatës, siç e thashë, ne nuk kemi dëshmitarë
13 për të provuar se ç'ka ndodhur në moment e fundit të jetës së
14 viktimës. Vrasja e ka bërë të sigurt që të mos ketë një gjë të
15 tillë. Megjithëkëtë, në rrethanat që kemi diskutuar nuk ka
16 dyshim që viktima është vrarë nga kapësit e tij në kompleksin
17 e ndalimit në Zllash. Tani do të ilustroj se pse Salih Mustafa
18 mban përgjegjësi penale për këtë vrasje.

19 ZPS-ja e ka akuzuar të akuzuarin me disa lloje të
20 përgjegjësisë, siç lejohet, për krimet e pikave 1 deri në 4.
21 Dhe ne i kemi adresuar të gjitha këto në dosjen tonë
22 përfundimtare. Tani do të bëjmë disa komente të tjera lidhur
23 me përgjegjësisë e Salih Mustafës, lidhur me akuzën e vrasjes,
24 që është pika 4 si dhe në vazhdimësi të llojit të
25 përgjegjësisë apo të ndërmarrjes kriminale të përbashkët. Pra,

1 të përgjegjësisë si superior.

2 Të nderuar Gjykatës, Salih Mustafa është përgjegjës për
3 vrasje si krim lufte përmes pjesëmarrjes në këtë ndërmarrje të
4 përbashkët kriminale. ZPS-ja e ka shpjeguar në paragrafët 311
5 deri në 329 të dosjes së saj, se si pikat 1 deri në 4 janë
6 bërë nga Salih Mustafa së bashku me një numër personash të
7 tjerë që ishin anëtarë të BIA-s nën komandën e tij. Ne kemi
8 shpjeguar sesi ky plan i përbashkët kriminal, përfshinte
9 vrasjen.

10 Ekzistojnë një numër faktesh dhe rrethanash të cilat
11 provojnë që i akuzuari dhe anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së
12 përbashkët kriminale kanë patur të njëjtin synim për të
13 krijuar këtë krim. Së pari, shfrytëzimi i instrumenteve
14 vrasës, si për shembull, shkopinjve të hekurit dhe të thikave.

15 E dyta, shpeshësia dhe ashpërsia e rrahjeve që ka bërë
16 që të ndaluarit e tjerë ta përshkruajnë atë si një masakër në
17 prag të varrit, në gjendje në të cilën ai nuk lëvizte dot më
18 tutje.

19 E treta, sjellja e të akuzuarit me të ndaluarit e tjerë.
20 Shfrytëzimi i një revolveri gjatë marrjes në pyetje të
21 ndërmarrje -- të W0353 [sipas përkthimit] më pas në rastin e
22 W01679.

23 Nuk ka arsye tjetër, nuk ka arsye tjetër apo shpjegim
24 tjetër të arsyeshëm se përse afrimi i ofensivës serbe ta
25 detyronte Salih Mustafën që të mos -- që të vononte lirimin e

1 viktimës.

2 Së fundi, të nderuar Gjykatës, synimi i Salih Mustafës
3 për të vrarë viktimën, provohet nga komanda dhe kontrolli që
4 ka patur ai mbi kompleksin e Zllashit dhe ushtarët e BIA-s.
5 Autoriteti është provuar. Vetëm i akuzuari mund të urdhëronte
6 ose të aprovonte veçimin e viktimës për këtë trajtim abuziv
7 gjatë të gjithë kohës në këtë kompleks. Vetëm i akuzuari mund
8 ta merrte këtë vendimin për lirimin e viktimës, ndërkohë që
9 janë liruar të tjerët.

10 Dhe në këtë drejtim, siç e ka thënë Prokurori i
11 Specializuar gjatë mëngjesit, provat tregojnë që i akuzuari ka
12 qenë i pranishëm në kohën kur janë liruar të burgosurit dhe
13 është mbajtur viktimja. Teuta Hadri ka treguar këtë që e ka
14 parë atë një natë përpara ofensivës serbe dhe ditën e
15 ofensivës me 1 prill 1999.

16 Përveç synimit, Salih Mustafa ka kontribuar për
17 ekzekutimin e planit të përbashkët, që përfshinte vrasjen dhe
18 e ka bërë këtë një numër -- në një numër mënyrash siç është
19 shpjeguar në paragrafët 325 deri 327 të dosjes sonë. Si
20 komandant i kompleksit të Zllashit e ka mbajtur viktimën në
21 kushte të rënda duke i dhënë atij dita-ditës një trajtim
22 brutal i cili ka ndikuar në mënyrë shkatërruese mbi shëndetin
23 e tij.

24 Përveç kësaj dhe efektet e dukshme të keqtrajtimit mbi
25 viktimën, Sali Mustafa nuk i ka dhënë fund këtij trajtimi. Ai

1 nuk ka dhënë asnjë ndihmë mjekësore viktimës. Përkundrazi, ka
2 lejuar që të vazhdojnë të pandërprera abuzimet deri në
3 momentin që viktima të mos lëvizte dot siç është përshkruar në
4 paragrafin 90 të dosjes përfundimtare.

5 Të nderuar Gjykatës, siç e kam thënë, qëndrimi ynë është
6 se Salih Mustafa ka qenë i pranishëm në kompleksin e ndalimit
7 në Zllash kur është vrarë viktima. Edhe në qoftë se ju, të
8 nderuar Gjykatës, nuk do të bindeni lidhur me këto prova
9 rrethanore, dëshmitë që kam diskutuar nuk do të ju pengojnë
10 për ta gjetur atë fajtor.

11 Nuk është e domosdoshme që të jetë prania e të akuzuarit
12 në momentin e kryerjes së krimit për ta gjetur atë përgjegjës,
13 si ndërmarrje e përbashkët kriminale. Në fakt, sipas
14 ndërmarrjes së përbashkët -- sipas dispozitave të ndërmarrjes
15 së përbashkët kriminale, një i akuzuar mund të gjendet fajtor
16 për krimet e bëra nga kryes të tjerë të cilët kanë qenë të
17 pranishëm.

18 Dhe për këtë arsye, të nderuar Gjykatës, provat provojnë
19 tej dyshimit të arsyeshëm që Salih Mustafa ka qenë përgjegjës
20 për tipin e parë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët, në të
21 gjitha pikat, përshirë vrasjet.

22 Të nderuar Gjykatës, siç e kemi thënë edhe në Aktakuzë,
23 në alternativë, Salih Mustafa është përgjegjës për vrasjen si
24 krim lufte, sipas pikës 4 dhe përmes formës së tretë të
25 ndërmarrjes kriminale të përbashkët.

1 Ne kemi përshkruar në mënyrë të gjerësishme në dosjen
2 tonë përfundimtare dhe gjatë parashtrimeve të sotme trajtimin
3 brutal të viktimës nga anëtarët e njësitit të BIA-s. Kemi
4 dëgjuar nga shumë dëshmitarë lidhur me ndikimin katastrofal që
5 kanë patur mbi shëndetin e viktimës këto trajtime. Ne kemi
6 dëgjuar sesi shëndeti i tij është dëmtuar pas rrahjes dhe nuk
7 lëvizte dot dhe më pas duhej të ngrihej nga të burgosësit e
8 tij.

9 Sahih Mustafa, të nderuar Gjykatës, i ka inkurajuar
10 vartësit e tij që t'i jepnin fund W01679. Dhe në këtë rrethana
11 ishte e parashikueshme për z. Salih Mustafa që krimi i vrasjes
12 ishte, do të ishte rezultat i këtij trajtimi, ndalimi arbitrar
13 edhe i trajtimit çnjerëzor dhe i torturës. Përveç kësaj, z.
14 Mustafa nuk e ndaloi këtë keqtrajtim, nuk e ndaloi
15 parandalimin dhe vazhdoi t'i lejonte që të kryheshin këto
16 krime. Dhe duke bërë këtë ka marrë atë rrezikun që viktima --
17 e ka marrë parasysh rrezikun që viktima do të vritej.

18 Prokurori, të nderuar Gjykatës, në mënyrë alternative ka
19 parashi -- ka thënë që i akuzuari është përgjegjës edhe si
20 ndihmës dhe inkurajues. E kemi shpjeguar këtë në dosjen tonë
21 përfundimtare. Dhe më lejoni që ta përfundoj, të nderuar
22 Gjykatës. Pjesëmarrja e tij personale, siç është përshkruar,
23 për sa i përket ndërmarrjes kriminale të përbashkët, dhe nuk
24 dua të përsëris për të harxhuar kohë të mëtejshme të Trupit
25 Gjykues, në fakt arrin në inkurajimin dhe ndihmën dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 100

1 mbështetjen morale për kryesit fizikë duke lejuar që vendi i
2 ndalimit në Zllash të përdorej si një vend për ndalimin e
3 paligjshëm dhe për keqtrajtimin.

4 Ndihma e tij praktike, të nderuar Gjykatës, ka patur një
5 ndikim të madh lidhur me kryerjen e këtyre krimeve.

6 Si komandanti që ka patur autoritetin përfundimtar mbi
7 BIA-n dhe qendrën -- dhe kompleksin e ndalimit dhe njohuritë
8 që aty po bëheshin krime, Salih Mustafa ka patur dijeni të
9 plotë që sjellja e tij ka kontribuar në kryerjen e këtyre
10 krimeve, përfshi krimin e vrasjes.

11 Dhe së fundmi, të nderuar Gjykatës, do të flas lidhur me
12 përgjegjësinë e tij për vrasje, sipas doktrinës së
13 përgjegjësisë si superior, si epror.

14 I nderuar -- i akuzuari është përgjegjës për krimin e
15 vrasjes edhe si epror, për shkak se ai nuk ka parandaluar apo
16 dënuar ato që kanë bërë vartësit e tij që kanë bërë këtë krim.
17 Ky ishte një dyshim -- një dështim i dyfishtë, të nderuar
18 Gjykatës, sepse e dinte që krimet ishin duke u bërë dhe nuk e
19 ka ndaluar atë.

20 Kryesit fizikë të këtyre krimeve, e kimit të vrasjes,
21 por edhe krimeve të tjera, ishin anëtarë të BIA-s me të cilët
22 ai ka kontrolluar dhe ka patur komandën. Dhe fakti që ai ka
23 qenë komandant i ka kontrolluar, janë të provuara me një numër
24 faktorësh. Aty ishte mundësia për të dhënë urdhra, për t'i
25 disiplinuar. E ka shpjeguar i akuzuari vetë se sa kontroll të

1 gjerësisht ka patur mbi anëtarët e BIA-s.

2 Dhe i akuzuari po kështu ka patur njohuri ose të paktën
3 ka patur arsye për ta ditur që vartësit e tij ishin gati që të
4 bënin krime kundër këtyre personave të ndaluar në qendrën e
5 burgimit në Zllash, përfshirë edhe viktimën e vrasjes. Dhe kjo
6 është provuar nga të gjithë faktorët që i kemi paraqitur si
7 pjesë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët, përfshirë
8 rrahjen me shkopinj hekuri dhe me thika. I akuzuari ka qenë i
9 pranishëm në ditën e vrasjes së viktimës apo në ditën kur ai
10 ka ardhur atje.

11 Fakti që viktimja është vrarë, është njohur nga anëtarët e
12 tjerë të UÇK-së, të paktën një javë pas vdekjes së tij. W04600
13 në fakt ka dhënë dëshmi lidhur me vdekjen e viktimës me datat
14 23 apo 24 prill 1999. Më pak se një javë pas lirimit të të
15 burgosurve të tjerë.

16 Do të ishte e paarsyeshme të mësohet, të nderuar Gjykatës
17 që komandanti i vendit ku është ndaluar viktimja nuk ka patur
18 dijeni mbi këto fakte.

19 Pavarësisht kësaj, i akuzuari -- dështimi i të akuzuarit
20 për të marrë masat e duhura për të ndaluar apo për të
21 parandaluar apo për të dënuar vartësit e tij që kanë kryer
22 këtë krim, tregon që ai mban përgjegjësi.

23 Dhe si përfundim, i nderuar Gjykatës, i akuzuari është
24 fajtor lidhur me pikën 4 të aktakuzës në dispozitën e
25 ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe për ndihmën dhe

1 inkurajimin e përgjegjësisë.

2 Të nderuar Gjykatës, këtu përfundon pjesa që ka të bëjë
3 me pikën e 4, të vrasjes. Dhe ja jap fjalën Prokurorit
4 Michalczuk i cili do të flasë mbi çështjen e masës së dënimit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Z. Prokuror ju e keni fjalën.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pjesa e
9 fundit e parashtrimit të ZPS-së për ditën e sotme ka të bëjë
10 me çështjet e masës së dënimit.

11 Sot në mëngjes, Prokurori i Specializuar foli lidhur me
12 kërkesën e ZPS-së për një masë të gjatë dënimi për sa i përket
13 rrethanave të kësaj çështje.

14 Dhe gjatësia e masës së dënimit duhet të jetë në
15 përputhje me sa të rënda janë krimet e bëra nga i akuzuari,
16 pasojat e rënda mbi viktimat, rolin e të akuzuarit në këto
17 krime, praninë e mjaft faktorëve fajësues dhe mungesën e
18 faktorëve shfajësues si dhe rëndësinë që ka si parandaluese
19 kjo çështje që kemi përpara.

20 Të nderuar Gjykatës, ju keni patur disa pyetje lidhur me
21 çështjen që e kemi paraqitur në dosjen F00471 të 8 shtatorit.
22 Ne nuk i kemi mbuluar këto çështje në masë të mëtjshme, me
23 përjashtim të rastit kur ju mund t'i keni pyetjet, të nderuar
24 Gjykatës.

25 Pjesa 6 e dosjes sonë përfundimtare diskuton masën e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 103

1 dënimit që i cili arrin në maksi -- në masën e dënimit të
2 dhomave të specializuara që arrin maksimumin e dënimit me
3 jetë, dënimit me burgim të përjetshëm. Dhe për këtë, duhet të
4 marrim parasysh këto çështje: sa të rënda kanë qenë krimet e
5 bëra, rolin e të akuzuarit, përfshirë praninë e tij të
6 drejtpërdrejtë në to, praninë e faktorëve rëndues të shumtë
7 dhe e fundit, mungesën e faktorëve lehtësues.

8 Të diskutojmë së pari, të nderuar Gjykatës, çështjen e
9 krimeve të bëra nga i akuzuari dhe sa të rënda janë ato.

10 Të nderuar Gjykatës, në bazë të nenit 44(5) i Ligjit të
11 Dhomave të Specializuara, krimet e -- sa të rënda janë krimet
12 dhe pasojat e tyre janë faktorë përkatës, lidhur me vendosjen
13 e masës së dënimit nga Trupi Gjykses. Siç është diskutuar në
14 dosjen tonë përfundimtarë, nuk ka asnjë dyshim lidhur me
15 faktin që krime të provuara në këtë rast, janë jo vetëm të
16 rënda, por janë tejet brutale dhe të tilla janë edhe pasojat e
17 këtyre krimeve mbi viktimat.

18 Të nderuar Gjykatës, do të mbani mend fjalët e përdorura
19 nga viktimat kur kanë përshkruar rrahjen, keqtrajtimin apo
20 torturat të cilave ju janë nënshtruar. Viktima 1679 ka dhënë
21 dëshmi para këtij Trupi Gjykses, lidhur me mënyrën sesi
22 ndjehej kur ai dhe të paraburgosurit e tjerë janë abuzuar nga
23 kapësit e tyre në mënyrë të ditëpërditshme dhe të vazhdueshme.

24 [Luhet videoincizimi]

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Sot, nesër, prisje që të të

1 vrisnin.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ky dëshmitari, të nderuar
3 Gjykatës, ka shpjeguar që nga hauri dhe ai dhe të ndaluarit e
4 tjerë dëgjonin si rriheshin njerëzit e tjerë katin e sipërm të
5 ndërtesës. Ai tha --

6 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
7 këshillohen]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
9 është -- nuk është, Gjykatësja -- nuk kuptoj.

10 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
11 këshillohen]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
13 doni që ta luajmë videon edhe një herë tjetër?

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po. Nëse na lejoni të nderuar
15 Gjykatës, do ta luajmë edhe një herë videon.

16 [Luhet videoincizimi]

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Dëgjonim njerëzit që bërtisnin,
18 dëgjonim çirrje, nuk flisnim pasi kishim frikë të flinim, pasi
19 mendonim se mund të na merrnin edhe neve të na dërgonin në
20 katin e sipërm herë pas here.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
22 Prokuror, unë nuk dëgjova fare se çfarë është thënë. Nuk
23 dëgjova audio.

24 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
25 këshillohen]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 105

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
2 dëgjova. Z. Prokuror, ju lutem a mund ta luani edhe një herë?
3 Më duket që diçka nuk ka funksionuar si duhet me zërin e
4 dëgjuesve të mia.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do ta luaj
6 edhe një herë këtë pasazh.

7 [Luhet videoincizimi]

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Prisnim për vdekjen. Prisnim kur
9 do të vinte. Sot, nesër. Prisnim që të na vrisnin.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ky dëshmitar ka shpjeguar se
11 nga ahuri ai dhe të ndaluarit e tjerë dëgjonin kur rriheshin
12 njerëzit në pjesën e sipërme të ndërtesës. Ai tha:

13 "Ne mund të dëgjonim. Unë mund të dëgjoja llojet e
14 ndryshme të zërave. Dhe atje mësova që zëri i një personi mund
15 të ndryshojë për shkak të asaj së cilët po i nënshtrohet.

16 "...dëgjoheshin njerëz që çirreshin, të cilët lehnin si
17 qen, që bënin zhurma si ato që bëjnë macet, macet që çirren,
18 për shkak të torturës dhe të dhimbjeve."

19 Kur është kërkuar të shpjegojë keqtrajtimin e tij,
20 pasojat e tij, një viktimë tjetër, viktima 3593, tha kështu
21 dhe të të nderuar Gjykatës, tani do të luaj një video tjetër
22 nga dëshmia.

23 [Luhet videoincizimi]

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Mund të them që më ka rënë të
25 fikët nja dy herë, tre herë, më ka rënë të fikët. Më kanë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 106

1 goditur me dru, më kanë shkelmuar. Më kanë goditur në mënyrë
2 të ndryshme. Më kanë goditur, nuk e di se me çfarë. Më janë
3 thyer, më është thyer gishti, më janë thyer dhëmbët.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kjo viktimë ka përshkuar sesa i
5 tmerruar ishte ai dhe të ndaluarit e tjerë që ishin të ulur
6 aty në haur ndërkohë që të tjerët keqtrajtoheshin jashtë. Dhe
7 të nderuar Gjykatës, do të luajmë një video tjetër nga dëshmia
8 e të njëjtit dëshmitar.

9 [Luhet videoincizimi]

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Dëgjonim njerëz të cilët
11 bërtisnin. Dëgjonim zhurma të rënda dhe nuk flinim dot për
12 shkak se kishim frikë që do të na merrnin edhe neve në çdo
13 moment dhe të na dërgonin në katin lart.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të ndaluarit ishin dëshmitarë
15 gjithashtu të brutalitetit dhe të torturave të shkaktuara
16 viktimës që më pas u vra. Dëshmitari 1679 dëshmoi se viktima e
17 vrasjes, citoj tani "ishte një nga personat që u rrah më
18 shumë, u lëndua më shumë. Ai u keqtrajtua brutalisht".

19 Përsëri, sipas fjalëve të këtij dëshmitari, po citoj përsëri:

20 "Ishte katastrofë, trupi i tij ishte gjithë shenja. Ishte
21 e tmerrshme. Të gjithë ne rriheshim, por ai u rrah më shumë
22 dhe ai u masakrua."

23 Sipas Dëshmitarit 4669, viktima e vrasjes ishte bërë i zi
24 nga të rrahurat. "Gjithçka në fytyrën e tij sytë, hunda,
25 gjithçka ishte e nxirë. Ishte mavijosur në të gjitha e dukshme

1 të trupit. Nuk i hapte dot sytë.”

2 Dhe tani do të luajmë një klip të shkurtër të dëshmisë së
3 këtij dëshmitari ku ai përshkuar kushtet e tmerrshme të
4 viktimës së vrarë dhe abuzimeve që ai vetë iu nënshtuar nga
5 torturuesit e tij.

6 [Luhet videoincizimi]

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ai u soll përsëri, por pastaj
8 nuk e pamë më. Kur e sollën për herë të dytë ishte pothuajse i
9 vdekur. Ishte i shtrirë në tokë, qante nga dhimbja, ishte i
10 ënjtur, nga hunda i rridhte gjak. Me fjalë të tjera, nuk ishte
11 në gjendje të fliste. Vetëm bërtiste nga dhimbja. Kjo ndodhi
12 për të dytë. Për t'ju shpjeguar këtë ne e dëgjuam kur e
13 sollën herën e parë, e nxorën jashtë. Nuk e di nëse e nxorën
14 jashtë herën e parë apo herën e dytë, por kur e sollën për
15 herë të dytë, e nxorën jashtë e rrahën keqaz dhe nga të çarat
16 -- nga ato të çarat e asaj kasolles pamë se po rrihej nga
17 pesë-gjashtë veta.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Rrahjet që iu shkaktuan ishin
19 të paparashikuara dhe jashtëzakonisht të dhunshme. Kishte
20 raste kur viktimat rriheshin kaq keq sa që binin në tokë pa
21 ndjenja. Instrumentet e përdorura për t'i rrahur dhe
22 keqtrajtuar, përfshinin qirinj për t'i djegur, kuti me
23 elektricitet, me korrent për t'ju bërë elektroshok, shkopinj
24 druri dhe shkopinj prej hekuri, për t'i rrahur keq.

25 Tortura me korrentin bëhej zakonisht nga dy vartës së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 108

1 Salih Mustafës, Kujtim Qerimi, i njohur ndryshe si Dardani dhe
2 nga një tjetër anëtar i BIA-s, që quhej Afrimi.

3 Ne diskutuam që në fillim të këtyre deklaratave
4 përbyllëse kushtet e mjerueshme çnjerëzore të ndalimit. Dhe
5 kujtoni Dëshmitari 3594 tha këtë që vijon:

6 "Më dukej vetja sikur isha kafshë dhe jo më një qenie
7 njerëzore."

8 Rrethanat e ndalimit dhe keqtrajtimit të viktimave ishin
9 edhe jashtëzakonisht poshtëruese dhe izoluese. Disa nga
10 viktimat kërkuan që t'i bashkëngjiteshin UÇK-së apo të
11 mbështesin kauzën e vet, por ishin -- u vunë në shënjestër nga
12 i akuzuari dhe vartësit e tij dhe u etiketuan si
13 bashkëpunëtorë apo spiunë pa asnjë bazë apo mundësi për të
14 mbrojtur veten apo për të hedhur poshtë këto akuza të pabaza.

15 Këto fjalë "spiun", "bashkëpunëtor", "hajn",
16 "gënjeshtar", u zgjodhën nga i akuzuari dhe vartësit e tij për
17 shkak të kuptimit që kishin, kuptimit të tyre të fuqishëm në
18 atë kohë në kuadrin e luftës në Kosovë, por edhe sot, në kohën
19 e sotme në shoqërinë aktuale të Kosovës.

20 Duke zgjedhur këto fjalë, duke i përdorur këto fjalë, i
21 akuzuari dhe vartësit e tij donin të etiketonin, të
22 marginalizonin viktimat, t'i ndanin ata nga familjet dhe nga
23 komunitetet. Të njollosur si bashkëpunëtorë, viktimat
24 gjykoheshin si armiq të UÇK-së dhe tradhtarë të komuniteteve
25 të tyre. Këto emërtime i izolonin viktimat si gjatë ndalimit

1 por edhe më pas për një kohë të gjatë.

2 Edhe pas lirimit të tyre, viktimat duhej të fshiheshin të
3 turpëruar në lidhje me atë që kish ndodhur. Të detyruar që të
4 jetonin si të mbijetuar pa asnjë mbështetje nga komuniteti.
5 Pasojat e këtyre krimeve ishin shumë afatgjata, si fizikisht
6 ashtu edhe psikologjikisht për viktimat, por jo vetëm për ta.
7 Edhe për familjet e tyre.

8 Pa u futur në hollësitë e këtyre pasojave të cilat janë
9 konfidenciale, për shkak të natyrës së tyre, do të përmend
10 vetëm pjesën 6, paragrafët 361-364 të dosjes përfundimtare të
11 Prokurorisë.

12 Tani dua që të kaloj tek roli konkret i të akuzuarit në
13 kryerjen e krimeve.

14 Në këtë rast, i akuzuari, jo vetëm drejtori krimet, por
15 mori pjesë në to. Ai ishte komandanti i BIA-s dhe përgjegjës
16 për atë që ndodhte në kompleksin e ndalimit në Zllash. Në të
17 njëjtën kohë ai ishte gjithashtu pjesëmarrës në krimet e
18 kryera aty. Dënimi i tij duhet të pasqyrojë rolin e tij të
19 dyfishtë.

20 I akuzuari urdhëroi vartësit e tij të ndalonin dhe të
21 abuzonin me viktimat duke rezultuar në vdekjen e të paktën
22 njërit prej tyre. Ai i keqtrajtoi viktimat vetë, duke përdorur
23 duart dhe armët për t'i abuzuar ata. Ai pyeti dhe rrahu
24 viktimën 3593 në praninë e vartësve të tij, duke modeluar për
25 vartësit e tij llojin e sjelljes që ai dëshironte.

1 Pas 3593 u rrash, i akuzuari i vuri revolverin në ballë
2 dhe tërhoqi këmbëzën. Kjo sjellje iu tregoi vartësve një
3 shpërfillje të plotë për jetën dhe dinjitetin e njeriut, një
4 dëshirë për të kallur tmerr dhe një gatishmëri për të vrarë.

5 Në disa raste, i akuzuari pa keqtrajtimin e viktimave dhe
6 i inkurajoi, i nxiti vartësit të vazhdonin. Pas fillimit të
7 rrahjes së viktimës 1679, i akuzuari i komandoi vartësit të
8 mbaronin punë me të.

9 Dënimi që ju do të vendosni për të duhet të jetë i rreptë
10 për të pasqyruar rolin specifik që kishte i akuzuari: një
11 udhëheqës që abuzonte me rolin e tij, që merrte pjesë
12 drejtpërdrejtë në krimet, me qëllim për të siguruar që komanda
13 e tij të kryhej nga vartësit dhe të kryhej plotësisht me
14 ashpërsi dhe shpërfillje të dinjitetit njerëzor.

15 Tani do të kaloj për të diskutuar faktorët rëndues
16 sikurse dhe faktorët lehtësues.

17 Në bazë të nenit 44(5) dhe rregullës 163(1), në
18 përcaktimin e dënimit të të akuzuarit, Paneli duhet të
19 konsiderojë sipas rastit rrethanat rënduese dhe lehtësuese,
20 sipas rastit.

21 Trupi Gjykues ka të drejtë të gjerë të vendosi për këto
22 rrethana dhe për peshën që do t'u jepet atyre. Në lidhje me
23 faktorët rëndues, së pari, Prokuroria e fton Trupin Gjykues të
24 shqyrtojë të paktën, të ketë parasysh tre rrethana rënduese:
25 një, keqpërdorimin e pushtetit a të cilësisë zyrtare nga i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 111

1 akuzuari; faktet që krimet janë kryer ndaj viktimave,
2 veçanërisht të pambrojtura dhe vulnerabël; dhe tre, faktin që
3 krimet janë kryer me egërsi të veçantë.

4 Po i diskutoj një nga një këto faktorë.

5 Keqpërdorimi i pushtetit. I akuzuari kishte një pozitë të
6 rëndësishme në UÇK. Ai ishte komandant dhe kishte ushtronte
7 udhëheqje, një rol udhëheqës të rëndësishëm në njësinë e tij
8 BIA. Por ai e keqpërdori pozicionin, pushtetin tij si
9 komandant i asaj njësie.

10 Pozicioni i tij i lartë dhe roli i tij në rrahje, torturë
11 dhe ndalimin e personave aty, bashkë me miratimin e tij të
12 vazhdueshëm të të njëjtave akteve gjatë periudhës së
13 aktakuzës, duhet të konsiderohet një rrethanë tejet rënduese.

14 Tani do të diskutoj lidhur me çështjen vulnerabilitetit
15 apo pambrojtshmërisë së viktimave.

16 Sikurse u diskutua më herët, viktimat e krimeve të të
17 akuzuarit ishin njerëz veçanërisht të pambrojtur dhe të bërë
18 edhe më -- të vënë edhe në një pozitë edhe më të pambrojtur si
19 rezultat i krimeve dhe për shkak të izolimit, ndodhjes shumë
20 thellë të kësaj qendre. Ata vazhdimisht shikonin të rrahurat e
21 pësuarat nga njëri-tjetri që krijoi një atmosferë terrori dhe
22 tronditjeje. Në këtë rast, viktimat ishin viktimat të ndaluara
23 arbitrarisht që mbaheshin në kushte çnjerëzore, poshtëruese në
24 izolim të plotë nga bota përreth dhe pa asnjë mundësi për të
25 pasur ndonjë kontakt me njeri.

1 Viktimat e të akuzuarit ishin të pambrojtur dhe ishin në
2 mëshirën e atyre që i kishin në dorë.

3 Ata shihnin vazhdimisht të rrahurat e njëri-tjetrit që
4 krijuan një atmosferë, pra, terrori dhe shoku që kontribuoi në
5 gjendjen e përgjithshme të frikës së tyre. Shkalla e vuajtjeve
6 dhe e poshtërimit të shkaktuar atyre, kushtet degraduese të
7 ndalimit dhe humbja e dinjitetit, janë të gjithë faktorë që
8 rëndojnë krimet e kryera nga i akuzuari.

9 Viktimat e të akuzuarit janë etiketuar gjithashtu si
10 bashkëpunëtorë dhe në këtë mënyrë janë ndaluar edhe më tej nga
11 kërkimi i drejtësisë edhe pas lirimit të tyre. Si rrjedhojë,
12 krimet e kryera kundër viktimave kishin pasoja afatgjate, si
13 fizike ashtu edhe psikologjike, të cilat janë rrethana që
14 rëndojnë edhe më tej krimet e kryera nga i akuzuari.

15 Së fundi, në lidhje me mizorinë. Për të vlerësuar mënyrën
16 sesi janë kryer krimet, ju të nderuar Gjykatës, duhet të
17 merrni parasysh shkallën e brutalitetit, barbarizmin dhe
18 zellin e treguar nga i akuzuari dhe vartësit e tij.

19 Brutaliteti i krimeve është diskutuar ndërkohë më parë
20 dhe është provuar si nga instrumentet dhe mjetet e kryerjes së
21 tyre dhe nga niveli i vuajtjeve shkaktuar viktimave. Sa për
22 një shembull, përdorimi i hekurave të nxehtë dhe përdorimi i
23 rrymës, flet për brutalitetin, keqtrajtimin dhe torturën. Po
24 ashtu dhe goditja me armë kundër Dëshmitarit 3593 tregon
25 mizori të qëllimshme.

1 ZPS-ja ju fton që të merrni parasysh të gjitha këto
2 rrethana më e pakta si faktorë rëndues.

3 Tani do të flas shkurt lidhur me faktorët lehtësues sepse
4 nuk ka rrethana që mund të zbusin dënimin që i duhet dhënë të
5 akuzuarit.

6 Veçanërisht i akuzuari nuk ka shprehur pendesë apo nuk ka
7 treguar ndonjë simpati, keqardhje apo dhimbje për viktimat.
8 Pavarësisht nëse ai e ka deklaruar veten të pafajshëm apo
9 fajtor, asnjëherë ai, në mos për gjë tjetër të paktën për
10 respekt të viktimave në këtë çështje, viktimat që janë
11 shqiptarë të Kosovës, civilë, që kanë vuajtur krime të rënda
12 të kryera nga kosovarë, bashkëkombës të tyre.

13 I akuzuari nuk ka kërkuar, nuk ka shprehur ngushëllime
14 për dënimin e shkaktuar viktimave dhe familjeve të tyre dhe
15 kurrë nuk ka pranuar dhimbjen dhe vuajtjen që viktimat në këtë
16 rast kanë duruar. Më tej, çdo parashtrim i mundshëm lidhur me
17 karakterin e mirë të të akuzuarit apo mungesë të dënimeve të
18 tij të mëparshme penale nuk duhet t'i jepet ndonjë peshë e
19 madhe dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të largohen nga krimet me
20 të cilat akuzohet ai, duke pasur parasysh sesa të rënda ishin
21 këto krime që ai ka kryer.

22 Të gjitha këto faktorë rëndues janë shumë të rëndësishëm
23 për përcaktimin e dënimit të tij. Krimet e kryera nga i
24 akuzuari janë veçanërisht të rënda. Sjellja e tij ka qenë
25 mjaft serioze dhe ka pasur pasoja shkatërrimtare tek viktimat

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 114

1 dhe familjet e tyre. Nëse viktimat dhe dëshmitarët janë aktorë
2 të njëmendte në gjykimet të tilla, ku mandati i gjykatës është
3 të gjykojë krime që përfshijnë krime shumë të rënda, siç janë
4 krimet e luftës, atëherë viktimat dhe dëshmitarët meritojnë që
5 këto krime të dënohen në mënyrë të përshtatshme.

6 Mund ta bëni këtë duke vendosur dënime të kërkuar nga
7 ZPS-ja, që mendohet që janë plotësisht të përshtatshme në
8 rrethanat konkrete të kësaj çështjeje.

9 Për të gjitha këto arsye dhe bazuar në tërësinë e provave
10 të paraqitura në gjykim, ZPS-ja kërkon nga Trupi Gjykues të
11 vendosë dënimet e mëposhtme ndaj të akuzuarit.

12 Pika 1 - ndalimi arbitrar: me 10 vite burgim;

13 Pika 2 - trajtim mizor: me 20 vite burg;

14 Pika 3 - torturë: me 25 vite burgim;

15 Pika 4 - vrasje: 33 vite burgim;

16 Rregulla 163(4) kërkon nga Paneli të japi një dënim të
17 vetëm që të pasqyrojë tërësinë e sjelljes kriminale të të
18 akuzuarit. Sigurisht varet nga Paneli ta dënojë të akuzuarin
19 sipas dënimeve që parashikohen lidhur me pikat 1 deri 4 të
20 marrë së bashku apo me një dënim më të lartë burgimi sesa ai
21 që paraqitet në lidhje me çdo pikë të veçantë.

22 Për këtë arsye ZPS-ja kërkon që t'i jepet të akuzuarit
23 një dënim i vetëm prej 35 vitesh burg.

24 Faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit z. Prokuror.

2 Këtu përfundojmë për sot deklaratat përmbyllëse të Zyrës
3 së Prokurorisë Speciale. Nesër do të vijojmë me programin
4 sikurse e kemi diskutuar.

5 Po e përsëris, nesër do të dëgjojmë deklaratat
6 përmbyllëse të Avokates së Viktimave lidhur me pafajësinë apo
7 dënimin e të akuzuarit. Dhe do të dëgjojmë edhe deklaratat
8 përmbyllëse të Mbrojtjes për të njëjtën temë për katër orë e
9 gjysmë.

10 Në rregull? Po.

11 Atëherë, kemi ardhur në fund të seancës së sotme, në
12 qoftë se nuk ka diçka që palët dhe avokatja e viktimave
13 dëshirojnë të ngrenë.

14 Keni ndonjë gjë z. Von Bone? Jo.

15 Atëherë po e përfundojmë seancën, por me këtë rast dua të
16 falënderoj palët, Avokaten e Viktimave, përkthyesit për
17 ndihmën që na dhanë sot, teknikës audiovizualë dhe punonjësit
18 e sigurisë dhe stenografin.

19 --- Seanca mbyllet në orën 15.20

20

21

22